



**REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS**



**RAPORTI VJETOR I PUNËS SË
KRYETARIT DHE QEVERISJES
LOKALE PËR VITIN 2020**



**DRENAS
2021**

PËRMBAJTJA

1.	ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS	3
1.1.	ZYRA PËR KOMUNIKIM ME PUBLIKUN.....	5
1.2.	ZYRA E AUDITORIT TË BRENDSHËM.....	5
1.3.	ZYRA E PERSONELIT	7
1.4.	ZYRA PËR INTEGRIME EVROPIANE (ZKIE).....	10
1.5.	ZYRA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM.....	11
1.6.	ZYRA PËR BARAZI GJINORE.....	12
2.	RAPORTET SIPAS DREJTORIVE	14
2.1.	DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME.....	14
2.2.	DREJTORIA E ARSIMIT	20
2.3.	DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT	32
2.4.	DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL (DBPZHR)	47
2.5.	DREJTORIA E INSPEKSIONIT.....	50
2.6.	DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA	55
2.7.	DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE	58
2.8.	DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTJE TË MJEDISIT	71
2.9.	DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË.....	77
2.10.	DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË	87
2.11.	INFRASTRUKTURA PUBLIKE.....	93
2.12.	DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK.....	97

1. ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

Në periudhën raportuese janar-dhjetor 2020 në Zyrën e Kryetarit janë regjistruar përmes intranetit të brendshëm (arkivit aktiv) 2132 lëndë të ndryshme dhe të gjitha janë procesuar me kohë, ndërsa janë kthyer përgjigje të gjithë atyre që kanë adresuar kërkesat përmes intranetit. Janë nxjerr mbi 350 vendime të ndryshme, të cilat janë publikuar edhe në ueb faqen e Komunës. Zyra e kryetarit ka organizuar dy (2) takime me publikun sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, për të diskutuar aktivitetet e gjashtëmujorit të parë dhe të dytë vitit fiskal. Po ashtu është mbajtur një (1) dëgjim për buxhet 2021-2023 për kërkesat fillestare me qytetarët e Komunës së Drenasit. Ndërsa, janë mbajtur edhe tri (3) takime të tjera me qytetarë për t'i diskutuar dokumente strategjike të Komunës. Një (1) takim është mbajtur për të diskutuar Planin Zhvillimor Komunal të Drenasit 2020-2028, një (1) takim është mbajtur për të diskutuar Rregulloren për Organizimin e Punës në Institucionet Edukativo-Arsimore në Komunën e Drenasit dhe një (1) takim me publikun për Statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr.Hafir Shala” në Drenas. Ndërsa, në muajin gusht të vitit 2020 janë mbajtur 6 dëgjime buxhetore në bashkësi lokale për të diskutuar draft kornizën afatmesme buxhetore dhe draft listën për investimet kapitale. Janë mbajtur edhe dy konsultime me publikun për raportin e vlerësimit strategjik mjedisor (VSMN) dhe për Hartën Zonale të Komunës.

Janë mbajtur edhe 8 mbledhje të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS), gjashtë (6) prej tyre të rregullta dhe dy (2) të jashtëzakonshme. Gjithashtu janë mbajtur 57 mbledhje të Bordit të Drejtorëve dhe 13 mbledhje të Shtabit Emergjent Lokal dhe Qendrës Operative. Për shkak të gjendjes së pandemisë globale të COVID-19, shumë projekte e aktivitete janë stagnuar, megjithatë angazhimi i ekzekutivit nuk ka munguar që gjatë kësaj periudhe të kryhen të gjitha punët e planifikuara për vitin fiskal 2020.

Komuna e Drenasit, që nga momenti i shpalljes së Emergjencës së Shëndetit Publik në Republikën e Kosovës i ka përcjell me vëmendje të gjitha vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, duke i postuar të njëjtit në ueb faqen e Komunës së Drenasit, në të njëjtën kohë duke bërë thirrje që këto vendime të respektohen në përpikëri, duke mos paragjykuar kushtetutshmërinë e tyre. Fillimisht me datë 12.03.2020 është formuar Shtabi Emergjent Lokal (Vendimi Nr.01-020/04-13622). Pastaj, Drejtoria e Shëndetësisë ka nxjerrë vendimin Nr.06-052/01-1942, me datë 16.03.2020 për prioritetet e QKMF-së në Drenas, duke u bazuar në vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Po ashtu, Inspektorati Komunal në vazhdimësi ka mbikëqyrë zbatimin e këtyre vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, duke qenë në teren gjatë gjithë kohës. Në Komunën e Drenasit nga data 13.03.2020, vendimet e nxjerra që lidhen me gjendjen e krijuar me Covid-19 janë gjithsej 55 vendime (duke përfshirë vendimet tjera administrative). Vlen të theksohet se Komuna e Drenasit ka formuar Shtabin Emergjent me datë 12.03.2020, një ditë para se të shpallet gjendja Emergjencës së Shëndetit Publik në Kosovë (vendimi Nr. Nr. 01-020/04-13622), nënshtabin me datë 02.04.2020 (55vendimi Nr. 01-030/01-142020) dhe ka formuar Qendrën Operative Emergjente Lokale me datë 15.04.2020 (vendimi Nr.01-020/04-14533). Komuna e Drenasit gjatë kësaj periudhe është kujdesur që të qëndroj afër qytetarëve përmes pakove ushqimore-higjienike, në mënyrë që të kalojnë sa më lehtë këtë situatë. Janë shpërndarë ndihma përmes buxhetit të komunës dhe donacione të ndryshme, duke arritur që të menaxhojë mirë dhe në mënyrë transparente shpërndarjen e tyre. Për këtë është krijuar një mënyrë e komunikimit të drejtpërdrejtë me administratorët e vendbanimeve e përmes tyre me përfaqësuesit e lagjes me qëllim të identifikimit të nevojtarëve real dhe me qëllim të shmangies së përfituesve të dyfishtë apo trefishtë.

Asambleja Komunale me qëllim të menaxhimit të situatës së krijuar pas shfaqjes së COVID-19 ka ndarë shumën prej 229,200.00 euro për blerje të pakove ushqimore dhe higjienike, me qëllim që familjet në nevojë të ndihmohen për tejkalim të situatës së rënduar nga pandemia. Prej tyre janë shpenzuar 85,000.00 Euro, ku procedurat janë monitoruar edhe nga legjislativi. Për këtë qëllim në kemi krijuar edhe komisionin i cili është përkujdesur për shpërndarjen e ndihmave. Në ditët e para pas pandemisë kemi pranuar një donacion prej 200

thasëve miell dhe 400 litrave qumësht e 400 litra lëngje nga ELKOS dhe Devolli të cilat u janë shpërndarë familjeve të cilat kanë qenë në nevojë imediate, të cilat lista i kanë ofruar administratoret e vendbanimeve. Po ashtu kemi shpërndarë 50 pako ushqimore dhe higjienike, për banorët të cilët jetojnë në banesat e socialit në Çikatovë të Re, donacion nga fondacioni “Jetimet e Ballkanit”. Pastaj kemi shpërndarë 600 pako ndihmë ushqimore dhe higjienike me vlerë prej 30,000.00 Euro, të blera nga buxheti komunal nga kategoria e subvencioneve nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, e të cilat sipas vlerësimeve kanë lehtësuar jetesën e familjeve në nevojë, e cila shpërndarje është bërë sipas listave të ofruara nga Administratoret e Vendbanimeve. Po ashtu, Komuna e Drenasit nga buxheti i saj ka blerë 2.000 pako ushqimore dhe higjienike në vlerë prej 85,000.00 Euro, të cilat po ashtu janë shpërndarë sipas listës së ofruar nga Administratoret e Vendbanimeve.

Pako me përmbajtje të njëjtë në sasi prej 100 njësi kemi pranuar donacion nga *Islamic Relief*, dhe 100 nga kompania *ATC*. Prej kësaj sasive 160 janë shpërndarë për punëtorët shëndetësorë në shenjë falënderimi për kontributin e tyre gjatë pandemisë, ndërsa pjesa tjetër prej 40 pakosh ka shkuar për kompaninë *Pastrimi*. Pas kësaj kemi pranuar edhe 210 pako donacion nga Feronikeli dhe 200 nga Katari, gjithashtu të njëjtat janë shpërndarë sipas listës së ofruar nga administratoret e Vendbanimeve.

Gjatë kësaj kohe kemi pasur shumë donacione miell. Gjatë javës së parë të prillit kemi shpërndarë 1011 thasë miell për të gjithë përfutuesit e skemës sociale në Komunën e Drenasit, pastaj me 21 maj, janë shpërndarë 907 thasë miell për nevojtarët sipas listave të hartuara nga Administratoret. Totali i miellit duke përfshirë edhe miellin e pakove arrin afërsisht 146 000 kg që i bien afërsisht 3 kg për kokë banori. Vlen të theksohet se komunikimi me administratoret e vendbanimeve ka qenë transparent, në të njëjtin grup ku është zhvilluar komunikimi kanë qenë të përfshirë edhe asamblistët. Një bashkëpunim të mirë kemi pasur me Kryqin e Kuq, dega në Drenas dhe sipas informacioneve që na kanë përcjellë ata kanë shpërndarë 192 pako ushqimore dhe higjienike dhe 391 pako higjienike. Kemi përkrahur edhe kategoritë që kanë qenë tepër të ngarkuara me punë ose të marginalizuara si zjarrfikësit, prindërit vetushqyes, Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave, persona në hemodializë, HANDIKOS-in, banorët që janë të vendosur në banesa të socialit si dhe disa kërkesa tjera specifike.

Përkrahja ka vazhduar edhe pas lirim të masave në qershor 2020. Zyra e Kryetarit është përkujdesur që deri në fund të vitit 2020 të shpërndahen pako ushqimore për familjet e izoluara sipas kërkesave të familjeve të prekura dhe kërkesave nga administratoret e vendbanimeve në emër të familjeve të izoluara. Pakot e shpërndara gjatë kësaj periudhe janë 19 nga komuna dhe 10 të tjera nga Kryqi i Kuq. Janë edhe 10 të tjera të sjella nga Qendra Burimore për Persona të Zhdukur e drejtuar nga z. Bajram Qerkini.

Zyra është përkujdesur që tu përgjigjet kërkesave individuale me miell nga donacionet dhe nga një sasi e cila ka qenë në depon e komunës. Janë shpërndarë 72 thasë miell sipas kërkesave individuale dhe 407 thasë miell në bazë të listave të dorëzuara nga administratoret e fshatrave.

Ndërsa nga data 22.12.2020, deri më 30.12.2020, janë shpërndarë 1495 pako të cilat u janë shpërndarë përfutuesve, emrat e të cilëve janë dërguar nga administratorët e vendbanimeve.

Parimet e ndjekura për përzgjedhjen e përfutuesve nga ana administratorëve janë:

1. Liria e administratorit për përzgjedhjen e individëve realë nevojtarë;
2. Parashtrimi i kërkesave të nevojtarëve tek administratorët;

3. Parashtrimi i kërkesave të familjeve të izoluar tek administratorët e vendbanimeve dhe drejtpërdrejtë tek Shtabi Emergjent;

4. Gjendja aktuale e punësimit, gjendja e përgjithshme ekonomike dhe rrjedhshmërie e të ardhurave.

Secili përfitues ka nënshkruar, krahas të dhënave tjera për pranimin e pakos. Përmbajtja e pakos ka qenë e njohur pasi që është bërë publike në uebfaqen e komunës.

Po ashtu vlen të theksohet se dhjetëra donacione nga barnatorët dhe biznese tjera kanë kontribuar në tejkalimin e kësaj situatë duke dhuruar maska, dezinfektues e pajisje tjera të nevojshme për mbrojtje nga virusi.

1.1. ZYRA PËR KOMUNIKIM ME PUBLIKUN

Zyra për Komunikim me Publikun, gjatë periudhës raportuese, ka përcjellë aktivitetet ditore, javore dhe mujore të Komunës. Përmes linkut zyrtar <http://kk.rks-gov.net/gllogoc/>, ueb faqes së Komunës, ka publikuar të gjitha aktivitetet e mbajtura dhe ka publikuar të gjitha vendimet, rregulloret, raportet, projektet, njoftimet, konkurset, njoftimet e zyrës së prokurimit si; kontratat e nënshkruara, njoftimet për anulim, njoftimet për dhënien e kontratave, njoftimet për kontratë, njoftimet për nënshkrimin e kontratave dhe shkresa të tjera në interes të gjithë qytetarëve të Komunës. Po ashtu përmes rrjetit social zyrtar të Facebook-ut (Komuna e Drenasit), janë publikuar të gjitha lajmet, njoftimet, agjendat dhe çdo informatë tjetër që ka pasur karakter informues për qytetarë, ndërsa për disa projekte janë krijuar edhe video. Ka mbajtur kontakte të rregullta me media, ku i ka përcjellë njoftime e lajme ditore për aktivitetet e zhvilluara në Komunë, ftesa, reagime etj., ku gjithsejtë ka lëshuar mbi 430 komunikata. Ka përcjell agjendën e Kryetarit dhe ka caktuar takime në bashkëpunim me Kryetarin me delegacione të ndryshme nga niveli qendror dhe ai lokal, si dhe më delegacione të ndryshme ndërkombëtare.

Në kuadër të kësaj zyre, janë pranuar dhe shqyrtuar edhe kërkesat për qasje në dokumente publike dhe gjatë periudhës raportuese janë pranuar 34 kërkesa për qasje, 4 prej tyre kanë qenë të pjesshme sipas Ligjit për QDP dhe 30 kanë qenë të qasshme. Ju ka përgjigjur të gjitha OJQ-ve për plotësimin e formularëve të pyetjeve të dërguara dhe kontakti i përhershëm me Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal si dhe me nivele të tjera qeveritare. Po ashtu ka mbajtur kontakte të rregullta me media dhe i ka kthyer përgjigje të gjitha atyre që janë interesuar për çështjet e Komunës së Drenasit.

Zyra për Komunikim me Publikun e ka përcjellë po ashtu edhe intranetin e brendshëm të Komunës e po ashtu edhe kjo zyra ka bërë procedurat e shpenzimit të kategorive buxhetore. Po ashtu përmes koordinatorit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi që është po nga kjo zyra, janë mbajtur 8 mbledhje të kësaj trupe, 6 të rregullta dhe 2 të jashtëzakonshme. Koordinator i ka bërë ftesën publike, agjendën, planin vjetor të punës së KKSB-së dhe procesverbalin e mbledhjeve, dhe pas secilit veprim janë publikuar ftesat, njoftimet, agjendat, proceset dhe të gjitha dokumentet tjera relevante në ueb faqen zyrtare; <https://kk.rks-gov.net/gllogoc/raporto-problemet-e-sigurise-ne-bashkesi/keshilli-komunal-per-siguri-ne-bashkesi/?page=2020>

1.2. ZYRA E AUDITORIT TË BRENDSHËM

Njësia e Auditimit të Brendshëm është e përbërë prej dy auditorëve, Drejtorin e Njesisë dhe një Auditor. Në fund të vitit 2019, kjo Njësi ka aprovuar para Komitetit të Auditimit të Brendshëm Planin Strategjik të zhvillimit të aktiviteteve audituese për vitet 2020 -2022 si dhe duke u bazuar në këtë Plan ka miratuar edhe Planin vjetor të Punës për vitin 2020.

Sipas këtij Plani, janë paraparë që gjatë vitit 2020 të kryhen gjithsej 6 (gjashtë) auditime të rregullta. Edhe përkundër situatës së krijuar me pandeminë Covid – 19, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka arritur që këto auditime t'i përfundoj të gjitha brenda planit të punës gjatë vitit 2020.

Gjatë vitit 2020 janë finalizuar gjashtë Raporte të auditimit. Auditimet e kryera kanë pasur për qëllim që të arrihen objektivat kryesore si:

- Arritja e një pajtueshmërie të plotë me kornizën ligjore
- Ruajtja dhe menaxhimi i mirë me pasuritë e komunës;
- Shfrytëzimi më ekonomik i pasurisë komunale dhe rritja e vlerës së kësaj pasurie;
- Shfrytëzimi më ekonomik i resurseve humane në dispozicion të komunës;
- Shtimi i sigurisë dhe integritetit të të dhënave të pasqyruara;
- Rritja e vlerës së burimeve humane dhe material; dhe
- Krijimi i një qeverisje të mirë të bazuar në rrezik

Të gjitha raportet e finalizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm janë shqyrtuar nga ana e Komitetit të Auditimit të Brendshëm dhe janë nxjerrë konkluzionet për hapat që duhet të ndërmerren për jetësimin e rekomandimeve të Auditorit.

Komiteti i Auditimit të Brendshëm është rifreskuar me anëtarë të ri dhe ka qenë mjaft aktiv gjatë këtij viti. Ky Komitet ka përfunduar Raportin vjetor të punës dhe e ka dorëzuar tek Zyrtari Kryesor Administrativ.

Po ashtu edhe Njësia e Auditimit të Brendshëm ka bërë rifreskimin dhe aprovimin e Statutit të Njesisë duke u bazuar në ndryshimet që kanë ndodhur në Ligjin për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike. Në fund të vitit 2020 kemi aprovuar edhe Planin Strategjik për aktivitetet audituese për vitet 2021-2023, si dhe Planin e punës së Njesisë për vitin 2021.

Njësia e Auditimit të Brendshëm ka ndërmarrë një qasje gjithëpërfshirëse dhe profesionale për ofrimin e rekomandimeve të dobishme për menaxhmentin e komunës.

Gjatë këtij aktiviteti ka zhvilluar intervista me menaxherët dhe ka shqyrtuar mostra për të identifikuar shkallën e implementimit të rekomandimeve dhe aktivitetet që janë ndërmarra në këtë drejtim. Fushat e audituara gjatë këtij viti kanë qenë:

1. Menaxhimi me pasuritë jofinanciare të komunës
2. Të hyrat nga dhënia e pronave në shfrytëzim – Qiratë.
3. Menaxhimi me pronat komunale.
4. Të hyrat nga Tatimi në Pronën e Paluajtshme.
5. Rishikimi i procesit të Shpenzimeve/pagesave gjatë vitit 2020.
6. Rishikimi i proceseve të Prokurimit gjatë periudhës 15.10.2019 deri me 13.11.2020.

Gjatë kësaj periudhe janë dhënë një numër i rekomandimeve dhe shumica prej tyre janë implementuar ku janë ndërmarrur një numër i madh i aktiviteteve për adresimin e drejtë të tyre. Për implementimin e këtyre rekomandimeve, në fund të vitit janë identifikuar se Menaxhmenti i komunës ka ndërmarrë mbi pesëdhjetë aktivitete të ndryshme që kanë pasur për qëllim implementimin e rekomandimeve të auditorëve me qëllim të

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE PËR VITIN 2020

arritjes së një shkalle të kënaqshme të përputhshmërisë me ligjet në fuqi si dhe shfrytëzimit sa më ekonomik, efikas dhe efektiv të buxhetit komunal.

1.3. ZYRA E PERSONELIT

Gjatë vitit 2020, Zyra e personelit ka azhurnuar listat e pagave sipas ndryshimeve, konform zhvillimeve në stafin e punëtorëve. Paraqitja në formë tabelare e realizimit sipas azhurimit në listë të pagave:

Muaji-viti	Punëtorë i ri	Ndryshi me	Punëtorë të larguar	Pagesa retroaktiv	etj
Janar 2020	2 Drejtor dhe 2 AAKKOM	4	1 (dorëheqje e asistentit të KK.	0	1 transfer
Shkurt 2020	1 Drejtor U.D. dhe 6 pozita AAKKOM	12	1 (pensionim)	6	
Mars 2020		4	1 (me vdekjen e SHC)	2	2 transfere bankare
Prill 2020			1 (pensionim)	11	
Maj 2020	1 Drejtor U.D.			9	3 transfere bankare
Qershor 2020		2	1 (pensionim)	1	
Korrik 2020		7	1 (pensionim)	7	1 transfer
Gusht 2020		9	1 (pensionim)	7	1 (pensionim i parakohshëm)
Shtator 2020		4	1 (pensionim)	9	
Tetor 2020		3		7	1 transfer bankar
Nëntor 2020	1 (AAKOM)	5	1 (AAKOM)	9	1 ndalesë 40%, masë disiplinore dhe 1 transfere bankare
Dhjetor 2020		3	1 (SHC e punësuar me kohë të caktuar)	6	1 ndalesë 20%, masë disiplinore

Nga muaji Janar 2020, zyra e personelit me kërkesë të MAP, USAID, IKAP, ATK ka përgatitur planin për trajnimin e stafit (shërbyesve civil). Është përgatitur lista e të dhënave të të punësuarve në shërbimin civil, për staf në Arsim, në Shëndetësi, staf Politik, staf mbështetës dhe i është dërguar përmes formularit (Moduli i Statistikave) në SIMBNJ (Sistemi Informativ për Menagjimin e Burimeve Njerëzore). Bazuar në Rregulloren Nr. 06/2011 për pushimin e nëpunësve civil për vitin 2020; është përgatitur Plani Orientues i shfrytëzimit të pushimeve vjetore për nëpunës civil. Hartimi i planit individual i personelit për pozitat e lira nga të gjitha format e kërkesave për vitin 2020 është përfunduar në fund të muajit Nëntor 2019, përmes sistemit të SIMBNJ, si dhe në Dhjetor bëhet plotësim-ndryshimi i PPI, sipas kërkesës së DASHC që të përfshihen edhe pozitave të lira nga sektori i Arsimit dhe Shëndetësisë. Edhe pse ishim të interesuar sa më parë të zhvillohen procedurat rekrutuese për pozitave të lira të punës që ishte edhe kërkesë imediate e njëjësive kërkuese për plotësimin e pozitave me rastin e pensionimit, me vdekjen e nëpunësit, me ndërprerje të marrëdhënies së punës për arsye të ndryshme, si dhe pozitave të lira të punës të planifikuara me PPI për vitin

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE PËR VITIN 2020

2020 të cilat në mungesë të infrastrukturës ligjore (Plotësim-ndryshimet ligjore dhe akteve nënligjore) në nivel vendi nuk ka pasur mundësi të realizohen.

Sqarim: Pra për kërkesat e njësive kërkuese për plotësim të pozitave të lira të punës që nga data 11/09/2019 nuk është realizuar asnjë procedurë rekrutuese.

Konkurs me marrëveshje për shërbime të veçanta për muajin Janar – Dhjetor 2020

Forma tabelare e konkurseve:

Muajt:	Lloj konkursit	Nr. Pozitave të shpallura	Nr. Pozitave të realizuara	Numri i pozitave të anuluar	Ankesat
Janar 2020	Konkurs me Marrëveshje për Shërbime te Veçanta	Një (1) Roje Pylli	1 pozitë në DBZHE	Më konkurs të dt.24.12.2019 është plotësuar pozita roje e pyllit	Nuk ka pasur ankesa
Janar 2020	Konkurs me Marrëveshje për Shërbime te Veçanta	Një (1) Zyrtar Administrativ	1 pozita në DKRS	Më konkurs të dt.24.12.2019 është plotësuar pozita	Nuk ka pasur ankesa,
Janar 2020	Konkurs me Marrëveshje për Shërbime te Veçanta për 5 (pesë pozita) 1 Zyrtar për mbrojtje të mjedisit, 1 Zyrtar për shërbime të transportit lokal, 2 Zyrtar të Prokurimit, Inspektor i Mjedisit	Për 5 (pesë pozita) 1 Zyrtar për mbrojtje të mjedisit, 1 Zyrtar për shërbime të transportit lokal, 2 Zyrtar të Prokurimit, Inspektor i Mjedisit	4 (katër pozita) për Zyrtar të pranuar ; 1 pozitë në DU, 1 pozitë në DSHPE , Inspektor i mjedisit dhe 2 pozita në DAP	Më konkurs të dt.24.12.2019 është plotësuar pozita	Nuk ka pasur ankesa,
Janar 2020	Konkurs me Marrëveshje për Shërbime te Veçanta për 5 (pesë pozita) 1 Zyrtar Ligjor , 1 Zyrtar Administrativ , 1 Zyrtar për Çështje pronësore 1 Zyrtar Administrativ, Arkëtar.	Për 5 (pesë pozita) 1 Zyrtar Ligjor, 1 Zyrtar Administrativ, 1 Zyrtar për Çështje Pronësore, 1 Zyrtar Administrativ , Arkëtar	5 (pesë pozita) për Zyrtar të pranuar ; 1 pozitë në ZK, 1 pozitë në DAP, 2 pozita në DGJKP dhe 1 pozitë në DBPZHR	Më konkurs të dt.22.01.2020 janë plotësuar pozita	Nuk ka pasur ankesa,

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE PËR VITIN 2020

Janar 2020	Konkurs me Marrëveshje për Shërbime te Veçanta për 10 (dhjetë pozita) Zyrtar në stadiumin sintetik, Zyrtar për palestër sportive, Mirëmbajtës – punëtor teknik në Stadiumin Sintetik, Mirëmbajtës – punëtor teknik në Palestrën Sportive, Zyrtar për Bujqësi, Zyrtar për shërbime sociale	Për 10 (dhjetë pozita) 1 Zyrtar për stadium sintetik, 1 Zyrtar për palestër sportive, 2 Mirëmbajtës – punëtor teknik në Stadiumin Sintetik, 2 Mirëmbajtës – punëtor teknik në Palestrën Sportive, 2 Zyrtar për Bujqësi, 2 Zyrtar për shërbime sociale	10 (dhjetë pozita) për Zyrtar të pranuar ; 7 pozita në DKRS, 2 pozita në DBPZHR, 2 pozita në QPS	Më konkurs të dt.22.01.2020 janë plotësuar pozita	Nuk ka pasur ankesa
Janar 2020	Konkurs me Marrëveshje për Shërbime te Veçanta për 3 (tri pozita) 1 Zyrtar ligjor 1 Zyrtar Ligjor, 1 Arkëtar	Tri (3) pozita – 1 Zyrtar ligjor 1 Zyrtar Ligjor, 1 Arkëtar	Tri (3) pozita 1 Zyrtar ligjor DGJKP, 1 Zyrtar Ligjor DIL, 1 Arkëtar DAP	Më konkurs të dt.31.01.2020 janë plotësuar pozita	Nuk ka pasur ankesa
Shkurt 2020	Konkurs me Marrëveshje për Shërbime te Veçanta	Një (1) Zyrtar Ligjor	1 pozitë ligjor DUPH	Më konkurs të dt.03.02.2020 është plotësuar pozita Zyrtar ligjor	Nuk ka pasur ankesa
Qershor 2020	Konkurs me Marrëveshje për Shërbime te Veçanta	Një (1) Pozitë-Fotograf	Zyra e Kryetarit	Më konkurs të dt.09.06.2020 është plotësuar pozita	Nuk ka pasur ankesa
Korrik 2020	Konkurs me Marrëveshje për Shërbime te Veçanta	Një (1) Zyrtar për Prokurim	Një (1) Zyrtar për Prokurim DAP	Më konkurs të dt.06.07.2020 është plotësuar pozita	Nuk ka pasur ankesa
Korrik 2020	Konkurs me Marrëveshje për Shërbime te Veçanta	Një (1) Inspektor i Mjedisit	Një (1) Inspektor i Mjedisit DI	Më konkurs të dt.08.07.2020 është plotësuar pozita	Nuk ka pasur ankesa

Korrik 2020	Konkurs me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta për 3 (tri pozita) Inspektor Sanitar	Tri (3) pozita Inspektor Sanitar	Tri (3) pozita Inspektor Sanitar DI	Më konkurs të dt.27.07.2020 është plotësuar pozita	Nuk ka pasur ankesa
-------------	---	----------------------------------	-------------------------------------	--	---------------------

Duke u bazuar në mungesë të stafit, gjë e cila imponon nevojën për kryerjen me rregull të punëve dhe detyrave brenda drejtorive dhe na është imponuar nevoja për mbulimin e këtyre pozitave përmes kontratave marrëveshje me shërbime të veçanta për vitin 2020, si dhe me kërkesë të Drejtorëve të Drejtorive Komunale drejtuar Zyrës së Personelit për vazhdimin e kontratave marrëveshje për shërbime të veçanta, me dt. 14.08.2020, Zyra e Personelit i rekomandon Zyrës së Kryetarit për vazhdimin e kontratave marrëveshje për shërbime të veçanta edhe për 5.5 muaj për kryerjen e punëve dhe detyrave për eliminimin e ngecjeve të punëve të cilat mund të paraqiten brenda Drejtorive.

Në muajin Qershor 2020, Auditorët e jashtëm

Kërkesa: Auditimi i pozitave të rekrutimit për vitin 2019, dosjet personale për disa shërbyes civil, auditimi i pozitave për punëtorët e pranuar me marveshtje për shërbime të veçanta për vitin 2019, Akt Emërimi, Lista e pagave për muaj të caktuar, Kualifikimi (diplomë ose certifikatë), lista e shërbyesve civil në pushim të lehonisë 2019, punë shtesë të shërbyesve civil, procedurën e pensionimit me arritjen e moshës, raporti periodik i evidencës së hyrjeve dhe daljeve të punëtorëve për periudhën dy mujore; 01/10/2019-31/10/2020 dhe 01/11/2019 – 30/11/2019 .

Zyra e personelit është përgjigjur dhe ka plotësuar dokumentacionin në bazë të detyrës zyrtare edhe sipas kërkesës së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me rastet ankimore. Po ashtu zyra e Personelit dhe njësisë e personelit sipas detyrës Zyrtare dhe sipas Rreg.nr.11/2020 ka rolin e sekretarisë për përgaditjen e seancave sipas ankesave, për Komisionin Disiplinor, ku janë zhvilluar seancat: Ankesat kanë qenë; ankesa për masë disiplinore.

1.4. ZYRA PËR INTEGRIME EVROPIANE (ZKIE)

ZKIE- Harton dhe miraton plane, projekte dhe ofron shërbime përkatëse në fushën e integritimeve evropiane, ofron përkrahje, këshilla dhe ekspertizë profesionale drejtuesve në fushën e integritimit evropian duke marrë parasysh obligimet që dalin nga të gjitha dokumentet strategjike kombëtare rreth integritimit evropian dhe marrëdhënieve në Kosovë, siguron që ndihma e jashtme është e ndërlidhur dhe kontribon në zbatimin e prioriteteve dhe planeve të institucionit, koordinon dhe konsultohet me institucionet përgjegjëse dhe me institucionet e tjera të jashtme përkatëse për fushën e integritimeve evropiane me qëllim të harmonizimit të prioriteteve dhe politikave, merr pjesë në përcaktimin dhe planifikimin e aktiviteteve të ministris në përputhje me dokumentet strategjike kombëtare për integritim evropian, koordinon dhe bashkëpunon me zyrën e personelit për ngritje të kapacitetit të stafit për çështjet e ndërlidhura me integritim evropian, ofron udhëzime për stafin e nivelit më të ulët të njësisë organizative në bërjen e hulumtimeve, përgatitjen e raporteve dhe ofrimin e këshillave rreth çështjeve të integritimit evropian, duke kontribuar në punën e tyre sipas nevojës monitoron produktet.

ZKIE gjatë periudhës Janar –Dhjetor 2020 ka kryer punët dhe detyrat e punës në bazë të planit të punës përshkrimit të detyrave të punës dhe Rregullorës Qeverisë 08/2011. Programi Kombëtar për Zbatim të MSA-së që është dokument ligjërish i detyrueshëm për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës dhe Komunave,ku në nivelin lokal kemi Planin e veprimt të obligimeve të Komunave nga Agjenda Evropiane.

Gjatë kësaj periudhe raportuese kemi përcjellur raporte sipas kërkeses së Ministrisë për Integritet Europian, kemi koordinuar punën me Drejtorët e drejtorive e shefa të sektoreve dhe Udhëheqësin e personelit për identifikimin e nevojave për trajnime për stafin civil të Komunës së Drenasit. Është raportuar më kohë kryetarit dhe MPL-së për Përbushjen e Obligimeve nga Agjenda Evropiane për periudhën Janar-Qershor 2020 për Komunën e Drenasit, ku në këtë drejtim gjatë muajit korrik është bërë përpilimi i Raportit të Përbushjes së obligimeve të cilat dalin nga Agjenda Evropiane dhe është përcjellur për Ministrinë e Integritet Europiane përkatësisht znj. Edona Morina. Në këtë raport janë të përfshira të dhëna lidhur me Zyrën për Integritet Europiane si dhe mbi përbushjen e obligimeve të Komunave të cilat dalin nga Agjenda Evropiane, për periudhën Janar - Qershor 2020 ndërsa raportimi i komunës për përbushjen e obligimeve që dalin nga Agjenda Evropiane për periudhën Janar – Dhjetor 2020 sipas kërkesës së MPL-së do të përbushet gjatë këtij muaji.

1.5. ZYRA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim këshillon autoritetet komunale në lidhje me nevojat e komuniteteve pakicë që jetojnë në Komunën tonë, të siguroj mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të tyre, qasje të barabartë të gjitha komuniteteve në shërbimet publike dhe të krijoj kushte për një kthim të qëndrueshëm të refugjatëve, personave të zhvendosur dhe atyre të riatdhesuar që u përkasin të gjitha komuniteteve.

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim gjatë vitit 2020, ka pasur për fokus personat e riatdhesuar – riintegrimin e tyre. Gjatë vitit 2020 kemi 7 persona të riatdhesuar, gjithashtu kemi një familje 7 anëtarëshe të riatdhesuar. Nga këta 7 persona – dy (2) raste i kemi raste të cënueshme. Gjatë vitit 2020 kemi 1 (një) familje të cilët janë përfshirë në Asistencë Sociale.

Në bazë të Rregullores së Riintegritit 22/2020, personat e riatdhesuar kanë mundësi aplikimi në: Vetëpunësim, Subvencionimi në punësim dhe Trajnim në punë.

Tek vetëpunësimi i personave të riatdhesuar kemi pasur dy thirrje për aplikim. Thirrja e parë ka qenë në fillim të vitit 2020, ku kemi pasur vetëm një person që ka përfituar në këtë kategori, i cili është përfitues i mjeteve të punës për fillimin e biznesit të tij. Vlera e mjeteve të punës përfshin 3000.00€.

Aplikimi për vetëpunësim është bërë vetëm online për shkak të gjendjes së krijuar me Covid-19.

-Trajnim në punë kemi 1 përfitues, ndërsa tek subvencionimi në punësim nuk kemi asnjë rast.

Në bashkëpunim me Shoqatën “Nëna Terezë” –përfitues të projektit nga GIZ-I gjerman, janë çertifikuar 5 persona të riatdhesuar dhe paisur me diplomë për përfundimin e zanateve të ndryshme, ku dy (2) nga këta persona janë paisur edhe me mjete për zanatet të cilat ata janë Diplomuar. (Murator dhe Qeramikë).

Gjatë vitit 2020 kemi pasur 12 kërkesa nga personat e riatdhesuar për paisje me vërtetim për personat e riatdhesuar ku të gjithë janë paisur në bazë të dokumenteve të kthimit që i kanë poseduar.

Nga personat e riatdhesuar kemi verifikuar në teren vetëm rastet e cënueshme, për shkaqe të gjendjes së pandemisë së krijuar në tërë vendin.

Një person i cili është riatdhesuar në vitin 2018, mirpo është paraqitur në zyrë tashmë në vitin 2020-në mungesë të njohurive mbi të drejtën e tij për regjistrimin e fëmijëve në procesin arsimor. Menjëherë pas marrjes së rastit në fjalë ZKKK e kemi paisur me Vërtetim familjen në fjalë dhe e kemi paraqitur rastin tek

Drejtoria Komunale e Arsimit- konkretisht tek Drejtori i Drejtorisë dhe Psikologu Komunal, i cili ky i fundit njëherit është edhe pjesë e Komisionit Komunal për Riintegrim kemi bërë regjistrimin e fëmijëve në shkollën ku ata edhe jetojnë në fshatin Baicë. Kjo e drejtë atyre iu ishte mohuar nga ish –Drejtori i Drejtorisë , duke mos patur njohuri mbi procesin dhe duke mos u konsultuar me ZKKK- Afije Veseli e po ashtu edhe me antarin e KKR –Hazir Elshani.

Zyra për Komunitete dhe Kthim ka mbajtur 5 takime të Komitetit për Komunitete , ku temë diskutimi ka qenë gjithmonë si pike e pare Raporti i punës nga Zyra për Komunitete dhe Kthim, pastaj temat të cilat kanë të bëjnë me mirëqenien e qytetarëve të Komunës sonë.

Gjithashtu kemi qenë pjesë e KKS-së, ku në çdo mbledhje kemi dhënë kontributin tonë.

Zyra për Komunitete dhe Kthim gjatë vitit 2018 ka filluar bashkëpunimin me Organizatën IADK, në bazë të marrëveshjes në mes të Kryetarit të Komunës, z.Ramiz Lladrovci dhe Drejtorit të IADK, projekt I cili ka vazhduar edhe gjatë vitit 2019-2020. Projekti ka për qëllim ndihmën e personave të riatdhesuar në Sektorin e Bujqësisë .

Nga ky projekt i cili ka përfunduar po në këtë vit -2020, kemi 14 persona të riatdhesuar të cilat kanë përfituar mjete pune në Sektorin e Bujqësisë.

Me datën 24.08.2020, kemi mbajtur takim me Organizatën “AKTI”, temë e diskutimit ka qenë projekti i propozuar nga Organizata “Akti”, për përgatitjen e të rinjve dhe shfaqjen e vlerave të tyre , përmes trajnimit dhe këshillimit që do të kenë se bashku me trajnerët e tyre. Pas përfundimit të këtij trajnimi ata do të kenë qasje dhe përkrahje nga ne si Komunë po ashtu edhe nga Organizata për punësimin e tyre në vendet ku ata kanë përgatitje shkollë.

Projekti ka për qëllim Grupet e Margjinalizuara duke përfshirë edhe personat e riatdhesuar. Ky projekt planifikon që për dy vite 60 persona të përfshihen në tregun e punës. Në bazë të projektit Kryetari i Komunës ka formuar një Komision (Grupi lokal i Veprimit) që janë të përfshirë të gjithë akteret kryesor komunal për monitorimin e projektit, ndërsa Zyra për Komunitete dhe Kthim është koordinatore e këtij grupi (Grupi lokal i Veprimit).

Në fund të muajit dhjetor, datë 26.12.2018, kemi mbajtur takimin e gjashtë dhe të fundit për vitin 2018, mbledhjen e Komitetit për Komunitete. Gjatë takimit kemi diskutuar pikat të cilat janë përcaktuar në rend dite nga anëtarët e Komitetit.

1.6. ZYRA PËR BARAZI GJINORE

Zyra për Barazi Gjinore në Drenas Siguron rekomandime dhe këshilla profesionale Kryetarit të Komunës në formulimin e politikave gjinore dhe integrimin e komponentit gjinor në dokumente strategjike dhe planprogrameve lokale ,merr pjesë dhe kontribuon në hartimin e politikave publike në të gjitha nivelet, në kuadrin e grupeve punuese koordinon, zbaton monitoron dhe raporton në institucionin ku bën pjesë, mbi aktivitetet që burojnë nga Programi për Barazi Gjinore për Kosovën në pajtim me përgjegjësitë e përcaktuara në program, mbledhë dhe përpunon të dhëna me bazë gjinore, të natyrës cilësore dhe sasiore, mbi zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore, Programin për Barazi Gjinore të Kosovës dhe të gjitha strategjitë dhe planprogramet në zbatim të hartuara nga komuna ose nga niveli qendror ofron raportime cilësore për Agjencinë për Barazi Gjinore për aspekte barazisë gjinore, në pajtim me kriteret dhe standardet e vendosura për raportim, për të gjitha politikat publike të aprovuara nga Qeveria e Kosovës dhe konventat ndërkombëtare këshillon Njësinë e burimeve njerëzore të institucionit, mbi kriteret gjinore në procesin e punësimit me qasje të barabartë të femrave dhe meshkujve sipas legjislacionit në fuqi bashkëpunon me komunitetin e OJQ-ve dhe partnerë të

tjerë potencialë vendor dhe ndërkombëtarë, për koordinimin e aktiviteteve mes institucioneve, sigurimin e burimeve financiare për zbatimin e politikave publike dhe për ngritjen e kapaciteteve institucionale..

ZBGJ gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2020 ka kryer punët dhe detyrat e punës që dalin nga fushëveprimtaria e saj në bazë të planit të punës dhe përshkrimit të detyrave të punës .

Gjatë muajit Mars Me rastin e 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas, në sallën e Kuvendit Komunal është mbajtur një takim i organizuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport me të gjitha punonjëset e administratës komunale, të cilave iu janë dhuruar edhe buqeta me lule. Gjatë këtij takimi Kryetari Lladrovci ka theksuar se Komuna e Drenasit mbetet komunë lidere sa i përket besimit në aftësitë dhe shkathhtësitë e grave, ku 6 nga gjithsej 12 drejtori udhëhiqen nga gratë/femrat, ndërsa pjesa dërmuese e stafit të administratës komunale janë femra.

Qendra për promovimin e të Drejtave të Grave (QPDG) kishte për vizitë një grup të Grave nga Komuna e Obiliqit me iniciativën e Ganimete Aliu (zyrtare për barazi gjinore në Komunën e Obiliqit) dhe gra aktiviste nga shoqëria civile në të cilin takim ishim edhe ne . Qëllimi i këtij takimi ishte njoftimi nga afër me punën dhe aktivitetet e QPSDG-së , e gjithashtu u theksua edhe se ngritja e vetëdijes dhe shmangia e stigmatizimit ndaj të mbijetuarave të dhunës seksuale gjatë luftës vazhdon të jetë ende e nevojshme edhe sot.

Komuna e Drenasit ka shënuar muajin e ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit. Zyra për Barazi Gjinore Komuna Drenas në bashkëpunim me QPDG me Drejtoreshën Kadire Tahiraj dhe QKMF radiologun Shkelzen Gashi kemi mbajtur një sesion informues lidhur me kancerin e gjirit. Sesioni është hapur nga zyrtarja për barazi gjinore pastaj radiologu i cili në mënyrë më të hollësishme ka informuar në hollësi lidhur me zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit dhe rëndësinë e shëndetit lidhur me këtë sëmundje .Në këtë sesion informues përveç zyrtarëve nga Komuna kanë marrë pjesë edhe shoqëria civile .

Gjithashtu të gjithë pjesëmarrësve iu është shpërndarë fjongo ngjyrë rozë e cila paraqet simbol ndërkombëtar të ndërgjegjësimit ndaj kancerit të gjirit dhe i mbështetjes së personave që vuanin nga kjo sëmundje. Qëllimi i këtij sesioni informues ishte ndërgjegjësimi i qytetarëve për rrezikun nga kanceri i gjirit

Me datë 06 tetor 2020 Drejtoria për Zhvillimit Ekonomik, Zyrtarja për Barazi Gjinore dhe përfaqësuesit e organizatës Women 4 Women kanë mbajtur një sesion informues për gratë e Komunës së Drenasit në kuadër të projektit “I SEE” të përkrahur nga organizata “Gratë për gra” (Women 4 Women) dhe i implementuar në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik.

Në takim, Drejtoresha për Zhvillim Ekonomik, Egzona Jetullahu përshëndeti gjithë të pranishmit dhe i inkurajoi që të gjitha gratë e interesuara të bëhen pjesë e këtij projekti i cili ka për qëllim përmirësimin e mundësive për vetëpunësim.

Kushtrim Shehu dhe përfaqësuesit e organizatës Women 4 Women falënderuan Komunën e Drenasit për bashkëpunimin e deritashëm dhe inkurajuan gjithë të interesuarat të bëhen pjesë e këtij projekti. i cili ka për qëllim kryesor përmirësimin e pozitës së grave të marginalizuara për tejkalimin e pengesave për përfshirje në ekonomi dhe në tregun e punës duke ngritur kapacitetet profesionale të tyre. Përmes këtij projekti do të përshtatet nevoja dhe kërkesa për trajnime profesionale të akredituara në sektorë ku ka potencial të punësimit duke ekuilibruar kërkesën dhe ofertën. Po ashtu projekti do t'i ofrojë përfituesve shërbime në ndërmjetësim në punësim dhe këshillim.

19 tetor – 18 nëntor 2020 - ZBGJ në Drenas si rezultat i situates së krijuar si pasojë e pandemisë në mënyrë simbolike shënon **fushatën kundër Trafikimit me Qenje Njerëzore** , ku në kuadër të kësaj fushate është

bërë publikimi i animacionit i cili i referohet fushatës në fjalë në mënyrë që sado pak të kontribuojmë në vetëdijsimin e qytetarëve dhe fuqizimin e ndërgjegjësimit mbi fenomenin në fjalë .

Lidhur me fushatën **“16 Ditët e Aktivizmit kundër dhunës në familje”** Komuna e Drenasit përkatësisht Zyra për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Qendren për promovimin e të Drejtave të Grave ka realizuar aktivitetet e saja lidhur me këtë fushatë ku në këtë drejtim gjatë mbledhjes së rregullt të Kuvendit ende pa filluar me pikat e rendit të mbledhjes antarëve të kuvendit u janë shpërndarë fjongo dhe maskë me ngjyrën që simbolizon fushatën sensibilizuese kundër dhunës në familje të cilat kanë qenë donacion nga QPDG-ja e gjithashtu para të pranishmëve është mbajtur një fjalim lidhur me këtë qështje e cila paraqitet mjaft problematike në vendin tone nga njëra prej asambleistëve të kuvendit si mënyra më e mirë e vetëdijimit të qytetarëve e në të njejtën kohë duke u bërë kështu zëri më i fuqishëm i viktimave të dhunës në familje.

.Gjithashtu në Qendrën për Punë Sociale me drejtorin e kësaj qendre dhe zyrtaret e shërbimeve sociale është mbajtur takim lidhur me ndihmën të cilën e ofrojnë ata për viktimat e dhunës në familje, me cilat vështiresi dhe sfida përballen gjatë punës së tyre lidhur me këto raste.

Gjatë këtij takimi u diskutua edhe lidhur me rastet të cilat janë trajtuar nga Organi i Kujdestarisë i QPS-së ku gjatë vitit 2020 ka trajtuar rastet e dhunës në familje me çrast ka ofruar të gjitha shërbimet e nevojshme për këtë kategori. Gjithsej kanë trajtuar 53 raste të dhunës në familje. 45 raste kanë qenë dhunë e ushtruar nga burri, dhe kryesisht kanë qenë lloj i dhunës fizike e psikike . Gjithashtu gjatë vitit 2020 Organi i Kujdestarisë ka arritur që të sanoj gjendjen e 16 rasteve të dhunës në familje kurse rastet e tjera janë në procedure gjyqësore.

Sa i përket masës afirmative për regjistrimin e pronës së paluajtshme në emër të dy bashkëshortëve nga Janari i vitit 2020 deri ne Dhjetor të vitit 2020, në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë janë paraqitur 41 kërkesa për regjistrimin e pronës në emër të të dy bashkëshortëve., ndërsa në posedim individual dhe pronësi individuale janë gjithsej 13 kërkesa në emër të femrave .

Për më tepër ZBGJ-ja gjithashtu në mënyrë të vazhdueshme ka pasur bashkëpunim me institucionet relevante për promovimin e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit ,përkatësisht për promovimin e Ligjit për Barazi Gjinore dhe ligjit kunder Diskriminimit.

2. RAPORTET SIPAS DREJTORIVE

2.1. DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Periudha raportuese njëvjeçare e punës në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme përfshinë Sektorin e Gjendjes Civile, Zyra e Prokurimit, Qendra për Shërbime me Qytetar, Shërbime të Kuvendit të Komunës, Sektori i Përgjithshëm dhe Sektori i Arkivit Komunal.

I.Gjendja Civile

Në Departamentin e Gjendjes Civile prej datës 01.01.2020-31.12.2020 janë lëshuar këto dokumente:

- 1.Ekstrakte të lindjes – **20610** copë
- 2.Çertifikata të lindjes- **7103** copë
3. Çertifikata të martesës- **4879** copë
4. Çertifikata të vdekjes- **1188** copë

5. Çertifikata të vendbanimit- **541** copë
6. Çertifikata të bashkësisë familjare- **3974** copë
7. Çertifikata të gjendjes martesore- **1274** copë
8. Çertifikata të shtetësisë- **323** copë
9. Vërtetim nga arkiva- **470** copë

Totali i certifikatave -41769 copë

Gjithashtu gjatë vitit 2020 përmes e-kioskut janë nxjerr **1434** certifikata

II. Zyra e Prokurimit

Gjatë periudhës 01.01.2020 deri më 31.12.2020 në Zyrën e Prokurimit Publik janë bërë kërkesa për blerje dhe zhvillim të procedurave të prokurimit nga të cilat:

1. Administrata komunale 403 kërkesa

a. Nga këto kërkesa si dhe kërkesat e njësive tjera, kjo zyre ka zhvilluar 136 procedura, prej tyre për:

1. Vlera minimale **35**
2. Kuotime të çmimeve **11**
3. Punë shtesë **0** dhe
4. Procedura të hapura **81**
5. Procedurë Negociuara pa njoftim për kontratë **9**
6. **5** Anulime të njoftimeve për kontratë dhe **4** Ritenderime

b. Janë nënshkruar 136 kontrata, prej tyre për:

1. Vlera minimale **35** (<1.000 €)
2. Vlera të vogla **11** (<10.000 €)
3. Punë shtesë **0** dhe të negociuara **9**
4. Vlera të mesme ose të mëdha **81** (>10.000 €)

c. Janë kryer njoftimet për kontratë, dhënie , anulime dhe pas nënshkrimit të kontratës

Njoftimet për kontratë **136**

Njoftime për dhënie **101**

Njoftime për anulime **5**

Njoftime për nënshkrimit të kontratës **101**

Aktvendime te hapjeve dhe Aktvendime te vlerësimeve **101**

Raporte te vlerësimeve 101

III.Qendra për Shërbime të Qytetarëve –QSHQ

QSHQ përmes sistemeve elektronike ka ofruar te gjitha shërbimet për qytetaret, ka pranuar dhe regjistruar të gjitha lëndët që u janë drejtuar organeve komunale. Në këtë zyre është dhënë prioritet në ofrimin e sa më shumë shërbimeve, duke krijuar mundësinë që qytetarët fare të mos frekuentojnë fizikisht zyrat e komunës.

Bazuar në rregullativën ligjore dhe politikat për TI-në dhe gjithnjë në koordinim me nivelin qendror si dhe institucionin përgjegjës për e-Qeverisje, QSHQ ka kryer këto funksione:

Ka kontaktuar drejtpërdrejt me qytetarët, ka pranuar dhe regjistruar kërkesat dhe ankesat nga qytetarët. Ka përcjellur kërkesat tek drejtoritë përkatëse për shqyrtim dhe vendimmarrje dhe ka kthyer përgjigje përmes QSHQ-ve ose në mënyrë elektronike, me synim eliminimin e qarkullimit të kopjeve fizike.

Ka ofruar ndihmë juridike administrative, ka njoftuar qytetarët për ecurinë e kërkesave të tyre brenda afatit ligjor, ka kryer transaksione të tjera në pajtim me kompetencat e komunës. Është përdorur libri unik i Protokollit në të gjithë komunën, duke përfshirë edhe kërkesat për gjendjen civile, si dhe zyrat e vendit. Funksionalizimi i Fletë Kërkesave dhe i Librit Unik të Arkës, duke përdorur sistemin e integruar të Arkës gjenerohen të gjitha llojet e faturave për pagesa në institucionet e komunës edhe pagesat me UNIREFA për pagesa bankare, bëhen në QSHQ. Me poshtë paraqesim numrin e lëndëve të kryera për vitin 2020 në QSHQ, sipas departamenteve:



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA GLOGOC - OPŠTINA GLOGOVAC - MUNICIPALITY OF GLOGOVAC



Raporti sipas departamenteve dhe statusit të zgjidhjes 03/01/2020 - 31/12/2020

Shkurtesa	Pershkrimi	Pranuar	Ne Proces	Miratuar	Refuzuar	Hedhur Poshte	Pezuluar	Ceduar	Anuluar	Perfunduar	Totali
	NUK EXISTON si DEPARTAMENT por ka Lende	0	2	0	0	0	0	0	1	0	3
DAP	Drejtoria për Administratë dhe Personel	34	139	1,399	12	0	30	0	15	27,313	28,942
DASH	Drejtoria për Arsimit dhe Shkencat	5	27	1,937	1,891	0	1	0	37	0	3,690
DIZHR	Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	4	7	488	118	9	3	0	37	0	668
DEBF	Drejtoria për Ekonomik, Financa dhe Buxhet	2	31	9,992	29	0	0	0	22	0	10,074
DKRS	Drejtoria për Kulturë, Rin dhe Sport	2	0	251	5	5	15	0	3	0	281
DUMM	Drejtoria për Urbanizim dhe Mbrojtje të Mjedisit	0	109	204	36	0	1	0	7	0	357
DPI	Drejtoria për Punë të Inspeksionit	2	73	1,968	11	4	6	0	37	0	2,091
DSHMS	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	3	0	708	186	10	51	0	9	0	967
DSHPS	Drejtoria për Shërbime Publike dhe Siguri	1	0	864	102	1	5	0	14	0	987
DQJPK	Drejtoria për Gjeodezi, Pronë dhe Kadaster	10	1	5,117	8	1	17	0	57	0	5,213
PR	Presidenca	9	2	1,761	301	1	41	0	17	0	2,132
ZKK	Zyra e Kuvendit Komunal	2	129	216	12	1	1	0	1	0	361
ZGKTH	Zyra Komunale për Komunitete të Këmbit	0	0	42	0	0	0	0	0	0	42
DZHE	Drejtorati për Zhvillim Ekonomik	0	5	192	0	0	0	0	3	0	200
DIL	Drejtorati për Infrastruktura Lokale	4	3	894	32	1	0	0	9	0	943
		78	527	25,933	2,743	33	171	0	269	27,313	57,067

• Zyra e Teknologjisë Informative

Avancimi dhe modernizimi i shërbimeve dixhitale komunale është prioritet, kemi mundësuar avancimin e proceseve dhe shërbimeve administrative në komuna. Duke përdorur shërbimet dixhitale, qytetareve u është lehtësuar marrja e shërbimeve në komunë. Tani qytetari duke përdorur platformën e re të ueb faqes, i mundësohet informimi me rrjedhjen e zgjidhjes së kërkesës së tij drejtuar organeve komunale.

Implementimin e proceseve të e-shërbimeve dhe aplikacioneve në komunë si: (Intraneti, Ueb-faqja, SMAED-i, SIMBNJ-a, SVMP-ja, e-Arkiva, e-Pasuria, GJC, Arka, etj.). Është mbështetur dhe trajnuar stafi për përdorimin e aplikacioneve, janë krijuar dhe konfiguruar llogarit për përdorim të aplikacioneve.

Është menaxhuar me rrjetin shtetërorë në institucionet komunale, sistemin e TI-ve , dhe proceseve të qeverisjes elektronike në administratën e komunës. Kemi siguruar të gjitha të dhënat që ruhen në serverët e komunës dhe DATA Qendër. Kemi menaxhuar, mirëmbajtur dhe krijuar llogarit zyrtare për zyrtar dhe këshilltar komuna, pajisjet zyrtare janë domain.

Me implementimin e aplikacioneve të E-Qeverisjes, komuna jonë monitorohet online nga MPL, si mbledhjet e kuvendit, performancën, aplikacioni i Intranetit dhe modulit e lejeve të ndërtimit.

Qytetarët mund të marrin shërbimet e Gjendjes Civile në 7ditë/24 orë duke përdorur e-Kioskën, këto shërbime mund të marrin edhe nga distanca duke përdorur ueb faqen e komunës.

Mbajmë kontakte të rregullta me Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit dhe me të gjitha institucionet tjera në nivel vendi.

Është mirëmbajtur sistemi i telefonisë VoIP dhe është aktivizuar qasja për thirrje pa pagesë për qytetarët në tel:**080013050**.

Pjesëmarrje në grupet punuese në ndërtimin dhe avancimin e aplikacioneve si: Intranet, ueb faqe, Implementimi i Strategjisë së E-Qeverisja 2020-2025. Poashtu kemi mbështet stafin në përdorimin e sistemeve dhe pajisjeve të TI-së, duke realizuar kërkesat në fushën e TI-ve për përkrahje.

Raporti i punës në zyrën e Teknologjisë Informative : Nga Data - 03/01/2020 deri me 31/12/2020		
Zyrtari :Ukë Krasniqi		
Drejtoria	Kërkesa nga Zyrtari	Lloji i intervenimit - Problemit
DAP	GJC	213 intervenime
DAP	QSHQ	175 intervenime
ZK		85 intervenime
DF		210 intervenime
DI		224 Intervenime
DKRS		186 intervenime
DSHMS		174 intervenime
DGJKP		158 intervenime
DUMM		187 intervenime
DIL		205 intervenime
DBP		164 intervenime
DZHE		132 intervenime
DA		185 intervenime
DSHPS		191 intervenime

IV.Shërbimet e Kuvendit të Komunës

Kuvendi i Komunës së Drenasit gjatë periudhës **Janar- Dhjetor 2020**, ka organizuar dhe mbajtur mbledhjet për Komitetin për Politikë dhe Financa dhe mbledhjet e Kuvendit Komunal.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020, Kuvendi Komunal ka mbajtur **gjithsejtë 21 mbledhje**:

Prej tyre **11 mbledhje** të rregullta të Kuvendit, **5 mbledhje** Solemne, **2 mbledhje** Urgjente dhe **3 mbledhje** të jashtëzakonshme.

Për **11 mbledhje** të rregullta të organizuara të Kuvendit janë shqyrtuar , **(124)njëqind e njëzetekatër** pika të rendit të ditës dhe **(2)** dy pikë në mbledhjen urgjente, **(2)** dy pika për mbledhje të jashtëzakonshme, **(16)** gjashtëmbëdhjetë pika për mbledhje solemne gjithsejtë (**145)njëqind e dyzetepesë pika**.

Nga incizimet e seancave të Kuvendit janë bërë 15, procesverbale, prej tyre 11, të mbledhjeve të rregullta të Kuvendit, dy (2) procesverbale të mbledhjes urgjente, dhe 2 procesverbale të mbledhjeve të jashtëzakonshme.

Sipas raportit të dt. 29.12.2020,Nr. 12-052/01-56538, akteve të miratuara në Kuvendin Komunal të Drenasit janë gjithsejtë shtatëdhjetë e nëntë (79) akte prej tyre.

- **Vendime shtatëdhjetë e dy (72),**
- **Strategji një (1),**
- **Plan zhvillimor një (1),**
- **Kodi i Etikës një (1),**
- **Rregullore Katër (4).**

V. Sektori i Përgjithshëm

- **Shërbimet e Përbashkëta**

Mbikëqyrja e pastrimit dhe sigurimit të objektit të komunës nga kompanitë e angazhuara, mirëmbajtja e rrymës, nxehjes qendrore, mirëmbajtja e kopshteve dhe oborrit të Komunës, Sallave, shpërndarja e postës si dhe mirëmbajtja e agregateve dhe mirëmbajtja e hapësirave tjera të komunës. Është mbajtur evidenca për **automjetet zyrtare të komunës**. Për çdo automjet është formuar dosja e veçantë për harxhime të karburanteve, kilometrazha, shpenzimet për riparim, regjistrimi i tyre, mirëmbajtja dhe pastrimi. Punët rreth shpërndarjes së postës dhe mirëmbajtja e objekteve komunale si dhe punët e mirëmbajtjes së energjisë elektrike kanë qenë në nivelin e duhur.

- **Zyra për Barazi Gjinore**

ZBGJ gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2020 ka kryer punët dhe detyrat e punës që dalin nga fushëveprimtaria e saj në bazë të planit të punës dhe përshkrimit të detyrave të punës. Me rastin e 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas, në sallën e Kuvendit Komunal është mbajtur një takim i organizuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport me të gjitha punonjëset e administratës komunale, të cilave iu janë dhuruar edhe buqeta me lule. Gjatë këtij takimi Kryetari Lladrovci ka theksuar se Komuna e Drenasit mbetet komunë lidere sa i përket besimit në aftësitë dhe shkathtësitë e grave, ku 6 nga gjithsej 12 drejtori udhëhiqen nga gratë/femrat, ndërsa pjesa dërrmuese e stafit të administratës komunale janë femra. Qendra për promovimin e të Drejtave të Grave (QPDG) kishte për vizitë një grup të Grave nga Komuna e Obiliqit me iniciativën e Ganimete Aliu (zyrtare për barazi gjinore në Komunën e Obiliqit) dhe gra aktiviste nga shoqëria civile në të cilin takim ishim edhe ne. Qëllimi i këtij takimi ishte njoftimi nga afër me punën dhe aktivitetet e QPSDG-së , e gjithashtu u theksua

edhe se ngritja e vetëdijes dhe shmangia e stigmatizimit ndaj të mbijetuarave të dhunës seksuale gjatë luftës vazhdon të jetë ende e nevojshme edhe sot.

Komuna e Drenasit ka shënuar muajin e ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit. Zyra për Barazi Gjinore Komuna Drenas në bashkëpunim me QPDG dhe QKMF përkatësisht radiologun Shkelzen Gashi ka mbajtur një sesion informues lidhur me kancerin e gjirit. Qëllimi i këtij sesioni informues ishte ndërgjegjësimi i qytetarëve për rrezikun nga kanceri i gjirit

Me datë 06 tetor 2020, Drejtoria për Zhvillimit Ekonomik, Zyrtarja për Barazi Gjinore dhe përfaqësuesit e organizatës Women 4 Women kanë mbajtur një sesion informues për gratë e Komunës së Drenasit në kuadër të projektit “I SEE” të përkrahur nga organizata “Gratë për gra” (Women 4 Women) dhe i implementuar në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik.

19 tetor – 18 nëntor 2020 - ZBGJ në Drenas si rezultat i situatës së krijuar nga pandemia në mënyrë simbolike ka shënuar **fushatën kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore**, ku në kuadër të kësaj fushate është bërë publikimi i animacionit i cili i referohet fushatës në fjalë në mënyrë që sado pak të kontribuojmë në vetëdijësimin e qytetarëve dhe fuqizimin e ndërgjegjësimit mbi fenomenin në fjalë .

Lidhur me fushatën **“16 Ditët e Aktivizmit kundër dhunës në familje”** Komuna e Drenasit përkatësisht Zyra për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Qendrën për promovimin e të Drejtave të Grave ka realizuar aktivitetet e saja lidhur me këtë fushatë ku në këtë drejtim gjatë mbledhjes së rregullt të Kuvendit janë shpërndarë fjalime dhe maskë me ngjyrën që simbolizon fushatën sensibilizuese kundër dhunës në familje dhe është mbajtur një fjalim lidhur me këtë çështje e cila paraqitet mjaft problematike në vendin tonë nga njëra prej asamblistëve të kuvendit si mënyra më e mirë e vetëdijësimin të qytetarëve e në të njëjtën kohë duke u bërë kështu zëri më i fuqishëm i viktimave të dhunës në familje.

Gjithashtu në Qendrën për Punë Sociale me drejtorin e kësaj qendre dhe zyrtaret e shërbimeve sociale është mbajtur takim lidhur me ndihmën të cilën e ofrojnë ata për viktimat e dhunës në familje, me cilat vështirësi dhe sfida përballen gjatë punës së tyre lidhur me këto raste.

Gjatë këtij takimi u diskutua edhe lidhur me rastet të cilat janë trajtuar nga Organi i Kujdestarisë i QPS-së ku gjatë vitit 2020 ka trajtuar rastet e dhunës në familje me ç ‘rast ka ofruar të gjitha shërbimet e nevojshme për këtë kategori. Gjithsej kanë trajtuar 53 raste të dhunës në familje. 45 raste kanë qenë dhunë e ushtruar nga burri, dhe kryesisht kanë qenë lloj i dhunës fizike e psikike. Gjithashtu gjatë vitit 2020 Organi i Kujdestarisë ka arritur që të sanoj gjendjen e 16 rasteve të dhunës në familje kurse rastet e tjera janë në procedure gjyqësore

Sa i përket masës afirmative për regjistrimin e pronës së paluajtshme në emër të dy bashkëshorteve nga Janari i vitit 2020 deri në Dhjetor të vitit 2020, në Drejtorinë për Gjeodozi, Kadastër dhe Pronë janë paraqitur 41 kërkesa për regjistrimin e pronës në emër të të dy bashkëshortëve., ndërsa në posedim individual dhe pronësi individuale janë gjithsej 13 kërkesa në emër të femrave .

Për më tepër ZBGJ-ja gjithashtu në mënyrë të vazhdueshme ka pasur bashkëpunim me institucionet relevante për promovimin e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit, përkatësisht për promovimin e Ligjit për Barazi Gjinore dhe Ligjit kundër Diskriminimit.

VI.Sektori i Arkivit Komunal

Gjatë vitit 2020 kemi vazhduar arkivimin e lëndëve, ku sipas legjislacionit në fuqi lëndët duhet të arkivohen në mënyrë fizike dhe elektronike. Secili drejtorat ka obligim ligjor që lëndët e përfunduara të kthehen në arkivin komunal për ruajtjen e mëtutjeshme. Në vazhdim po e paraqesim në mënyrë tabelare numrin e lëndëve që janë kthyer për arkivim në mënyrë fizike sipas Programeve dhe Drejtorive.

1.	Zyra e Kryetarit te Komunës	344	Lëndë
2.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme	1116	Lëndë
3.	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	44	Lëndë
4.	Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	304	Lëndë
5.	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	27	Lëndë
6.	Drejtoria i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	189	Lëndë
7.	Drejtoria për Kadastër ,Gjeodezi dhe Pronë	00	Lëndë
8.	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit	44	Lëndë
9.	Drejtoria për Arsim	00	Lëndë
10.	Drejtoria për Kulture, Rrini dhe Sport	29	Lëndë
11.	Drejtoria i Inspektimit Komunal	1761	Lëndë
12.	Zyra e Kuvendit	227	Lëndë
13.	Drejtoria për Shërbime publike dhe Emergjencë	00	Lëndë
14.	Zyra për Komunitete dhe kthim	00	Lëndë
15.	Drejtoria për Infrastrukturë Lokale	214	Lëndë

Numri i lëndëve të arkivuara në mënyrë fizike për të gjitha programet për vitin 2020 është **4299**.

Ndërsa numri i lëndëve të arkivuara në mënyrë elektronike për të gjitha programet është **30182**.

Spektori i arkivit kryen edhe punë tjera në shërbim të qytetarëve si vijon:

1. Deklaratë për ushqim për vitin kalendarik [mbajtës i familjes] për bashkatdhetarë për të gjitha shtetet.
2. Certifikatë për shtesa të fëmijëve ,për Punëtorët që kanë punuar në shtetet e huaja.
3. Vërtetim mbi jetën për të gjithë bashkatdhetarët.
4. Deklaratë e udhëtimit për shtetas të huaj.
5. Legalizimin e të gjitha dokumenteve nga origjinali.

Për këto shërbime në vitin 2020 kemi proceduar **945** lëndë.

2.2. DREJTORIA E ARSIMIT

Të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e këtij Drejtorati janë realizuar gjatë kësaj periudhe me përkushtim dhe me përgjegjësi të plotë. Me prezantimin e këtij raporti do të jeni më afër të njohur dhe të informuar sidomos në aspektin zyrtar për punën, organizimin dhe zhvillimin transparent të politikave arsimore në Drenas. Procesi arsimor gjatë këtij viti ka qenë vazhdimisht i përcjell me kujdes nga Departamenti jonë, ku të gjitha institucionet arsimore janë vizituar disa herë, si nga ana e Drejtorit, ashtu edhe nga zyrtarët e arsimit. Në fund të çdo muaji kemi realizuar mbledhje të rregullta me drejtorë të institucioneve shkollore. Janë mbajtur takime të rregullta edhe me MASHT-in, ku çdo detyrë e dhënë nga ana e tyre është realizuar me sukses nga ana jonë.

Për shkak të pandemisë Covid-19 procesi i rregullt mësimorë është ndërprerë me 11.03.2020. Mirëpo DKA-ja edhe gjatë pandemisë ka realizuar takime virtuale të vazhdueshme me të gjithë drejtorët në Komunën e Drenasit dhe ka monitoruar nga afër mbarëvajtjen e mësimin nga distanca.

STRUKTURA ORGANIZATIVE - Këtë sektor e përbejnë 11 punëtor: Drejtori, një zyrtar për personel, dy zyrtar për arsim, një pedagog, një psikolog, një zyrtar për financa, një zyrtar për prokurim, një punëtor për lista të pagave dhe arkivim, një zotues, një depoist. Drenasi ka një çerdhe, 30 shkolla fillore dhe të mesme të ultë, 1 paralele të ndara fizike, dy shkolla të mesme, gjithsejtë 34 institucione shkollore. Ku punojnë gjithsejtë 957 punëtor dhe ndjekin mësimin e rregullt 12168 nxënës. 54 punëtor administrativ, 766 mësimdhënës, 131 punëtor teknik. Çerdhja “Ardhmëria” ka gjithsejtë 125 fëmijë, parafillor 952 fëmijë, shkollat fillore prej (I - IX) ka gjithsejtë 8398 nxënës, SHML Gjimnazi “Gj.K.Skënderbeu” ka gjithsejtë 1093 nxënës dhe ShMP “Fehmi Lladrovci” ka gjithsejtë 1600 nxënës.

AKTIVITETET DHE DETYRAT E PUNËS - Janë realizuar me sukses mbledhje të rregullta me drejtorë të institucioneve shkollore në Drenas. Në këto takime kemi kërkuar angazhim edhe më të madh të mësimdhënësve, sidomos në ngritjen e cilësisë në arsim në këtë vit shkollor, dhe kemi kërkuar respektimin në përpikëri të ligjeve dhe Udhëzimeve të reja Administrative të nxjerra nga MASHTI-i. Kemi realizuar takime me prindër, kemi marrë pjesë në manifestimin në Ditën e shkollës në disa shkolla. Gjatë këtij viti nga zyrtarët e arsimit janë vizituar shumë shkolla që kanë kontrolluar mbarëvajtjen e procesit mësimor, kanë mbledhur të dhëna lidhur me zhvillimet e procesit mësimor dhe rezultatet e arritura. Për shkak të pandemisë Covid-19 procesi i rregullt mësimorë është ndërprerë me 11.03.2020. Mirëpo DKA-ja edhe gjatë pandemisë ka realizuar takime virtuale të vazhdueshme me të gjithë drejtorët në Komunën e Drenasit dhe ka monitoruar nga afër mbarëvajtjen e mësimin nga distanca. Si DKA në Drenas kemi pranuar raporte të rregullta në baza ditore nga të gjithë drejtorët e shkollave. Interesimi dhe angazhimi i të gjithë akterëve (personelit arsimor, prindërve, nxënësve, stafit mbështetës etj.) ka qenë në nivel ashtu siç është kërkuar në këto rrethana. Si DKA ju kemi bërë të qartë të gjithëve detyrat dhe përgjegjësitë për realizimin e mësimin në distancë konform udhëzimeve të pranura nga MASHTI.

Gjatë kohës së pandemisë për klasat nga 1-9 mësimi është përcjelle nga transmetuesi publikë dhe nëpërmjet të platformës emesimi.rks-gov.net që është shfaqur edhe në Youtube. Te gjithë mësimdhënësit i kanë formuar grupet e komunikimit dhe kanë qenë në kontakt të vazhdueshëm me prindërit dhe nxënësit duke e përcjellë angazhimin e nxënësve dhe kryerjen e detyrave

Në nivelin e tretë të shkollimit, klasat 10-12 të arsimit të mesëm të lartë në gjimnazin dhe në shkollën profesionale, në Komunën e Drenasit kemi filluar mbajtjen e mësimin nga distanca nga data 23.03.2020 (në këtë datë ju kemi dërguar kërkesë për konfirmim edhe MASHTI-t) dhe tashmë i kemi përfshirë të gjitha lëndet profesionale. Duke filluar nga 06.04.2020 kemi startuar me mësimin e rregullt sipas orarit zyrtar në shkollë. Sigurisht ka qenë sfidë për shkakë numrit të madh të lëndëve mirëpo kemi arritur që t’mbajmë me sukses dhe mund të themi se kemi qenë Komuna e vetme me këtë formë të organizimit (mbajtjes) se orëve gjatë pandemisë.

Në ngritjen e cilësisë së arsimit në përgjithësi ka ngritje të cilësisë dhe kushteve më të mira për nxënës dhe personel. Drenasi tashmë është nga Komunitat në nivel vendi sa i përket sukseseve në lëndë të ndryshme shkollore. Garat komunale dhe ato mbarëkombëtare por edhe angazhime dhe matje të tjera të dijes duke rezultuar me suksese dhe rezultate të larta dhe pozitive.

Mbështetja dhe mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar në komunën tonë, është duke u realizuar në vazhdimësi ku sipas planit dinamik zyrtaret kanë përcjellë nga

afër ecurinë e zhvillimeve në arsim dhe njëkohësisht duke i mbështetur shkollat me këshilla profesionale në këtë kohë pandemie që po kalon vendi, si dhe përpjekje maksimale për sa i përket Zhvillimit profesional të mësimitdhënësve me trajnime dhe module të ndryshme të cilat do të ndikojnë në ngritjen e cilësisë në procesin edukativo-arsim.

Aktivitetet më të rëndësishme të realizuara :

- Inspektimet në institucionet edukativo arsimore, sipas objektivave të paraparë nga ana e zyrtarëve dhe drejtorit DKA-së.
- Përgatitjet për mbajtjen e testeve të semimaturës dhe maturës shtetërore -2020.
- Janë trajnuar të gjithë mësimitdhënësit e klasave : para- fillore, klasa e I, IV -ta.
- Janë realizuar planifikimet për fondin e orëve të klasave me kurrikulën e re dhe zbatimin i udhëzuesit për ndarjen e orëve me zgjedhje.
- Publikimi i konkurseve dhe regjistrimi i fëmijëve si dhe nxënësve në institucionet parashkollore, në klasat e(I) para dhe të (X) dhjeta.
- Është bërë shpërndarja e teksteve shkollore falas nga MASHT për nxënës, për dallim nga vitet tjera në këtë vit, librat janë shpërndarë për nivelin fillor (I – V) – ta.
- Futja e të dhënave statistikore për numrin e fëmijëve dhe personelit, në sistemin EMIS.

Drejtorja e Arsimit, pavarësisht situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, asnjëherë nuk ka reshturi së vepruari në funksion të përmirësimit të kushteve dhe mundësive më të mira për mësimitdhënie dhe mësimitnxënie duke zhvilluar procesin edukativo arsimor sipas skenarëve të MASH, në koordinim me DKA dhe specifikat e shkollës me numrin e nxënësve dhe infrastrukturën e saj

Gjatë muajit Shtator, Tetor, Nëntor, ekipi profesional në nivel komunal, ka hartuar planifikimet për të hartimin e planeve unike për lëndët kurrikulare, për nivelin 0-IV , pra planifikimet janë përgatitë për në nivel komunal .

Drejtorja e Arsimit në koordinim dhe bashkëveprim me Ministrin e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë, Inovacionit dhe mekanizma të tjerë mbështetës, kanë vazhduar me organizimin e mësimit në distancë për nivelin e arsimit fillor (I-V) dhe nivelin e arsimit të mesëm të ulët (VI-IX) edhe gjatë muajit nëntor 2020. Përhapja e pandemisë COVID-19 ka paraqitë vështirësi të mëdha në shumë dimensionë dhe në veçanti, kjo ka reflektuar edhe në procesin edukativo arsimor ku më të filluar realizimi i procesit të mësimit online është vërejtur se një numër i konsiderueshëm i nxënësve nuk kanë pajisje teknologjike për përcjelljen dhe për të qenë pjesëmarrës në këtë proces.

Andaj, Drejtorja e Arsimit për këtë kategori nga një donacion ka shpërndarë disa pajisje teknologjike për nxënësit në nevojë, duke ju mundësuar që secili të vijojnë mësimit në distancë.

Nga situata e krijuar nga pandemia, plani i zhvillimit dhe i mbarëvajtjes së procesit arsimor me skenare të arsimit është paraparë të krijohet edhe Task-Forca në kuadër të shkollave të cilat kanë qenë në funksion të zhvillimeve të proceseve progresive në sistemin e arsimit gjatë kësaj duke realizuar punët dhe detyrat e përcaktuara dhe në fund të muajit kanë përgatitë raporte mbi ecuritë dhe zhvillimet e përgjithshme në shkollë. Drejtori i drejtorisë komunale të Arsimit gjatë kësaj periudhe ka pasur takime bashkëpunimi me institucione

dhe organizata të ndryshme, ku janë shtruar tema të ndryshme që kanë të bëjnë me zhvillimin, mbështetjen dhe avancimin e procesit mësimor dhe reformave në arsim.

1. Kolegjin “ Mehmet Akif”-Lipjan,
2. Përfaqësuesit e GIZ-it, për sa i përket trajnimeve dhe zhvillimit profesional të mësimeve
3. Caritasi Zviceran.

I-Sa i përket çështjes së Psikologut, brenda punës dhe detyrave që ka me organogram, punët e kryera për periudhën e gjashtëmujorit të dytë të vitit 2020 si; trajtimet e rasteve të referuara nga prindërit nga kujdestaret e klasave nga mësuesit dhe drejtoret e shkollave të gjitha këto raste në pajtim me marrëveshjen e prindit për përmirësim të sjelljeve të këqija në raport me shoqërinë dhe procesin edukativ-arsimor apo edhe probleme në të nxënë ku të gjitha këto në afat kohor janë të trajtuara në nivel profesional, po ashtu në bashkëpunim edhe me institucionet e shtetit si; Gjykatën, Policinë, QPS, Shërbimin Sprovues-i cili me vendim të Prokurorit vendos për Masën e Diversitetit si Këshillim Psikologjik nga ana e imë profesionale, po ashtu edhe me referenca të organeve të sigurisë për kujdesin dhe përmirësimin e sjelljeve devijante të miturve në institucione arsimore, në disa raste edhe në përmirësimin e raporteve mësues-nxënës-prind-shkollë dhe anasjelltas.

II-Ndërsa sa i përket çështjes së Arsimit gjithëpërfshirës, në arsimin e rregullt-institucione arsimore komunale, kemi të inkuadruar 65 FAMNV për të cilët komuna e jon ka bërë disa lehtësira dhe në vazhdimësi bënë përpjekje për të ndihmuar mbështetjen profesionale për një arsimim dhe edukim të rregullt për ta, në mbështetjen e tyre kemi të angazhuar; pesë(5)Mësues mbështetës dhe katër(4)Asistentë mbështetës në favorin e ngritjes së zhvillimit të tyre arsimore po ashtu edhe në arsimin e hershem në kopshte. Në bazë të rregullores së punës dhe planit zhvillimor të Koordinatorit për Arsim gjithëpërfshirës me kërkesa nga prindërit, nga mësuesit, nga institucioni arsimor për Vlerësime nga ekipi Komunal për Vlerësim të FAMNV me kohë bëhet vlerësimi dhe përcaktohet shkalla e vlerësimit të tyre për integrim të rregullt në institucioni Arsimor në mbështetje të UA, Nr; 16/2017 i cili siguron integrim dhe mbështetje nga institucioni arsimor për fëmijën në proces të rregullt mësimor. Me kërkesa të mësuesve, edukatoreve, asistentëve, apo edhe të prindërve për hartimin e planit PIA, duke marrë në konsideratë kërkesat e tyre në afat kohor, përgatitet plani PIA për secilin fëmijë-nxënës për fushën që ka pengesë në zhvillimin e tyre, kjo ndihmon në një produktivitet të tij/saj për arritjet edukative dhe ngritje në performancën jetësore.

HARTIMI I AKTEVE ADMINISTRATIVE, SHKRESAVE TJERA ZYRTARE LIDHUR ME DREJTORATIN PËR ARSIM DHE INSTITUCIONET ARSIMORE

Konkurse	37
Shpallje të rezultateve të konkurseve.....	21
Vendime të komisioneve intervistuese	26
Vendime për transferim	15
Vendime të lehonisë	34
Aktvendime për pensionim	23
Aktvendime për ndërprerje të marrëdhënies së punës.....	11
Aktvendime e pushimeve pa pagesë.....	10
Vendim, aktvendime të tjera të ndryshme	34
Aktvendime të refuzuara.....	25
Aktvendime të aprovuara.....	155
Njoftime të ndryshme.....	19
Njoftime për ushqim, udhëtim.....	795

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE PËR VITIN 2020

Hartimin e konfirmimeve për borxhe	133
Hartimin e pëlqimeve të ndryshme	34
Hartimin e kërkesave të ndryshme.....	15
Hartimin e ankesave të ndryshme	7
Padi dhe përgjigjeje në padi.....	6

DONACIONET - Edhe këtë vit nuk kanë munguar donacionet: Nga MASHT është siguruar ndërtimi (planifikimi) i palestrës sportive në Poklek. Nga MZHE është siguruar renovimi i SHFMU “Dëshmoret e Drenicës” në Verboc. Kemi siguruar granate nga Banka Botërore në 3 shkolla: SHFMU “Ali Gashi” – Drenas, SHFMU “24 Korriku” në Fushticë, SHFMU “Arif Shala” në Korroticë të Ulët. Nga MASHTI kemi siguruar donacion në vlerë prej 30.000 euro në SHFMU SHFMU “Arif Shala” në Korroticë të Ulët. Donacion nga MAPL janë edhe ndërtimi i dy shkollave: SHMP në Komoran dhe SHFMU në Fushticë të Epërme, ku është duke vazhduar ndërtimi i tyre në fazat e punimeve të vrazhda.

BUXHETI I APROVUAR DHE I SHPENZUAR I SEKTORIT TË ARSIMIT, SIPAS KATEGORIVE EKONOMIKE VITI 2020

Nr	Kodi ek. i nënprogramit	Nënprogrami	Buxheti i aprovuar, Pagat	Mallra & shërbime	Pa paguar nga Thesari	Bilanci	Shpenzime komunale	Subvencione (21)
1	92005	Administrata e Arsimit	76,212.00	313,948.16			0	95,806.00
		Buxheti i shpenzuar	67,839.91	237,705.75	61,949.41	14,293.00	0	92,000.00
		Përqindja e realizimit %	89.01 %	75.71 %	19.73 %	4.55 %	0	96.03

Nr	Kodi ek. i nënprogramit	Nënprogrami	Buxheti I aprovuar, Pagat	Mallra & shërbime nga fondi : Rimëkëmbja ekonomike	Papaguar nga Thesari	Bilanci	Shpenzime komunale	Subvencione
1	92005	Administrata e Arsimit		196,337.30			0	-
		Buxheti i shpenzuar		124,061.01		72,276.29	0	-

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE PËR VITIN 2020

		Përqindja e realizimit %		63.19 %	-	36.81 %	0	-
--	--	--------------------------	--	---------	---	---------	---	---

Nr	Kodi ek.i nënprogramit	Nënprogrami	Buxheti i aprovuar, Pagat	Mallra & shërbime	Pa paguar nga Thesari	Bilanci	Shpenzime komunale	Subvencione
2	92210	Arsimi parafillor-QEAP”Ardhmëria”	125,621.34	21,482.00			6,120.00	-
		Buxheti i shpenzuar	121,099.10	13,018.38	5,614.93	2,848.68	3,134.70	-
		Përqindja e realizimit %	96.40 %	60.60 %	26.14 %	13.26 %	51.22 %	-

Malla dhe shërbime nga të hyrat vetanake (22)2019

Nr	Kodi ek.i nënprogramit	Nënprogrami	Buxheti i aprovuar, Pagat	Mallra & shërbime	Pa paguar nga Thesari	Bilanci	Shpenzime komunale	Subvencione
2	92210	Arsimi parafillor-Qerdhet		6,776.78		-		-
		Buxheti i shpenzuar		6,776.78				-
		Përqindja e realizimit %		100.00 %	-	-		-

Malla dhe shërbime nga të hyrat vetanake(21) 2020

Nr	Kodi ek.i nënprogramit	Nënprogrami	Buxheti I aprovuar, Pagat	Mallra & shërbime	Pa paguar nga Thesari	Bilanci	Shpenzime komunale	Subvencione
----	------------------------	-------------	---------------------------	-------------------	-----------------------	---------	--------------------	-------------

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE PËR VITIN 2020

2	92210	Arsimi parafillor-Qerdhet		14,006.50		14,006.50		-
		Buxheti i shpenzuar		-				-
		Përqindja e realizimit %		%	-	-		-

Nr	Kodi ek.i nënprogr amit	Nënprog rami	Buxheti i aprovuar , Pagat	Mallra &shërbi me	Pa paguar nga Thesari	Bilanci	Shpenzi me komunal	Subvenci one
3	93000	Arsimi fillor	5,066,288.00	283,788.56	145,511.39	31,982.47	61,312.00	-
		Buxheti i shpenzuar	4,352,003.64	106,294.70	-	-	42,410.03	-
		Përqindja e realizimit %	85.90 %	% 37.46	51.27 %	11.27 %	69.17 %	-

Nr.	Kodi ek.i nënprogramit	Nënprogrami	Buxheti i aprovuar, Pagat	Mallra &shërbime	Pa paguar nga Thesari	Bilanci	Shpenzime komunale	Subvencione
4	94200	Arsimi i mesëm	1,259,517.00	75,507.00	37,125.21	1.99	19,625.00	-
		Buxheti i shpenzuar	1,248,156.00	38,379.80	37,125.21	1.99	17,091.25	-
		Përqindja e realizimit %	99.10 %	% 50.83	49.17 %	0.00	87.09 %	-

SHFMU “ALI GASHI” QIKATOVË E RE

PROJEKTE TË BANKËS BOTËRORE 2020

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE PËR VITIN 2020

Bloku kodues	Data e KSH	Përfutuesi/Klient i/Emri I bankës	Obligim	Prd	Kuponi i ditarit	Burimi I dokumentit #	Përshkrim	Debi
04/611/93009/ 13610/00000/0 912	18/9/2020	MIGROS 2 SHPK	2020- 121399	9	2020- 451188	2020- 198559	#344/FURNI ZIM ME LEKTYRA SHKOLLOR E	869.45
04/611/93009/ 13610/00000/0 912	22/12/2020	HYSEN NEZIRI BI	2020- 199931	12	2020- 821165	2020- 361224	#711/FURNI ZIM ME LEKTYRA SHKOLLOR E	632.50
04/611/93009/ 31610/42124/0 912	17/9/2020	HTG SHPK	2020- 111234	9	2020- 447206	2020- 196639	#331/PAJISJ E TE TEKNOLOG JISE INFORMAT IVE	1,250.0 0
04/611/93009/ 31610/42124/0 912	29/10/2020	BEHAR RAMA BI	2020- 149670	10	2020- 552890	2020- 251168	#428/PAJISJ E TEKNOLOG JISE INFORMAT IVE	4,973.0 0
04/611/93009/ 31610/42124/0 912	25/11/2020	FUTURB ETIS SHPK	2020- 166244	11	2020- 638676	2020- 291876	#429/PAJISJ E TEKNOLOG JISE INFORMAT IVE	368.00
								8,092.9 5

SHFMU “ARIF SHALA” KORROTICË E POSHTME

PROJEKTE TË BANKËS BOTËRORE 2020

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE PËR VITIN 2020

Blloku kodues	Data e KSH	Përfutuesi /Klienti/ Emri i	Obligim	Prd	Kuponi i ditarit	Burimi i dokumen tit #	Përshkri m	Debi
04/611/93010/13 610/00000/0912	28/10/2 020	METIJE NEZIRI BI	2020- 122164	10	2020-539429	2020- 245885	#350/Furn izim me lektyra shkollore	789.50
04/611/93010/31 690/42124/0912	27/10/2 020	BEHAR RAMA BI	2020- 121872	10	2020-528255	2020- 237493	#351/Furn izim i shkolles me kabinet te biologjise dhe kimise	3,713.00
04/611/93010/31 610/42124/0912	27/10/2 020	MEDIA TECH PRINT SHPK	2020- 121887	10	2020-528331	2020- 237569	#349/Pais je e teknologji se informati ve	1,430.00
04/611/93010/31 690/42124/0912	15/12/2 020	BEHAR RAMA BI	2020- 187193	12	2020-740690	2020- 325667	#707/Furn izim me paisje te kabineteve	1,838.00
04/611/93010/31 610/42124/0912	22/12/2 020	HYSEN NEZIRI BI	2020- 199914	12	2020-821253	2020- 361276	#708/Furn izim me paisje te teknologji se informati ve	165.00
								7,935.50

SHFMU “24 KORRIKU” FUSHTICË E POSHTME

PROJEKTE TË BANKËS BOTËRORE

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE PËR VITIN 2020

Blloku kodues	Përfituesi /Klienti/ Emri i bankës	Prd	Burimi i dokumen tit #	Përshkrim	Debi
04/611/94226/13610/00000 /0912	METIJE NEZIRI B I	8	2020-155656	#301/Furnizim per zyre	730.00
04/611/94226/31610/42124 /0912	MEDIATECH PRINT SHPK	9	2020-203416	#383/Furnizim me pajisje te teknologjise informative	1,198.00
04/611/94226/31690/42124 /0912	MEDIATECH PRINT SHPK	11	2020-263199	#391/Furnizim me pajisje tjera	1,110.00
04/611/94226/31690/42124 /0912	EUROPRINTY SHPK	11	2020-273152	#382/Furnizim me pajisje tjera	3,483.50
04/611/94226/31610/42124 /0912	MEDIATECH PRINT SHPK	12	2020-301349	#551/Furnizim me paisje teknologjise informative	371.00
04/611/94226/31690/42124 /0912	EUROPRINTY SHPK	12	2020-334919	#709/Furnizim me paisje tjera	356.00
04/611/94226/31690/42124 /0912	MEDIATECH PRINT SHPK	12	2020-334930	#710/Furnizim me paisje tjera	696.00
					7,944.50

INVESTIMET KAPITALE - Gjatë këtij viti kalendarik në drejtorin e arsimit kanë qenë të planifikuara 11 projekte kapitale këtu janë përfshirë disa projekte, mirëpo janë grupuar në mënyrë që të realizojmë më pak shpallje, nga këto projekte 7 kane qenë me burimin e fondeve grante qeveritare (10), dhe 2 kane qenë nga të hyrat vetanake si dhe 2 me kombinimin e të dy burimeve të fondeve (10 dhe 21).

Si pasoj e pandemisë vonesat në alokimin e këtyre fondeve kane ndikuar në zhvillimin me vonesë të projekteve, sepse nuk ka qenë e mundur të zhvillohen procedura pa qene mjetet e alokuara, zotuar. Pasi janë siguruar këto, kemi vazhduar procedurat sipas radhës, ku brenda këtij viti, janë zhvilluar projektet si në vijim.

Projektet si në vijim **nga grantet (10)**

I. Rregullimi i rrethojave të oborreve të shkollave në vlerë (54,138.00€) – është realizuar.

1. SHFMU “Zenel Hajdini” Tërstenik I
2. SHFMU “24- Korriku” Fushticë e Poshtme
3. SHFMU “Rexhep Xheli” Likoshan
4. SHFMU “7 Marsi” Kizhnarekë
5. SHMFU “Hasan Prishtina” Llapushnik
6. SHMFU “Mehmet Gradica” Gradicë

II. Depo për dru dhe thëngjill në këto shkolla dhe vlera kontratës (13,523.80€) – është lidhur kontrata

1. SHFMU “Shaban Polluzha” Korroticë e Epërme
2. SHFMU “Abedin Bujupi” Arllat- Lagjja e Xhamisë

3. SHFMU “Hasan Prishtina” Likoshan

Me këtë kontratë është punuar vetëm në SHFMU “Shaban Polluzha” Korroticë e Epërme, deri te punët e kulmit dhe për shkak të papërgjegjësisë së OE, është ndërpre kjo kontratë, dhe pastaj kemi filluar me shpallje e tenderit për fazën e dytë, janë realizuar të gjitha procedurat mirëpo nuk është lidhur kontratë për fazën e dytë pasi që kanë qenë të gjitha ofertat mbi zotim. Si i tillë ky projekt nuk është realizuar sipas planifikimit.

III. Riparimi i nxehjes qendrore (radiator dhe pajisjeve të tjera përcjellëse në shkolla, vlera e kontratës (7,777.84€) është realizuar.

IV. Furnizimi i shkollave me pajisje të TIK-ut-(297.900.00€) është realizuar, dhe është bërë furnizimi i shkollave me pajisje të TIK-ut:

1. Furnizim me sistemin e kamerave në të gjitha shkollat
2. Furnizim me TV, tabela interaktive
3. Furnizim me kabinete të TIK-ut e zhvilluar në dy faza

V. Renovimi i njejeve sanitare të shkollave (27,888.00€) – është realizuar :

1. Gjymnazi Gjergj Kastrioti Skënderbeu
2. SHFMU “ Gani Sylja” Poklek
3. SHFMU “ Rasim Kiqina” Drenas
4. SHFMU “ Azem Bejta” Shtuticë
5. QEAP “ Ardhmëria” Drenas
6. QEAP Ardhmëria “ Komoran

VI. Inventarizimi i shkollave në Drenas-(126,349.00€) është realizuar dhe është bërë furnizimi i shkollave me Inventar shkollor (karrige, banka) si dhe dollapë për nivelin Klasor (1-5), dollap për secilin nxënës

VII. Renovimi i Objekteve shkollore (kulm dysHEME, dyer dhe dritare)- (52,609.00€) është realizuar :

1. Gjymnazi Gjergj Kastrioti Skënderbeu
2. SHFMU” Rasim Kiqina “ Drenas
3. SHFMU “ Gani Elshani” Krajkovë
4. SHFMU “ Gani Sylja” Poklek
5. SHFMU “ Mehdi e Sylejman Bytyqi “ Arllat
6. SHFMU “ Dëshmorët e Fortesës” Verboc

Projektet si në vijim **nga të hyrat vetanake (21)**

- I. **Furnizimi i shkollave me kabinete për Kimi, Fizikë dhe Biologji –(155.000.00€)** ky projekt është realizuar në dy faza dhe është bërë furnizimi i 12 shkollave me Kabinete për Kimi , Fizikë dhe Biologji.
- II. **Ndërtimi, rrethimi i fushave sportive –** nuk është realizuar, pasi që nuk ka pasur mjete.

Projektet si në vijim **nga grantet (10) dhe nga të hyrat vetanake (21)**

III. Ndërtimi i platove për rreshtimin e nxënësve dhe trotuareve me kubeza (37,600€) – është realizuar:

1. SHMFU “Ali Gashi” Çikatovë e Re

2. SHFMU” Rexhep Xheli” Likoshan
3. SHMFU” Zenel Hajdini” Terstenik I
4. SHFMU “ Shote Galica “ Terdec
5. SHFMU “ Dëshmorët e Fortesës” Verboc

IV. Ngjyrosja dhe suvatimi i objekteve shkollore - ky projekt nuk është zhvilluar sepse nuk kanë qenë komplet mjetet e zotuar. Përveç këtyre projekteve të cilat kanë qenë ta planifikuar edhe në listën e PIP-it, kemi realizuar edhe këto projekte:

1. Laboratori virtual
2. Hapja e puseve për ujë të pijshëm në disa shkolla
3. Furnizimi me material didaktike
4. Furnizimi me material kundër COVID-19 , doreza, dezinfektues, maska, termometër pompa për dezinfektim te objekteve etj.

KOMUNIKIMI ME MASHT-in - Gjatë kësaj periudhe kemi realizuar takime të rregullta me MASHT-in, ku kemi dhënë kontributin tonë me nevojat dhe prioritet tona si DKA në sferën e arsimit. Në çdo mbledhje me drejtorë të drejtorive Komunale për Arsim janë paraqitur kërkesat tona dhe gjithashtu janë marruar detyra nga MASHT-i. Kemi dërguar disa kërkesa për përkrahje të cilat janë në proces: Kërkesë për përkrahje në pako për laboratorë (fizike, kimi, biologji), kërkesa për renovime të tualeteve të shkollave, kërkesa për çerdhe, kërkesa për furnizim me inventarë për klasat parafillor etj.

BASHKËPUNIMI ME BE-në - Gjatë kësaj periudhe kemi zhvilluar takime me përfaqësuesit e BE-së lidhur me donacionin “Ndërtimi i një Kopshti për fëmijë” ku pas këtyre bisedimeve ka pasur zhvillime dhe tani jemi në fazën e fillimit të realizimit të këtij projekti madhor për Komunën e Drenasit. Kemi marrë pjesë në konferencën ndërkombëtare të organizuar nga Parlamenti Evropian, ku gjimnazi ka qenë e vetmja shkolle jashtë vendeve të BE-së pjesëmarrëse në mesin 94 shkollave. Kemi realizuar takime virtuale me vendet si Finlanda, Gjermania, Austria, Zvicra etj, në funksion të shkëmbimit të përvojave lidhur me organizimin e mësimit online dhe me qëllim të përmirësimit të cilësisë në arsim. Janë certifikuar shumica e mësimeve online nga projekti i BE-së implementuar nga GIZ-i në bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit, trajnimet e mësimeve online kanë vazhduar edhe gjatë kësaj periudhe.

VËSHTIRËSITË – Pandemia ka shkaktuar vështirësi të shumta në të gjitha dimensionet, obligimet financiare që dalin nga implementimi i kontratës kolektive (kërkesa të mëdha për shujta). Gjithashtu kemi kërkuar edhe trajnimin e zyrtarëve të administratës me qëllim të ngritjes profesionale në sektorin përkatës. Stafi profesional na mungon në shumicën e shkollave (sekretar, pedagog, psikolog). Në shumicën e shkollave punët administrative, pedagogjike etj, i kryen drejtori i shkollës.

PËRFUNDIM- Jemi të vetëdijshëm për sfidat që kemi përpara vetës, edhe në këtë vit, vetëm e vetëm që në Drenas të ngritet cilësia në arsim, të shtohet disiplina në punë dhe të këtë llogaridhënie në këtë drejtim. Për të krijuar kushte dhe mundësi të reja në rrethanat e reja shtetërore që sot e nesër të kemi shkolla efektive dhe funksionale në kuptimin e plotë të fjalës, vlen që të gjithë të angazhohemi për ta ngritur sa më lartë cilësinë në arsim. Për këtë kemi krijuar një komision i cili ka për detyra të skanoj gjendjen në teren dhe të nxjerr rekomandime në funksion të përmirësimit të cilësisë.

2.3. DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Aktivitetet kryesore në periudhën Janar-Dhjetor 2020	Arritjet/progresi/përformanca kyçe vitit 2020
Aktivitetet kulturore	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka realizuar në tërësi plan-programin e vet të punës dhe për periudhën janar-qershor i ka kryer këto aktivitete: - Raporti vjetor i DKRS-së për vitin 2019 - Raporti gjashtë mujor për vitin 2020 - Kërkesa finale buxhetore - Plani dhe programi i punës për vitin 2021 Aktivitete në Sektorin e Kulturës: - Janë bërë homazhe në Kompleksin e Jasharajve më rastin e 22 vjetorit të sulmit nga forcat serbe ndaj familjes Jashari. - Më rastin e shënimit të 30 vjetorit të rënies së tre dëshmorëve, Enver e Shani Morina dhe Sahit Shala, të rënë në demonstratat e vitit 1990, në sallën e Kulturës, është mbajtur Akademi Përkujtimore. - Manifestimin për 17 shkurtin-Ditën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, filloi duke bërë homazhe tek të gjitha varrezat e dëshmorëve dhe martirëve në komunën e Drenasit, u mbajt një Seancë Solemne e Kuvendit, u dha një program kulturo-artistik me këngë e valle nga SHKA-të e komunës sonë, pika monologësh nga talentet tanë. Gjithashtu u realizua edhe ndeshja miqësore në mes dy klubeve tona të futbollit (KF “Feronikeli” dhe KF “Drenasi”) dhe për fituesin e kësaj ndeshje u dha kupa e pavarësisë. - Homazhe tek varri i heroit dhe pjesëmarrje në Akademinë Përkujtimore për shënimin e 75-vjetorit të rënies së Heroit të kombit Shaban Polluzha. - Më rastin e shënimit të 22-vjetorit të betejës së Likoshanit dhe Qirezit, janë bërë homazhe në varrezat e dëshmorëve në Likoshan dhe Qirez dhe është bërë zbulimi i Pllakës Përkujtimore të Mehmet dhe Naser Gjeli, po ashtu Pllaka Përkujtimore është zbuluar edhe në kullën e Ibrahim Rexhepit. - Më rastin e shënimit të 22 vjetorit të “Epopesë së UÇK-së”, rënies heroike të Familjes Jashari dhe Komandantit Legjendar, Adem Jashari, kemi bërë homazhe në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz, në Kompleksin Memorial të Dëshmorëve në Marinë dhe në Sheshin “Fehmi Lladrovci” në Drenas pranë shtatorëve të Shaban, Hamëz e Adem Jashari. Në shënim të këtij përvjetori është mbajtur edhe Seancë Solemne e përbashkët e dy Kuvendeve Komunale Drenas dhe Skenderaj; - Më rastin e shënimit të 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas, është mbajtur mbledhje solemne.

- Si DKRS në respektim të vendimeve të qeverisë dhe masave tjera mbrojtëse të rekomanduara nga OBSH dhe IKSHPK, për parandalim të përhapjes së pandemisë COVID-19, jemi obliguar të ndërpresim dhe pezullojmë të gjitha aktivitetet kulturore, sportive dhe Rinor;
- Janë bërë homazhe me rastin e 21 vjetorit të rënies së heroit të kombit Ilaz Kodra, 40 dëshmorëve dhe 275 martirëve;
- Janë bërë homazhe me rastin e 21 vjetorit të rënies së heronjve Rasim Kiçina e Ragip Halilaj, pranë shtatores së heroit Rasim Kiçina në sheshin “Fehmi Lladrovci” dhe në Kompleksin Memorial në Marinë.
- Me rastin e shënimit të 21 Vjetorit të Ditës së Çlirimit, qyteti ynë u dekorua me flamuj dhe bilborda me mbishkrim me 11.06.2020 ndërsa me 14.06.2020 u mbajt Seancë Solemne e Kuvendit Komunal për të vazhduar me homazhe te shtatoret e heronjve në sheshin “Fehmi Lladrovci”, Komplekset Memoriale në Prekaz dhe Marinë si dhe homazhe tek të gjitha vendvarrezat e dëshmorëve në komunën tonë (për shkak të situatës pandemike nuk është mbajtur ndonjë aktivitet tjetër festiv);
- Nga momenti i krijimit të gjendjes pandemike, në respektim të masave mbrojtës dhe rekomandimeve të institucioneve kompetente, kemi mundur mbajtjen e seancave të Kuvendit Komunal në Sallën e Kulturës;
- Pjesëmarrje në fillimin e punimeve për konservimin dhe restaurimin e shtëpisë së Fadil Muqollit ku kishte ndodhur masakra e Poklekt, ku ishin vrarë e djegur 53 shqiptarë civil, ndër ta 23 fëmijë.
- Hartimi i Historikut të RFBSH-së.
- Takim pune me komisionin për monitorim të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal.
- Analiza e zhvillimit (realizimit) të planifikimit të Strategjisë së Zhvillimit ekonomik Lokal.
- Plotësimi i tabelës së Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal-DKRS.
- Shqyrtimi i Draftit të Auditimit.
- Specifikimi i pozicioneve të shpërblimeve për Sportistin e vitit-2020.
- Shënimi i 28 Nëntorit, filloi duke bërë homazhe tek të gjitha varrezat e dëshmorëve dhe martirëve në komunën e Drenasit, u mbajt një Seancë Solemne e Kuvendit, u dha një program kulturo-artistik me këngë e valle nga SHKA “Shotë Galica”;
- Realizimi i edicionit të radhës të Festivalit Folklorik “Xheladin Gashi-Plaku”;
- Shënimi me anë të akademisë solemne 112 vjetorin e „Kongresit të Manastirit”;
- Realizimi i Videos sensibilizuese “Say Hi” në bashkëpunim me OJQ ”Shqipet e Drenicës” dhe Hendikos në Drenas, ku në këtë mënyrë i jemi bashkuar fushatës kundër bullizmit;
- Realizimi i videos promovuese për hapësirat e mundshme turistike në komunën tonë;
- Realizimi i Monopërformancës “Hana”;
- Mbajtja e aktivitetit Sportisti Vitit-2020.

Me kërkesë të DKRS-ës kemi arritur të pasurojmë fondin e bibliotekave tona libra të rinjë të cilat i dhuruan:

Biblioteka “Hizi Sulejmani” Prishtinë	611	2020
Libraria “Dukagjini”	434	2020
Autori Bedri Tahiri	7	2020
Teuta Elshani	11	2020
Banori i Komoranit (dhuruesi)	10	2020
Autori Hamit Zogaj	2	2020

Ministria e Kulturës Rinis dhe Sportit	322	2020
Pensionistët	5	2020
Grup vulnetarësh	10	2020
Autorja Medina Kastrati	5	2020

Aktivitetet dhe puna në arkivin komunal:

- 4 certifikata shkollore të lëshuara nga Arkivi;
- 1 palë është pajisur me të dhëna për hulumtim shkencor për punim masteri për periudhën kohore për një muaj nga Arkivi,
- 3 përgjigje iu janë dhënë shkollave së bashku me vendimet e themelimit,
- 5 palë janë shërbyer me kopje të dokumenteve të lokaleve afariste dhe trojeve, **Gjithsejtë: 13 palë** janë pajisur me dokumente që gjenden në arkivin historik, ndërsa 8 kërkesa pas shqyrtimit u është kthyer përgjigje që nuk kemi të dhënat e kërkuara në arkivin historik.
- Pranimin e vendimeve për pjesëmarrje në komisione të ndryshme si:
 - **Tre vendime** të lëshuara nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, vendimi për pranimin e mallrave dhe shërbimeve të ndryshme për DKRS, vendimi për emërim të komisionit për pranimin e inventarit të dhuruar (Karrigeve/1000 copë për Stadiumin Sintetik) nga MKRS tek DKRS, vendim për kontrollimin, verifikimin dhe klasifikimin e dokumentacionit të DKRS-së që gjendet në Objektivin e Vjetër të Komunës.
 - **Pesë vendime** të lëshuara nga Zyra e Kryetarit të Komunës për emërim në komisione të ndryshme jashtë DKRS-së, Vendimi për Vlerësimin e Pasurive Jo Financiare në sektorin e Administratës, Vendim për Negocimi të çmimeve sipas ofertës së BMG ndërtimi i stadiumit “Rexhep Rexhepi” faza e dytë, **Vendim** për vlerësimin e gjendjes faktike dhe nevojës eventuale për renovimin e Stadiumit Sintetik.
 - Pranimin e Vendimit nga Zyra e Kryetarit për ndarjen e Subvencioneve jashtë thirrjes publike
 - **Dy vendime** të lëshuara nga Zyra e Kryetarit të komunës për monitorimin e tetë OJQ-ve dhe Individëve të subvencionuara nga DKRS për monitorimin e aktiviteteve kulturore, pranimin e Raporteve Narrative dhe Financiare.
 - **Tetë vendime** të lëshuara nga Zyra e Prokurimit për pjesëmarrje në komisione të ndryshme vlerësime të tenderëve për periudhën Janar – Dhjetor, “ Ndërtimin e Fushave Sportive dhe Rekreacion”, “Mbindërtimi i Objektivit të ri të Komunës”, “Ndërtimi i kolektorëve për grumbullimin e ujërave të zeza Drenas - Dobroshec”, ”Furnizim me Barëra dhe Material Shpenzues”, “ Rehabilitimi dhe rikonstruimi i rrjetit të Kanalizimeve në Komunën e Drenasit”, “ Rregullimi i Ujërave të zeza në fshatrat Korroticë e Ulët, Korroticë e Epërme. Poklek i Ri, Poklek i Vjetër, Nekoc, Kishnarekë, Sankoc, Fushticë e Ep. Dhe e Ulët”, “Kanalizimi i Ujërave të zeza në dhe Infrastruktura në Komoran –I, II, III dhe IV”, “Ndërtimi i kolektorëve për grumbullimin e ujërave të zeza Drenas faza e dytë ”
- 17 Vendime gjithsejtë** të pranuar për vitin 2020, i emëruar në komisione të ndryshme.
- Skanimin e 300 lëndëve, përpunimin, klasifikimin, evidentimin, e fondeve me Nr. 31, 16, 9, 26, 30, 5, 34, 32, 48; renditjen nëpër dosje vendosjen në kuti, vënien e etiketave dhe vendosjen

- në rafte për ruajtje, përmbajtja e lëndëve, marrëveshje, kontrata procesverbale, raporte, plane, vendime, fleta poseduese, aktvendime etj., të viteve 1957 – 1996.
- Evidentimin e nxënësve në listat e librave nr.7 dhe 8 të fondit nr. 18 Gjinnazit “Gjergj Kastrioti – Skënderbeu”.
 - Rivendosjen e tiketave të kutive në fondin nr. 1 të shkollës fillore “Bashkimi” të Glllogocit, renditjen sipas viteve etj.
 - Vizitë Kalasë së Vuçakut së bashku me Drejtoreshën në kuadër të DKRS-së në shënimin dhe në monitorimin të aktiviteteve në kuadër të Muajit të Rinisë të realizuar nga KVRL.
 - Mbajtjen e tri takimeve të punës me Grupin punues Lokal të Veprimit të zgjedhur me vendim të zyrës së Kryetarit, ku u diskutua për angazhimin e të rinjve në trajnime që do të mbahen në muajt në vijim dhe inkuadrimit të tyre në tregun e vendeve të reja të punës;
 - Pas kontrollimit të fondit është bërë renditja sipas viteve dhe palosjen e librave të amzave dhe e ditarëve të shkollës fillore “ Bashkimi” të Glllogocit.
 - Punët administrative të DKRS-së, dërgimin e kërkesave për punëtorët me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta, kërkesave për pagesë për buqeta lulesh për homazhe bashkëngjitjen e raporteve të pranimit të komisionit.
 - Pjesëmarrje në trajnimin Online, se bashku me zyrtaren e DZHE, të organizuar nga Departamenti i Turizmit lidhur me hartimin e Strategjisë për Zhvillimin e Turizmit.
 - Dërgimin e kërkesave individëve dhe OJQ-ve të Subvencionuar nga DKRS për të na sqaruar mbajtjen e aktiviteteve kulturore në komunën e Drenasit, për të na raportuar me ecurit e aktiviteteve, dërgimin e raporteve Narrative dhe Financiare pas përmbylljes së projektit.
 - Përgatitjen e sallës dhe organizimin e aktivitetit kulturor “Kongresi i Manastirit” se bashku me punëtorët e DKRS-së.
 - Përgatitjen e kërkesave se bashku me zyrtaren administrative të DKRS-së për material shpenzues, për Stadiumit Sintetik, materialin për DKRS dhe përgatitjen e raporteve të komisionit për pranimin e materialit shpenzues për DKRS.
 - Pas pranimit të vendimit nga DKRS kemi filluar me punën e komisionit në përpunimin e lëndëve të DKRS-së që është marra në zyrën DKRS-së në objektin e vjetër të komunës, ndarjen e lëndëve të pa vlerë, renditjen sipas llojit të lëndëve, evidentimin e tyre në kompjuter etj.
 - Pjesëmarrje në organizimin e aktivitetit për zgjedhjen sportistit të vitit 2020, i organizuar nga DKRS.

Bibliotekat në Komunën e Drenas gjatë kësaj periudhe ka regjistruar dhe ka pasur lexues për gjysmëvjetorin e parë të vitit-2020

Muaji- Janar- Qershor 2020	Nr. i ekzemp.	Nr i titujve	Ekzemplar të ri	Libra të lexuara	Nr. i lexuesve	Lexues të ri	Gjithsejt ë lexues
Drenas	7750	2847	942	1226	162	57	404
Terstenik	4229	-	120	-	-	-	-
Arllat	5134	935	182	479	362	4	106

	Komorani	3180	1823	173	306	178	37	178
	TOTALI	20293	5605	1417	2011	702	98	688
Aktivitete sportive	Sektori i Sportit e ka realizuar plan-programin e vetë të punës dhe për periudhën janar-qershor ka zhvilluar këto aktivitete. - Në kuadër të planifikimit të punëve dhe aktiviteteve të zhvilluara në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, përkatësisht Sektorit të Sportit janë kryer këto punë – aktivitete sportive: - Janë zhvilluar takime me klubet dhe shoqatat sportive për plotësimin e dokumentacionit-formularëve dhe raportimit për subvencionimin e aktiviteteve sportive; - Pjesëmarrje në komisione të ndryshme në bazë të vendimit të kryetarit të komunës; - Kemi bashkëpunuar edhe me Drejtoratin të Arsimit për koordinimin për aktivitetin për shënimin e garave të Shkollave Fillore të Mesme të Ulëta dhe Shkollave të Mesme të Larta, për disa disiplina sportive, ku për fituesit janë ndarë shpërblime (kupa, medalje, mirënjohje, fanella sportive); - Janë zhvilluar garat Komunale sipas kalendarit të garave të Federatës së Sportit Shkollor për Sh.F.M.U-të dhe Sh.M.L-të; - Janë ndihmuar klubet në transportin e lojtarëve të klubeve për zhvillimin e Lojërave kampionale, pjesëmarrje në ngjarje të organizuara nga Federate e Çiklizmit; - Në palestrën sportive „Hysni Jetullahu” me datë 23.02.2020 u mbajt aktiviteti sportiv Kupa e Pavarësisë 2020-Indor nga Federata e Shigjetarisë së Kosovës; - Jemi përgjigjur kërkesave të ndryshme nga klubet tona sportive, iu është dhënë përgjigja adekuate në bazë të ligjeve, udhëzimeve administrative dhe rregulloreve; - Zyrtari i sportit ka bashkëpunuar dhe prezantuar në mbledhjet, kuvendet e mbajtura nga klubet sportive, seanca stërvitore sipas orarit të përcaktuar nga DKRS për klubet në objektet sportive dhe ndeshje kampionale të zhvilluara gjatë këtij viti nga federatat përkatëse; - Zyrtari i sportit ka bashkëpunuar me zyrtarët e objekteve sportive, në mbarëvajtjen dhe respektimin e rregulloreve për objektet sportive; - Është rinovuar objekti i stadiumit sintetik; - Mbikëqyrje fushat sportive (Komoran, Polluzhë dhe Damanek) që janë në menaxhimin e DKRS dhe ka bërë kërkesa për renovimin e tyre në pjesët ku janë dëmtuar; - Zyrtari i Sportit si organ mbikëqyrës është bërë raporti për pagesën në projektin „Dekorimi i Qytetit”; - Me mbështetjen teknike të ofruar nga ne është realizuar pjesëmarrja e çiklistëve tanë në aktivitetin “Me një biçikletë s’ vjen vera” organizuar nga Federata e Çiklizmit e Kosovës;							

- Me vendimin e Ministrisë së Shëndetësisë të gjitha aktivitetet sportive dhe ato shkollore dhe të klubeve sportive janë ndërprerë për shkak të përhapjes së virusit Covid-19, nga dt.14.03.2020 deri me vlerësimin e fazës së dytë,
- Është bërë pastrimi dhe dezinfektimi brenda në objekteve sportive, Stadiumin Sintetik, Palestër Sportive si dhe janë pastruar hapësirat jashtë;
- Kam marrë pjesë në komisionet e ndryshme në Drenas, në bazë të vendimit të kryetarit të komunës në bazë të vendimit të zyrës së prokurimit;
- Në bashkëpunim me KOK është zhvilluar aktiviteti sportiv me fëmijët e lindur në vitin 2008 për shënimin e Ditës Ndërkombëtare Olimpique dhe kështu videoja e shënimit të këtij aktiviteti nga KOK-u u vlerësua me vendin e gjashtë në garë e të gjitha komunave;
- Në bashkëpunim me MKRS-Departamentin e Sportit, qarkorja-udhëzime për përmbushjen e obligimeve ligjore që rregullojnë punët e kuvendeve të klubeve sportive, janë të njoftuara t'i përmbahen kësaj qarkoreje;
- Është realizuar Dita Botërore e Ecjes, në të cilën morën pjesë të rinjtë, klubet sportive, personat me nevoja të veçanta dhe të gjithë qytetarët të cilët kanë shprehur interesim të jenë në aktivitet;
- Në bashkëpunim me Federatën e Sporteve Shkollore dhe Ministrinë e Kulturës, Rinis dhe Sportit kemi realizuar “Javën Evropiane të Sportit” me 100 fëmijë pjesëmarrës;
- Janë themeluar klube të reja sportive në sportet e Çiklizmit, Karatesë, Ngjitjes;
- Është mbajtur manifestimi i zgjedhjes së sportistit të vitit 2020;
- Zyrtari i sportit ka kryer edhe detyra tjera të ngarkuara nga Drejtoresha e DKRS-së;

Rangu që klubet kanë bërë gara 2020

1. Klubi Publik i Futbollit Feronikeli - Superliga e futbollit e Kosovës,
2. Klubi i Hendbollit Drenica -Superliga e hendbollit e Kosovës,
3. Klubi Volejbollit "Gryka" (f)- Superliga e volejbollit e Kosovës,
4. K.Volejbollit,, Feronikeli"(f)-Superliga e volejbollit e Kosovës,
5. Klubi i Basketbollit Feronikeli 2018 – liga e Parë e basketbollit e Kosovës,
6. Klubi Publik i Futbollit Drenasi - Liga e Parë e futbollit e Kosovës,
7. Klubi Futsall „Liqeni”- Superliga e Futsallit e Kosovës,
8. Klubi i futbollit “Fortuna”, pjesëmarrje në turnirë memorialë,
9. Klubi i Shigjetarisë Ferronikeli,- Sistem Turneve
10. Klubi i Shenjjetarisë dhe Shigjetarisë,, Qëndrsa” Sistem Turneve
11. Klubi i Boksit „Drenasi” – Drenas, Sistem Turneve
12. Klubi i Shahut „Drenasi”-Drenas, Sistem Turneve
13. Klubi i Ngjitjes "Ketrat" –aktivitete të ndryshme në terren,
14. Klubi i shahut „ Drenasi” femrat - Sistem Turneve
15. Klubi i Karatesë, “Drenasi”- Sistem Turneve
16. Klubi i Çiklizmit „Komobike”- Sistem Turneve

Stadiumi Sintetik – Drenas

Raporti vjetor Janar-Dhjetor

Nr	Muaj	Stërvitjet	Orë	Nr. i Lojtarëve	Nr. i shikuesve	Ndeshje Kampionale
1.	Janar	117	144.45	3183	1042	7
2.	Shkurt	157	201.20	4758	1594	26
3.	Mars	87	111.10	2536	796	11
4.	Prill	Ndërpriten të gjitha aktivitetet si masë parandaluese ndaj Virusit COVID-19				
5.	Maj	Ndërpriten të gjitha aktivitetet ,si masë parandaluese ndaj Virusit COVID-19				
6.	Qershore	42	57.30	934		
7.	Korrik	180	210.40	6356		18
8.	Gusht	Është respektuar Vendimi i Qeverisë dhe Ministrisë e Shëndetësisë të Kosovës, që ka marrë vendim që të mbyll palestrat sportive të tipit të hapur dhe të mbyllur.				
9.	Shtator	Është respektuar Vendimi i Qeverisë dhe Ministrisë e Shëndetësisë të Kosovës, që ka marrë vendim që të mbyll palestrat sportive të tipit të hapur dhe të mbyllur.				
10.	Tetor	217	259.15	7364		33
11.	Nëntor	151	209.10	5633		25
12.	Dhjetor	131	181.55	5149		41
13.	Dëmet në Objekt					
14.	Përmbledhje e aktiviteteve	1082	1375.45	35913	3432	161

- Më datën 14.03.2020, nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, në respektim të vendimeve të Qeverisë së Kosovës, si masë parandaluese ndaj përhapjes së virusit COVID-19, jemi njoftuar për ndërprerje të të gjitha aktivitetet kulturore, sportive dhe rinore, në objektin sportive publik. Ky njoftim ka qenë i vlefshëm deri me 22.06.2020, ndërsa pas kësaj date jemi njoftuar se në fazën e III të lehtësimit të masave qeveritare, lejohet zhvillimi i aktiviteteve sportive duke respektuar disa prej masave mbrojtëse të specifikuar Manualit për Mbrojtje nga Përhapja e Virusit COVID-19;
- Është dezinfektuar objekti, janë vendosur dezinfektues dhe mbishkrime për respektim të masave mbrojtëse në vende të qasshme në objekt;
- Janë lejuar aktiviteteve stërvitore dhe ndeshjeve përkatësisht për klubet e futbollit të Superligës. është lejuar mbajtjen e aktiviteteve stërvitore për klubin e KF "Feronikeli" dhe KFF "Feronikeli". Njoftimi i radhës nga DKRS, që objektet sportive mund te shfrytëzohen nga data 22.06.2020. Klubet janë përgjegjës për marrjen e të gjitha masave mbrojtëse dhe zbatimin e manualit për mbrojtje nga Përhapja e Virusit COVID-19,
- Kemi forcuar e drejtuar shtyllat e rrethojës;
- Kemi pastruar brena dhe hapësirat për rreth objektit të Stadiumit Sintetik,
- Janë pastruar dhe kositur hapësirat e gjelbra tek Objekti i Qendrës Kulturore për Gruan;
- Në fillim të muajt gusht Qeveria prapa miraton masa te reja për parandalimin e pandemisë Covid-19, pra anulohen aktivitete sportive deri me datën 25.09.2020, ku nga kjo datë e tutje lejohen mbajtja e aktiviteteve sportive në respektim të Manualit.

	Palestra e Sportit “Hysni Jetullahu” – Drenas						
	Nr	Muaj	Stërvitjet	Orë	Nr. i Lojtarëve	Nr. i shikuesve	Ndeshje Kampionale
	1.	Janar	31	51	386	-	-
	2.	Shkurt	80	124	1257	30	1
	3.	Mars	55	98	1144	310	6
	4.	Prill	Ndërpriten të gjitha aktivitetet si masë parandaluese ndaj Virusit COVID-19				
	5.	Maj	Ndërpriten të gjitha aktivitetet si masë parandaluese ndaj Virusit COVID-19				
	6.	Qershor	7	14	81	80	2
	7.	Korrik	28	51	495	-	3
	8.	Gusht	-	-	-	-	-
	9.	Shtator	9	14	142	-	-
	10.	Tetor	80	138	1490	-	10
	11.	Nëntor	100	181	1938	-	12
	12.	Dhjetor	55	130	936	-	14
		Përmbledhje e aktiviteteve	445	801	7872	420	48
		Dëmet në Objekt	Nuk ka dëme në këtë periudhë				
	Raporti vjetor Janar-Dhjetor						
Aktivitetet rinore	Sektori i Rinisë në bashkëpunim me KVRL-në gjatë kësaj periudhe ka zhvilluar këto aktivitete:						
	- Realizimi i sesionit informues në lidhje me punëtorinë “Podium” e cila do të realizohet me përkrahje të Peer Education Network-PEN, ky aktivitet ka për qëllim zhvillimin e aftësive për avokim dhe lobim të adoleshentëve në mënyrë që ata të mund të përmirësojnë kushtet e komuniteteve ku ata jetojnë; - Është mbajtur sesion informues për punëtorinë UP-Shift; - Në bashkëpunim me të Rininë Aktive të Gjakovës dhe financim të GIZ-it, është realizuar trajnimi i cili ka për qëllim t’i aftësojë të rinjtë që të shkruajnë saktë CV-në, letrën motivuese si dhe përgatitja e tyre për një intervistë pune; - Me tu shpallur gjendje emergjente e shëndetit publik pas përhapjes së pandemisë COVID në shtetin tonë, kemi realizuar një fushatë sensibilizuese për vetëdijesim të qytetarëve që ata të respektojnë rekomandimet e institucioneve relevante që trajtojnë pandeminë; - Në bashkëpunim me vullnetaren amerikane e cila për shkak të pandemisë ka shkuar në Amerikë, në formë virtuale kemi realizuar ligjëratën online me temën “Lidershipi dhe strategjia si të qëndrojmë në shëndetshëm në shtëpi” e cila ka qenë e qasshme për të gjithë të rinjtë; - Realizimi i takimeve online me strukturat e KVRL-ës; - Mbrëmje Humanitare; - Trajnim-Promovimi i aftësive për punësim të të rinjve;						

	- Ligjëratë-Aktivizimi vullnetar dhe roli i nxënësve nëpër shkolla; - Ditët e Rinis, aktivitet simbolik-Balonat fluturues- Lirimi i energjisë negative; - Vizitë studimore ne Kalanë e Vuçakut; - Mbrëmje Rinore në Liqenin e Vasilevës; - Dita Botërorë e Pastrimit; - Pjesëmarrje në Ditën Botërore të Ecjes; - Trajnim për Lidership, mendim kritik dhe menaxhim të kampanjave; - Realizimi i projektit Green Saver-Sensibilizim i opinionit në raport me natyrën dhe ruajtjen e saj; - Ligjëratë – Çrregullimi i spektrit të autizimit; - Dhurata për fundvit për fëmijët e Handikosit dhe vullnetar; - Realizimi i trajnimit dhe certifikimi i dhjetëra të rinjve nga Ministria e Zhvillimit Rajonal për ndërmarrësi;															
Projektet kapitale	Në kuadër të projekteve kapitale në gjashtëmuorin e parë të 2020 kemi pasur pengesa në realizimin e tyre për shkak të pandemisë, por prapë ka pasur zhvillim të punimeve kështu kemi këto projekte të zhvilluara në këtë periudhë: - Vazhdimi i ndërtimit të Stadiumit “Rexhep Rexhepi”; - Realizimi i projektit të Renovimit dhe Inventarizimit Qendrës Rinore; - Renovimi i pjesshëm i kulmit të Stadiumit Sintetik, si projekt kapital emergjent; - Renovimi i Stadiumit Sintetik, faza e parë e punimeve; - Ndërtimi i dy fushave sportive dhe renovimi i tre fushave të tjera;															
Ndarja e subvencioneve 2020	Gjatë kësaj periudhe janë subvencionuar OJQ-kulturore, sportive, rinore dhe individ MJETE TË NDARA PËR AKTIVITETE KULTURORE-2020 <table><tr><td>Emri i OJQ-së përfituese, dhe personave fizik</td><td>Emri i projektit dhe /ose programit apo aktiviteteve të financuara</td><td>Shuma e dhënë (Euro)</td></tr><tr><td>ShKA "Shote Galica"</td><td>Mbështetje financiare për aktivitetin e SHKA "Shote Galica"</td><td>2000 €</td></tr><tr><td>OJQ “Shqipet e Drenicës”</td><td>Mbështetje financiare për aktivitetin e OJQ “Shqipet e Drenicës”</td><td>2500 €</td></tr><tr><td>SHKA “Komorani”</td><td>Mbështetje financiare për SHKA “Komorani”</td><td>500 €</td></tr><tr><td>Nuredin Ibriqaj</td><td>Mbështetje financiare për botimin e monografisë</td><td>500 €</td></tr></table>	Emri i OJQ-së përfituese, dhe personave fizik	Emri i projektit dhe /ose programit apo aktiviteteve të financuara	Shuma e dhënë (Euro)	ShKA "Shote Galica"	Mbështetje financiare për aktivitetin e SHKA "Shote Galica"	2000 €	OJQ “Shqipet e Drenicës”	Mbështetje financiare për aktivitetin e OJQ “Shqipet e Drenicës”	2500 €	SHKA “Komorani”	Mbështetje financiare për SHKA “Komorani”	500 €	Nuredin Ibriqaj	Mbështetje financiare për botimin e monografisë	500 €
Emri i OJQ-së përfituese, dhe personave fizik	Emri i projektit dhe /ose programit apo aktiviteteve të financuara	Shuma e dhënë (Euro)														
ShKA "Shote Galica"	Mbështetje financiare për aktivitetin e SHKA "Shote Galica"	2000 €														
OJQ “Shqipet e Drenicës”	Mbështetje financiare për aktivitetin e OJQ “Shqipet e Drenicës”	2500 €														
SHKA “Komorani”	Mbështetje financiare për SHKA “Komorani”	500 €														
Nuredin Ibriqaj	Mbështetje financiare për botimin e monografisë	500 €														

	Genc Heta	Mbështetje Financiare për shfaqje teatrale	700 €
	Shkumbin Veseli	Mbështetje financiare për promovim te kulturës rurale	700 €
	Elhami Gjeli	Mbështetje financiare për realizimin e një filmi të shkurtër	1000 €
	Albert Sinani	Mbështetje financiare për ekspozitë me fotografi	1000 €
	MJETE TË NDARA PËR AKTIVITETET RINORE-2020		
	Emri i OJQ-së përfituese, dhe personave fizik	Emri i projektit dhe /ose programit apo aktiviteteve të financuara	Shuma e dhënë (Euro)
	OJQ Këshilli i veprimit rinor lokal në Drenas	Mbështetje financiare për zhvillimin e aktiviteteve rinore	
	MJETE TË NDARA PËR AKTIVITETE SPORTIVE-2020		

Emri i OJQ-së përfituese, dhe personave fizik	Emri i projektit dhe /ose programit apo aktiviteteve të financuara	Shuma e dhënë (Euro)
KF ''Feronikeli''	Mbështetje financiare për zhvillimin e aktiviteteve sportive	40000 €
KH ''Drenica'' (M)	Mbështetje financiare për zhvillimin e aktiviteteve sportive	8000 €
KV ''Feronikeli'' (F)	Mbështetje financiare për zhvillimin e aktiviteteve sportive	2000 €
Klubi i Shigjetarisë ''Feronikeli''	Mbështetje financiare për zhvillimin e aktiviteteve sportive	1000 €
KF ''Drenasi''	Mbështetje financiare për zhvillimin e aktiviteteve sportive	6000 €
KB ''Feronikeli''	Mbështetje financiare për zhvillimin e aktiviteteve sportive	6200 €
Klubi i Ngjitjes Ketrat	Mbështetje financiare për zhvillimin e aktiviteteve sportive	1000 €
''Shoqata e të Shurdhërve''	Mbështetje për aktivitetin e Shoqatës së Shurdhërve	500 €
Neë Stars Soccer School	Mbështetje financiare për zhvillimin e aktiviteteve sportive	300 €

Gjithashtu ashtu siç e mundëson rregullorja MF-NR-04/2017 që deri në 5% të ndarjes buxhetore/totalit të subvencioneve, mund ta ndajmë jashtë thirrjes publike, kemi aprovuar kërkesat e ardhura në drejtori për mbështetje financiare.

Përfitues të subvencioneve jashtë thirrjes publike ishin:

Sektori Kulturë:

Emri i OJQ-së përfituese, dhe personave fizik	Emri i projektit dhe /ose programit apo aktiviteteve të financuara	Shuma e dhënë (Euro)
Riza Greiçevci	Mbështetje financiare për botimin e librit	500€

Sektori Sport:

Emri i OJQ-së përfituese, dhe personave fizik	Emri i projektit dhe /ose programit apo aktiviteteve të financuara	Shuma e dhënë (Euro)
KV “Gryka”	Mbështetje financiare për zhvillimin e aktiviteteve sportive	500€
Klubi i Shahut “Drenasi” m	Mbështetje financiare për zhvillimin e aktiviteteve sportive	500€
Klubi i Shahut të femrave të Drenasit	Mbështetje financiare për zhvillimin e aktiviteteve sportive	500€
AMKK “Drenica Racing”	Mbështetje financiare për zhvillimin e aktiviteteve sportive	500€
Klubi i Boksit ”Drenasi”	Mbështetje financiare për zhvillimin e aktiviteteve sportive	500€

Disa prej aktiviteteve të paraqitura përmes fotografive



Figurë 1. Edicioni i 1-të i Festivalit



“Drenasi Fest 2020”

Figurë 2. Dita e të Rinjve të Drenasit



Figurë 3 dhe 4. 112 vjetori i “Kongresit të Manastirit”



Figurë 5. Certifikimi i të rinjve në fushën e ndërmarrësisë



Figurë 6. Shënimi i Ditës Ndërkombëtare për Personat e Pagjetur



Figurë 7. Dita Botërore e Ecjes



Figurë 8. Dita Ndërkombëtare e Gruas



Figurë 9 dhe 10. Ekspozita Në 160 fotografitë e shkrepura nga fotografi Albert Sinani financuar nga DKRS



Figurë 10 dhe 11. Realizimi i garave komunale në disa disiplina sportiv



Figurë 12,13 dhe 14. Investimet në infrastrukturën sportive



Figurë 15, 16 dhe 17. Dezinfektimi dhe mirëmbajtja e hapësirave sportive



Figurë 18. Aktivitet kulturor



Figurë 19. Vizitë Kalasë së Vuçakut



Figurë 20 dhe 21 Shënimi i Javës Evropiane të Sportit



Figurë 22. Monopërformaca “Hana”



Figurë 23. Video promovuese për turizëm



Figurë 24 Fushata Sensibilizuese kundër bullizmit “Say hi”

2.4. DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL (DBPZHR)

Kjo Drejtori gjatë kësaj periudhe një vjeçare (për vitin 2020) ka kryer punët dhe detyrat në të gjitha lëmit përkatëse që janë kompetencë e saj, në bazë të Statutit të Komunës ku është obligim dhe përgjegjësi e kësaj Drejtorie, që të zbatojë dispozitat ligjore lidhur me të gjitha lëmit që janë në kompetencë të saj:

Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (DBPZHR) në kuadër të kompetencave, autorizimeve dhe përgjegjësi të saja funksionon në zbatim të drejtpërdrejt të ligjeve:

- Ligjin për tokën bujqësore Nr.02/L-26 ;
- Ligjin për mbrojtjen e bimëve Nr.02/L-95 ;
- Ligji për Shërbime Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural – Nr.04/L-074
- Ligjin për Gjuetinë Nr.02/L-53 ;
- Ligjin për Bletarin Nr.02/L-111 ;
- Ligjin për kujdesje ndaj kafshëve Nr.02/L-10 ;
- Ligjin për pyjet e Kosovës Nr.2003/3 ;
- Ligjin 03/L-153 Për ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit Nr.2003/3 për Pyjet e Kosovës.

Në Komunën e Drenasit, bujqësia po shndërrohet në një sektor të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik dhe duke pasur parasysh kushtet e volitshme si nga aspekti pedologjik po ashtu edhe në atë klimatik. Duke pas parasysh këta faktor komuna e Drenasit ka për qëllim që të zgjerojë kapacitetin e zhvillimit bujqësor ku përmes saj do të hapen vende të reja të punës e po ashtu si qëllim kryesor do të jetë rritja e prodhimeve vendore dhe ulja e importit.

SEKTORI I BUJQËSISË DHE SEKTORI I ZHVILLIMIT RURAL KA KRYER KËTO PUNË:

- Këshillime për fermerë për të gjitha sektorët e bujqësisë;
- Këshillime, udhëzime fermerëve rreth aplikimit për Grande në MBPZHR, në sektorët e ndryshëm.
- Këshillime fermerëve rreth aplikimit për subvencione në pagesa direkte në sektorët e ndryshëm të bujqësisë.
- Regjistrimi i fermerëve të rinjë në regjistrin e fermës (NIF).
- Është bërë lëshimi i Certifikatës së fermeri (NIF) dhe informatave përcjellëse të fermerit-(ANEXI)
- Është bërë pranimi i kërkesave të ndryshme të fermerëve në sektor të bujqësisë :
 - 124 kërkesa për vlerësim të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore;
 - 279 kërkesa – aplikuese në 3 projektet e drejtorisë ;
 - 10 kërkesa të ndryshme të fermerëve, është bërë raporti i vlerësimit për secilin fermer dhe kthimi i përgjigjeve.
- Është bërë planifikimi dhe realizimi i të mbjellurave pranverore **2020** (të planifikuara **3628 ha** ku prej tyre janë realizuara **3398 ha**).
- Është bërë planifikimi dhe realizimi i të mbjellurave vjeshtore **2020/2021** (të planifikuar **3800 ha** ku prej prej tyre janë realizuar **3326.00 ha**).
- Përgatitja rreth Korrje –Shirjëve, bashkëpunim me MBPZHR, auto-kombajnerët, fermerët dhe pikat grumbulluese të drithërave në territorin e Komunës së Drenasit.

➤ Çmimi i korrje -shirjeve ka qenë **90 € për ha**

- Kompania – Ndërmarrja “**IBËR LEPENC**” Njësia e Punës në Komoran gjatë këtij viti ka punuar në rregullimin e rrjetit të ujitjes dhe ndërrimin e pjesëve të dëmtuar në rrjet në mënyrë që të zgjerohen sipërfaqet e ujitura ,tani rrjeti i ujitjes është i aftësuar me **2970 ha**, ndërsa sipërfaqet të ujitura për vitin 2020 janë **mbi 142.20 ha**
- Është bërë vlerësimi dhe ekspertizat e dëmeve në kulturat e ndryshme bujqësore nga fatkeqësitë natyrore si erërat e forta, bora, breshëri.
- Punim në komisionin për hartimin e planit për vlerësimin e rrezikshmërisë për Komunën e Drenasit 2020-2024.
- **Punim** për planin për zbatimin e strategjisë për Zhvillimin Ekonomik Lokal (Programi komunal për banim 2020-2025)
- Punim në komisionin për Hartimin e Strategjisë për Zhvillimin Ekonomik Lokal të Komunës së Drenasit
- Punim në komisionin për përpilimin e planeve Lokale Zhvillimore
- Punim në komisionin për Pëlqime Mjedisore Komunale
- Punim në komisione për shqyrtimin e konkurseve, Marrëveshje për shërbime të veçanta dhe zhvillimin e procedurave për vende të lira të punës
- Punim në komisionin për Arsim dhe Shëndetësi për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për nëpunësit që punojnë në sektorin publik të cilët nuk janë shërbyes civil
- Janë kryer punë shtesë nga zyrtarët e drejtoratit tonë në bazë të vendimit të zyrës së Kryetarit.

Projektet nga Komuna

➤ Perimtari

Furnizimi i fermerëve me Serra me sipërfaqe 50 m²

Në këtë projekt kanë aplikuar 143 fermer dhe kanë përfituar gjithësej 65 fermer me vlerën totale të projektit **24,528,40€** . Projekti ka qenë me Financim të Komunës 70 % dhe Participim nga fermeri 30% .

➤ Blegtori

Furnizimi i fermerëve me mikser për ushqimin e kafshëve 2.0m³

Në këtë projekt kanë aplikuar gjithsej 22 fermer dhe kanë përfituar gjithsej 14 fermer me vlerën totale të projektit **33,432.00 €**, ky projekt ka qenë me Financim të Komunës 70% dhe Participim të fermerit 30% .

➤ Bletari

Furnizimi i fermerëve me centrifugë mekanike me 4 korniza

Ky projekt është realizuar në dy faza për arsye se në fazën e parë fermerët aplikues nuk kanë plotësuar kriteret e thirrjes. Në fazën e parë kanë aplikuar 86 aplikues dhe kanë përfituar 61 fermerë mirëpo një fermerë është tërhequr nga përfitimi i pajisjes. Në fazën e dytë kanë aplikuar 28 fermerë dhe kanë përfituar 19 fermerë, numri i përgjithshëm i fermerëve përfitues në këtë projekt është 79 . Vlera totale e projektit është **9,875.00 €**.

Projektet nga MBPZHR në bashkëpunim me Komunën

Është bërë informimi i fermerëve për aplikim rreth grandeve, subvencioneve për pagesa direkte: Grurë, Farë Gruri, Elbit, Thekrës, Misër, Luledielli, Vreshta, Pemë, për prodhimin Fidanor të Pemëve , Perime në fushë të hapur , Lopë dhe Buallica Qumështore, Dele, Dhi, Bletari, Pula Vojse, Dosa në Riprodhim, Bimë Mjekues Aromatike, Bujqësi Organike dhe Thëllëza.

Është bërë DIGJITALIZIMI i parcelave të mbjellura me kultura të ndryshme , janë bërë të gjitha pranimet e aplikacioneve të fermerëve që kanë aplikuar në programet e ndryshme për subvencionime nga MBPZHR , janë kompletuar dokumentacionet dhe janë dërguar në AZHB , gjithsej 861 aplikacione të fermerëve aplikues në të gjithë sektorët e bujqësisë Pemëtari, Perimtari, Lavërtari, Blegtori, Bletari, Shpeztari etj.

- **Subvencionimi i të mbjellurave me grurë**, është bërë digjitalizimi i parcelave **1730.21 ha** , subvencionimi për 1 hektar ka qenë **300€**.
- **Subvencionimi i të mbjellurave me elb**, është bërë digjitalizimi i parcelave **22.85 ha** , subvencionimi për 1 hektar ka qenë **300€**.
- **Subvencionimi i të mbjellurave me thekër**, është bërë digjitalizimi i parcelave **7.47 ha** , subvencionimi për 1 hektar ka qenë **300€**.
- **Subvencionimi i të mbjellurave me tërshërë**, është bërë digjitalizimi i parcelave **62.87 ha**. subvensioni për 1 hektar ka qenë **300€**
- **Subvencionimi i të mbjellurave me misër**, është bërë digjitalizimi i parcelave **1117.08 ha**, subvencionimi për 1 hektar ka qenë **300€**.
- **Subvencionimi i Plantacioneve me pemë**, është bërë digjitalizimi i parcelave **142.15 ha**, subvencionimi për 1 hektar ka qenë **800€**.
- **Subvencionimi i Perimkulturës - (në fushë të hapur)**, është bërë digjitalizimi i parcelave **63.05 ha**, subvencionimi për 1 hektar ka qenë **600€**.
- **Subvencionimi i BMA-së -**, është bërë digjitalizimi i parcelave 3.85 ha subvencionimi për 1 hektar ka qenë **300€** ,

Subvencionet: Blegtori (Lopë, dele, dhi) bletari

- **Subvencionimi i lopëve qumështore** – Fermerët kanë aplikuar për **1.489** krerë lopë qumështore, subvencionimi për 1 lopë qumështore ka qenë **140 €**.
- **Subvencionimi i deleve**, Fermerët kanë aplikuar për **5.173** krerë dele, subvencionimi për 1 dele ka qenë **35 €**.
- **Subvencionimi i dhive**, Fermerët kanë aplikuar për **214** krerë dhi, subvencionimi për 1 dhi ka qenë **35 €**.
- **Subvencionimi i shoqërive me bletë** Fermerët kanë aplikuar për **5.990** koshere bletë, subvencionimi për 1 koshere ka qenë **30 €**.

Subvencionet: Shpeztari

- **Subvencionimi i fermerëve për pula Vojse** ka aplikuar 1 fermerë për **17000** copa pula Vojse
- **Subvencionimi i fermerëve për thëllëza** ka aplikuar 1 fermerë me **26200** copa

Subvencionimi për qumësht/litër sipas kategorive të cilësisë

- Kanë aplikuar 37 fermer për qumësht/litër për gjashtëmuorin e parë sipas kategorive: **Ekstra klasë 0.12 €, Klasa e parë 0.08€, Klasa e dytë 0.04€ Gjithsej: 691,268.00 litra**

Projektet nga Memorandum bashkëpunimi në mes të OJQ- SocialCreativity në bashkëpunim me Komunën e Drenasit

Ky projekt është realizuar për të mbështetur gratë e marginalizuara të cilat janë të regjistruara në Qendrën për Promovimin e të Drejtave të Grave. Përfutuese të këtij kanë qenë 6 gra.

Trajnimet nga IADK , ESG, BB, AUVK, USAID, KDC

- Organizata IADK, ESG, AUVK, USAID, KDC kanë mbajtur trajnime për ngritjen e kapaciteteve të fermerëve në fushat e ndryshme të bujqësisë si Pemëtari , Perimtari, Blegtori, Bletari , Lavërtar , Përpunim i Teknologjisë Ushqimore etj.
- Me IADK-janë mbajtur trajnime si dhe vizita tek fermerët përfitues në programin: Mbështetja e zinxhirit të vlerave për Bimë Mjekësore Aromatike përmes krijimit punësimit dhe vazhdim të eksportit të mbështetur nga GIZ-i Gjerman ;
- Me IADK-janë mbajtur trajnime si dhe vizita tek fermerët përfitues në programin për të riatdhesuar të mbështetur nga GIZ-I Gjerman;
- IADK ka mbajtur trajnim me fermerët e komunës sonë : Krasitja e pemëve frutore në fazën dimërore;
- AVUK ka mbajtur trajnim me temën: Raportimi i lëvizjeve të kafshëve dhe rasteve të sëmundjeve të tyre
- USAID ka mbajtur trajnime online me temat :
 1. Programi i zhvillimit bujqësor dhe mundësitë rurale për të aplikuar për grande
 2. Master plani për ujë dhe korniza investive,
 3. Praktikat e mira bujqësore,
 4. Standardet e ushqimit,
 5. Konferenca e 5-të e mjedres në Kosovë,
- Marrja e mostrave të tokës për analiza tek 9 fermer dhe komunikimin e rezultateve të analizave kimike, biologjike dhe fizike me ESG.

2.5. DREJTORIA E INSPEKSIONIT

Menagjimi, arritjet kryesore, performanca kyçe në periudhën janar-dhjetor 2020 për realizimin e prioriteteve	Drejtorja e Inspeksionit, punët dhe detyrat e punës për periudhën janar-dhjetor 2020 i ka kryer duke u bazuar në planin operativ për vitin 2020 dhe gjithnjë duke u mbështetur në dispozitat e përgjithshme administrative, Ligjet e Kuvendit të Republikës së Kosovës si dhe Rregulloret e Kuvendit Komunal. Gjatë kësaj periudhe raportuese, gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, inspektorët gjithnjë kanë qenë mjaft transparent, bashkëbisedues për dialogje të hapura dhe shumë të përafërt me të gjithë qytetarët e komunës së Drenasit. Mënyra e menagjimit, në këtë Drejtori ka qenë në nivel të aktiviteteve të rëndësishme, varësisht prej punëve dhe detyrave ku çdo herë si model është aplikuar parimi i efikasitetit, gjegjësisht identifikimi i problemit, definimi i qëllimit të zgjedhjes së problemit,
--	---

	vlerësimi i alternativave, zgjedhja e alternativës më të mirë, (marrja e vendimit), implementimi (zbatimi) i vendimit dhe kontrolla e implementimit. Me qëllim të parandalimit të infeksionit Corona Virus (COVID-19) Drejtoria e Inspeksionit në bashkëpunim dhe asistimin e PK në bazë të Ligjit për Shëndetësi nr. 04/L-125, Ligjit nr.02/1-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, Manualit dhe Rekomandimeve të IKShP si dhe në zbatim të Vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, që nga data 13.03.2020 është duke vazhduar inspektimet e të gjitha subjekteve për të respektuar masat mbrojtëse për mbrojtje ndaj COVID-19. Orari i kujdestarisë ka vazhduar të mbahet në grupe prej orës 17.00-22.30 në bashkëpunim me inspektorët e AUVK, MSH dhe PK dhe atë çdo ditë duke llogaritur edhe ditët e vikendeve dhe festave. Vlen të theksohet se gjatë këtij viti është bërë edhe punë shtesë jashtë orarit me qëllim të realizimit të planit të punës sonë dhe vetëdijesimit të qytetarëve në zbatim të Ligjeve në përgjithësi. Në të gjitha lëmitë e inspektimit është punuar nga secili inspektor në kuadër të kompetencave ligjore, rrethanave në terren dhe në përputhje me realitetin ekzistues në territorin e komunës së Drenasit. Gjatë periudhës raportuese janar –dhjetor 2020 vazhdimisht është bërë koordinimi i punëve dhe detyrave të punës në teren dhe është bërë përcjellja e punës së inspektorëve, duke raportuar çdo ditë, si dhe janë dhënë sqarime profesionale në zbatueshmërinë inspektuese. Në vazhdimësi është përcjellë buxheti i vitit 2020, zotimet dhe shpenzimet për paga, mallra dhe shërbime. Po ashtu është hartuar buxheti –kërkesat finale për periudhën 2021-2023 për Drejtorinë për Inspeksion. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2020 janë kryer punët dhe detyrat nën mbikëqyrjet inspektuese si vijon : • Mbikëqyrja e ndërtimit në sektorin publik dhe privat rreth punimeve dhe pajisjes me leje të ndërtimit, si dhe ndalimi i punimeve të objekteve pa leje dhe marrja e masave të nevojshme. • Inspektimet lidhur me tregtimin me pakicë, pajisjen e subjekteve afariste me certifikata të biznesit si dhe inspektimet mbi blerjen, shitjen, çmimet, deklaracionin e mallit, mbrojtjen e konsumatorit, zbatimin e orarit të punës etj • Mbikëqyrja e tregjeve, rrugëve, trotuareve, e sidomos inspektimi rreth ujërave të zeza në zonat rurale. • Mbarëvajtja e tregjeve javore në Drenas dhe Komoran • Mbikëqyrja e kualitetit të ushqimit, të produkteve të ambalazuara dhe të paambalazuara. • Inspektimet rreth mbrojtjes nga pandemia COVID-19 sipas Manualit të IKShP, Ligjit për mbrojtje të sëmundjeve ngjitëse dhe Vendimeve të Qeverisë së Kosovës.
--	--

	• Inspektimi i subjekteve afariste hoteliere rreth Ligjit të duhanit dhe marrja e masave ndaj shkelësve të këtij Ligji. • Inspektimi rreth higjienës dhe kushteve higjieno-sanitare etj. • Inspektimi rreth ndotësve të ambientit • Mbikëqyrja e kompanive të transportit në komunikacionin rrugorë, orari i udhëtimit, lejet e operimit, rendet e udhëtimit, stacionet, parkingjet etj. • Janë kryer edhe punë tjera sipas kërkesave dhe nevojave në teren.
	Nga lëmia e Inspektorit Sanitar është bërë inspektimi rreth parandalimit të dhe luftimit të sëmundjeve ngjitëse COVID-19, higjienës së ujit, Institucioneve shkollore, artikujve ushqimor, hoteleve, kuzhinave ushqimore si dhe higjiena e objekteve tjera afariste. • Inspektimet rreth parandalimit COVID-19 ku janë lëshuar 1056 aktvendime për personat e izoluar me familje të infektuar me COVID -19 dhe 737 anulime të aktvendimeve për personat e shëruar nga COVID-19. • Inspektimet rreth higjienës, kontrolles së përgjithshme të artikujve ushqimorë dhe produkteve të përdorimit të përgjithshëm (Marketet, subjektet afariste hoteliere, sallonet e ondulimit etj) • Kontrolla e higjienës në të gjitha objektet shkollore, parashkollore, si dhe objektet e qendrave të mjekësisë familjare në Drenas. • Inspektimet rreth zbatimit të Ligjit për kontroll të duhanit dhe marrja e masave për shkelësit e këtij Ligji. • Inspektimi i ujit të pijes sipas kërkesave të qytetarëve. • Kontroll rreth librezave sanitare. • Nga data 13.03.2020 pas përhapjes së Covid-19, Drejtoria e Inspeksionit në bashkëpunim me PK-në -stacioni Drenas kanë marr masa për zbatimin e rekomandimeve të IKSHP-së, MSH-se, dhe ligjit nr.02/1-109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse. • Janë hartuar 323 procesverbale, 1815 Aktvendime, 13 pëlqime sanitare, janë shqyrtuar 25 kërkesa të palëve, janë shqiptuar, 62 gjopa mandatore në shumë prej 5,550.00 euro
Nga lëmia e Inspektorëve të Tregut	Nga lëmia e tregut dhe çmimeve për periudhën janar-dhjetor 2020 është bërë inspektimi mbi certifikimin e ushtrimit të biznesit, licencat, çmimet e mallrave të ekspozuara, mbarëvajtja e tregut në Drenas dhe Komoran, orari për fillimin dhe mbarimin e punës, deklaracioni i mallit si dhe punëve tjera nga kjo lëmi. Sidomos gjatë kësaj periudhe rëndësi e veçantë i është kushtuar zbatimit të orarit të barnatoreve pas orarit të rregullt të punës, bastoreve, si dhe inspektimi i produkteve se a i kanë etiketat në gjuhen zyrtare shqipe. • Inspektimet e subjekteve afariste rreth regjistrimit të bizneseve. • Kontrollë rreth zbatimit të orarit të punës, deklaracionit të mallit dhe kontrollit të çmimit të artikujve.

	• Inspektimi i sigurisë së produkteve ushqimore me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve. • Inspektimet e herëpashershme sipas kërkesave dhe në bashkëpunim me MTI-në në bazë të Ligjit të tregtisë së brendshme. • Janë hartuar 277 procesverbale, 77 aktvendime, përkohësisht janë mbyllur 8 lokale për parregullsi si dhe janë dhënë 21 pëlqime për ushtrimin e veprimtarisë. Janë shqiptuar 8 gjoba mandatore për ekspozim të mallit jashtë lokali në shumën prej 1,450 € • Inspektim për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse ,manualit dhe rekomandimeve të IKShP, si dhe në zbatim të vendimeve të Qeverisë së Kosovës.
Nga lëmia e Inspektorit të Ndërtimit	Nga lëmia e ndërtimtarisë janë përcjellë në vazhdimësi ndërtimet rreth lejeve të ndërtimit dhe tërë dokumentacionin e nevojshëm ndërsa për shkelësit e ligjit janë marrë masat e nevojshme. Gjatë vitit 2020 janë inspektuar objektet siç janë: Objekte të ndërtimit të kategorisë së I-rë dhe të II-të, instalime nëntokësore elektrike-ujësjellës-kanalizim, mure rrethuese, rrethoja të ndryshme, rrugë të dëmtuara, bllokim i ujë rrjedhave me mbushje, kioska, fasada të ndërtesave, parkingje etj. Në këto inspektime përfshihen objektet me leje dhe pa leje ndërtimore. Gjatë vitit 2020 janë rrënuar: - 2 objekte ndihmëse Komoran - 1 autolarje Paklek - 5 objekte banimi (shtëpi) të pronarëve në Komoran për lirimin e pronave publike për ndërtimin e Shkollës Profesionale. -3 kiosqe (vetëlargim) në Drenas. -rreth 20 pengesa në rrugë në rrugët lokale të vendosura pa leje (pëlqime) nga DSHPE. Gjatë kësaj periudhe janë bërë: • Inspektimi i ndërtimeve në sektorin publik dhe privat që përfshinë ngritjen instalimin, renovimin, zgjerimin, ndryshimin apo adaptimin e të gjitha strukturave ndërtimore. • Inspektimi i lejeve të ndërtimit • Inspektimi i kushteve urbanistike (leja urbanistike). • Inspektimi i dokumentacionit teknik (projektet ndërtimore, lejet ndërtimore). • Lëshimi dhe modifikimi i sanksioneve dhe përgatitja e vendimeve për ndërprerjen e ndërtimeve ilegale. • Rrënimi i ndërtimeve pa leje • Gjatë kësaj periudhe janë hartuar 101 procesverbale, 35 Aktvendime për pezullim të punimeve dhe të ngjashme, 14 urdhëra për ekzekutim, 8 rrënimet e objekteve, 3 kiosqe(vetëlargim) 3 gjoba mandatore në shumë prej 1,500.00 euro.

Nga lëmia e Inspektorit të Mjedisit	Inspektori i mjedisit ka qenë i angazhuar rreth mirëmbajtjes së pastërtisë së qytetit, mbrojtja e ambientit nga ndotja, mbeturinat, zhurma e me theks të veçantë inspektimi rreth ujërave të zeza sidomos në zonat rurale sipas kërkesave të qytetarëve, pastaj hyrja e qytetarëve në sistem të menaxhimit të mbeturinave. Rëndësi të veçantë ju është dhënë problemit me impiantin e ujërave të zeza. • Inspektimi i hedhjes së mbeturinave afër rrugëve, vendeve publike. • Inspektimi i largimit të mbeturinave inerte në vendet ku ka pasur ndërtime. • Inspektimet e operatorëve (Feronikelit , Gurëthyesëve) të cilët veprojnë në Komunën e Drenasit e që janë ndotës të Mjedisit. • Inspektimet sipas kërkesave të qytetarëve rreth kanalizimeve, ujërave të zeza, plehrave, etj-sidomos në zonat rurale. • Gjithsejtë janë hartuar 82 procesverbale, janë shqyrtuar 39 kërkesa, janë shqiptuar 5 gjoba mandatore në shumen prej 630 € për hudhje të mbeturinave, djegieje mbeturinave dhe plastikës si dhe 163 hyrje në SMM.
Nga lëmia e Inspektorit të Komunikacionit	Inspektori i Komunikacionit është angazhuar konform Ligjit për transportin rrugor dhe Rregullores për transportin rrugor në territorin e Komunës së Drenasit ku problem ka qenë numri i madh i kombi-taxive që megjithë punën që është bërë nga Inspeksioni dhe PK-ës ende operojnë në mënyrë ilegale. Janë inspektuar Operatorët Ekonomik-autobusët rreth respektimit të rendin të udhëtimit sipas Ligjit për transportin rrugorë Nr.04/L179, Rregullores për Transportin Rrugon nr. 06/7086, si dhe rregullores 12.Nr.344-50040. Nga kjo lëmi është punuar me sa vijon: • Inspektimi në komunikacionin rrugor të udhëtarëve të operatorëve ekonomik (autobusët, kombibusët, autotaxit). • Inspektimi i pajisjes së transportuesëve me leje operimi, orar të udhëtimit. • Inspektimi në stacionin e autobusëve, rrugë etj, sipas kërkesave dhe në bashkëpunim me Policinë e Kosovës-Njësi të Drenas. • Për këtë janë hartuar 131 procesverbale, janë konfiskuar 49 parë tabela të regjistrimit, 30 automjete të konfiskuara, si dhe është shqiptuar 01 gjobë në shumën prej 100 €

Gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2020 janë realizuar:

-Procesverbale.....	914
-Aktvendime.....	134
-Aktvendime për izolim (COVID-19).....	1056
-Anulime të Aktvendime për izolim (COVID-19).....	737
-Urdhër për ekzekutim.....	14

-Rrënime të objekteve pa leje dhe të ngjashme.....	11
-Mbyllje të përkohshme të lokaleve.....	16
-Pelqime.....	34
-Gjoha mandatore.....	79
-Konfiskim i tabelave të automjeteve.....	49
-Konfiskim (largim i automjeteve nga komunikacioni).....	30

GJOBAT MANDATORE TE SHQIPTUARA SIPAS SEKTORVE

1.Sektori Sanitar

-Asgjësim malli dhe mbrojtje nga COVID-19.....	5,550.00€
--	-----------

2.Sektori i Komunikacionit

-Për transportuesit legal dhe ilegal, taxit fizik dhe juridik në shumën	100.00 €
--	----------

3.Sektori i Tregut

-Për ekspozim të mallit jashtë lokali.....	1.450.00 €
--	------------

4.Sektori i Ndërtimit

-Për ndërtimin e objekteve pa leje ndërtimi.....	1.500.00 €
--	------------

5.Sektori i Mjedisit

-Për hedhje të mbeturinave dhe djegja e tyre.....	630.00 €
---	----------

Totali:..... 9.230.00 €

Ndonëse është kryer një punë e madhe, parregullsitë kërkojnë angazhim edhe më të madh jo vetëm të kësaj Drejtorie por të gjithë faktorëve relevant në Komunë. Gjatë punës së saj kjo Drejtori vazhdimisht ka bashkëpunuar me Policinë e Kosovës gjegjësisht Stacionin Policor në Drenas. Nëse është e nevojshme plotësimi i vendit të punës me një inspektor të Bujqësisë, si dhe të bëhet rregullimi i kushteve të tregut të gjelbër dhe të kafshëve në Drenas dhe Komoran.

2.6. DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Drejtorati për Buxhet dhe Financa, gjatë periodës janar- dhjetor /2020, punët dhe detyrat e punës i ka kryer duke u bazuar në Plan-programin e punës, të mbështetur në Ligjin për Menaxhimin e Financave publike dhe Përgjegjësitë nr. 03/L-048, Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal nr. 03 / L-049, Ligjin për vetëqeverisjen

Lokale nr. 03 / L-040, rregulloret, vendimet, udhëzimet e MEF-it dhe Kuvendit të Komunës, si dhe në bazë të detyrave dhe obligimeve të përcaktuara me Statutin e Komunës së Drenasit.

Ky Drejtorat, punën e vetë kryesisht e ka orientuar në këto lëmi:

- raporti i punës dhe financiar për vitin 2020,
- pasqyrat financiare 2020,
- procesi buxhetor-Strategjia Fiskale 2021-2023, sipas kërkesave të Drejtorateve,
- aprovimi i shpenzimeve dhe certifikimi për buxhetin komunal sipas programeve,
- kryerja e pagesave lidhur me shpenzimet operative dhe kapitale, si dhe barazimi me raportet e SIMFK
- punët lidhur me arkën e parave të gatshme (arkëtimi dhe pagesat),
- regjistrimi në sistemin kompjuterik i të gjitha të hyrave të arkëtuara nga burimet vetanake dhe barazimi ditor, javor, mujor dhe periodik me SIMFK,
- autorizimi i shpenzimeve për D.B.F
- përcjellja e të hyrave publike të akorduara nga B.K.K,
- përgatitja e transfereve të parave të depozituara në llogaritë e thesarit të MEF-it,
- caktimi i tatimit në pronë- shpërndarja e faturave për vitin 2020,
- evidentimi i objekteve të reja si pasuri e paluajtshme dhe rimatja e objekteve,
- përgatitja e analizave mujore lidhur me zhvillimin e buxhetit komunal,
- raporti i punës dhe financiar sipas periodave të vitit /2020,
- propozim Korniza Afatmesme Buxhetore 2021-2023,
- shlyerja e pagesave për tatimin në pronë,
- plotësimi i formularëve për buxhetin 2021-2023, sipas kërkesave fillestare,
- Trajnimin e punëtorëve të D.B.F,
- punë dhe detyra tjera të punës për pushtetin lokal dhe qendror,
- punët me palë në lëmin e buxhetit dhe financave.

Struktura e përgjithshme organizative për funksionet e Drejtoratit për Buxhet dhe Financa, tani më është e bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjin për Vetëqeverisjen lokale, Statutin e Komunës, sipas Sektorit të Buxhetit, Thesarit dhe Financave.

1

- 1. Sektori i Buxhetit** - Për periodën janar-dhjetor/2020, ka kryer këto punë dhe detyra pune:
 - zhvillimi i aktivitetit lidhur me planifikimin e buxhetit komunal 2021-2023, sipas kërkesave fillestare,
 - përgatitja e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2021-2023
 - vërtetime tjerë për qytetarët lidhur me rregullimin e dokumentacionit,
 - numëri i kërkesave të regjistruara dhe koduara për shpenzime nga shfrytëzuesit e buxhetit komunal,
 - lëshuarja e fletëpagesave sipas kërkesës së palëve,
 - ruajtja e databases për të dhënat e regjistruara,
 - objektet e reja të matura – rimatura,
 - fatura të shpërndara përmes poste,
 - numri i ankesave të pranuar,
 - pranimi i kërkesave për regjistrimin e objekteve të reja,
- 2. Sektori i Thesarit.**- Në këtë sektor, punët dhe detyrat e punës për periodën janar-dhjetor/2020, janë kryer si vijon:
 - Është bërë arkëtimin e parave të imta për shërbime në ofiçari, arkiv, Gjeodezi, Urbanizëm, shërbimet e pagesës së tatimit në pronë, dhe për shpallje të tenderëve - shërbime për arkëtim të

parave të imta. Përveç arkëtimit , është bërë përgatitja dhe depozitimi ditor i parave në llogarinë bankare të Komunës.

- regjistrimi i të hyrave vetanake të arkëtuara është bërë për çdo ditë në database dhe në sistemin e Free-balancit,
- tansferi i të hyrave vetanake nga llogaria bankare komunale në llogari të thesarit MEF për çdo fund muaji ,
- barazimi i raporteve të arkës me raportet e bankës dhe kontrollimi i tyre për çdo ditë,
- hartimi i raporteve mujore për të hyrat vetanake për nevoja të ekzekutivit dhe MEF-së,
- zotimi i parave publike për qëllime të pagimit të shpenzimeve operative dhe kapitale, sipas modulit të blerjes, dhe sipas modulit të aprovimit,
- kryerja e pagesave nga buxheti i Sektorit të Përgjithshëm (drejtoratet dhe zyrat komunale) për të gjitha lëndët që kanë qenë të kompletuara. Vlen të cekët se 100% e lëndve të pranuar në zyrën e pagesave janë procesuar për pagesë,
- Certifikimi UOP për të gjitha kategoritë: 3,848,
- Certifikimi i UOP për Komunal 1,398,
- Aprovimi i avanseve për para të imta 134,
- Certifikimi i UOP për mallra dhe shërbime 2031,
- Certifikimi i UOP për Subvencione 74,
- Certifikimi i UOP për Investime Kapitale 204
- Dorëzimi i UOP në arkiv 3,848,
- përgatitja e analizave mujore lidhur me zhvillimin e buxhetit komunal sipas sektorëve kryesor dhe programeve

2

3. **Sektori i Financave-** Në periodën janar-qershor /2020 , përmes Sektorit të Financave janë kryer këto punë dhe detyra pune:

- Përgatitja e pasqyrave financiare për vitin /2019,
- çertifikimi i dokumentacionit financiar për buxhetin komunal sipas programeve – drejtorateve dhe zyrave komunale me modulën e blerjes 3,848,
- çertifikimi i lëndve për pagesë sipas modulit të aprovimit 1,653,
- përgatitja e regjistrimit të faturave të paguara për dosjet e dokumentacionit financiar, për vitin 2020.
- është mbajtur evidencë analitike për të gjitha lëndët e certifikuar sipas shpenzimeve veç e veç 3,848
- raporti i punës-financiar për periodën Janar-Mars /2020
- raporti i punës-financiar i periodës janar-qershor/ 2020,
- raporti i punës dhe financiar janar - shtator 2020
- raporti i punës dhe financiar janar-dhjetor 2020
- plani i punës për vitin 2021,

4. **Zyra e Tatimit në Pronë**

- Raste të reja 402 ,
- Verifikim Tereni 1004,
- Lëndë të miratuara intranet 10,022,
- Pagesa të pranuar në arkë 12,463
- Certifikata të pagesës për TPr 13,717
- Shpronësimet dhe ndërrimet e pronarëve 37
- Korrigjime dhe kalkulim manuale të pagesave 1,225
- Riprogramim i marrëveshjeve 19
- Vendime nga bordi i ankesave 15

- Certifikata për jo tatimpagues 622,
- Lidhja e marrëveshjeve për pagesë me këste 19,
- Shqyrtimi i kërkesave për korrigjim 29,
- Leshuarja e faturave në mënyrë manuale 9,112,

Nga Drejtorati për Buxhet dhe Financa, për periodën raportuese (janar-dhjetor /2020) janë kryer edhe shumë punë dhe detyra tjera të punës që nuk janë evidentuar më lartë e të cilat kanë ndihmuar punën e Bordit të Drejtorëve, Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendin e Komunës.

2.7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Qendra kryesore e mjekësisë Familjare ne bazë të infrastrukturës dhe strukturës orrganizative ofron shërbime shëndetësore në gjithë teritorin e Komunës së Drenasit në bazë të konceptit të mjekësisë familjare. Këto shërbime shëndetësore janë gjithëpërfshirëse për të gjitha grup moshat.

Kujdesi shëndetësor në bazë të rrethanave të kohës dhe përparimit të teknologjisë ka një qasje të avancuar në aspektin e trajtimit dhe përkujdesjes shëndetësore, është një kohë e transformimit dh një qasje gjithëpërfshirëse shëndetësore, mirëqenies sociale, ekonomike, epidemiologjike dhe rehabilituese.

Detyrat e përgjithshme Ligjore dhe statutore të QKMF-së

- Zbaton ligjin për shëndetësi me qëllim të ruajtjes dhe përparimit të shëndetit të qytetarëve
- Zbaton politikat shëndetësore të hartuar nga DSHMS
- Zbaton planin operativ te propozuar nga Kuvendi Komunal përmes DSHMS-le
- Planifikimi i nevojave për resurse humane profesionale
- Shfrytëzimi racional i buxhetit të aprovuar nga K.Komunal në bashkëpunim me DSHMS-le
- Organizimin e punës në kujdesin parësor shëndetësor me qëllim të ofrimit të shërbimeve shëndetësore profesionale dhe cilësore
- Përmes protokolleve dhe udhërrëfyesve klinik përcjell trendin e trajtimit të sëmundjeve dhe diagnostikimit
- Zbaton udhëzimet administrative për kujdes parësor te hartuara nga Ministria e Shëndetësisë
- Vlerëson nevojat lokale në bazë të të dhënave dhe parashtron DSHMS-le për hapat e veprimit
- Raporton për situatën epidemiologjike DSHMS –le në mënyrë që të monitorohen situatat nga DSHMS-le.
- Bashkëpunimi me organizatat qeveritare dhe jo qeveritare që kanë për qellim përparimin e shëndetit në kujdesin parësor shëndetësor.

KPSH- Bazohet në ofrimin e shërbimeve shëndetësore cilësore dhe të sigurt, të ndërtuara mbi parimet e konceptit të Mjekësisë familjare, të drejtuara nga nevojat dhe kërkesat e individëve, familjeve dhe bashkësisë, me synim të promovimit ruajtjes dhe përmirësimit të shëndetit për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës

SHËRBIMET E INSTITUCIONEVE TË KUJDESIT PARËSOR SHËNDETËSOR

1. Shërbimet e promovimit shëndetësor, përfshirë informimin, komunikimin dhe edukimin
2. Shërbimet e imunizimit dhe vaksinimit dhe shërbimet tjera parandaluese

3. Shërbimet esenciale kurative dhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike
4. Shërbime të kujdesit akut dhe urgjent
5. Shërbimet e kujdesit shëndetësor për sëmundjet kronike
6. Shërbimet e kujdesit shëndetësor për fëmijë, adoleshentë dhe të rinjtë
7. Shërbimet e planifikimit familjar
8. Shërbimet e kujdesit ante/peri dhe post natal
9. Shërbimet e shëndetit oral parandalues
10. Shërbimet e shëndetit mendor
11. Shërbimet e kujdesit shtëpiak përfshirë shërbimet e kujdesit neonatal dhe atij terminal palitativ
12. Shpërndarja e barërave nga lista esenciale

Me aprovimin e statutit të QKMF Drenas në bazë të U.A.08/2017 dhe Strategjisë sektoriale të shëndetësisë struktura organizative dhe qasja në shërbime shëndetësore është bërë konform këtyre dokumenteve të aprovuara nga MSH.

Situata e pandemisë ka ndikuar dukshëm në zbatimin e PKZHIKPSH i aprovuar nga Kuvendi Komunal i Drenasit, arësyeja për shkak të situatës pandemike kanë ndryshuar rrethanat e ofrimit të shërbimeve shëndetësore në bazë të rekomandimeve të IKSHP.

Në fazën fillestare të pandemisë QKMF Drenas iu është përmbajtur rekomandimeve të IKSHP për menagjimin e situatës. Më qellim të të aplikimit të këtyre rekomandimeve është formuar grupi punues prej 5 anëtarëve me kryesues Epidemiologun ku është hartuar plani i veprimit dhe informimi i profesionistëve shëndetësor me udhëzues për IKPSH rreth qasjes dhe masave të veprimit.

1. Formimi i ekipit mjekësor që do të mbikëqyrë personat që vijnë nga vendet endemike dhe hynë në territorin e RK në zbatimin e procedurave të vetizolimit për këta persona dhe familjet e tyre.
2. Ekipi mjekësor që do të mbikëqyrë gjendjen shëndetësore të këtyre personave
3. Formimi i ekipit që do të bëjë dezinfektimin e hapësirave të IKPSH sipas udhëzuesit për dezinfektimin në bazë të rekomandimeve të IKPSH
4. Trajnimi i këtij ekipi rreth mënyrës së përdorimit mjeteve dezinfektuese është kryer nga Epidemiologu
5. Rekomandimet nga IKSHP përmes MSH që në pikat kufitare të dërgohen ekipet mjekësore në nivel regjional mbështetje i ekipit Mjekësor në Aeroportin Ndërkombëtar 'Adem Jashari' nga data 27 shkurt deri me datë 17 mars 2020. Nga QKMF Drenas është dërguar ekipi mjekësor në mbështetje në Aeroport.

Me rastin e shpalljes së gjendjes të gatishmërisë së lartë nga QK dhe formimi i shtabeve Emergjente Komunale me qëllim të zbatimit të këtyre masave përmes rekomandimeve të DSHMS dhe vendimeve të nxjerrura nga kjo drejtori me qëllim të menaxhimit të situatës pandemike nga COVID-19.

Në bazë të strukturës organizative të QKMF, trupave profesionale dhe stafit mbështetës shëndetësor me kapacitetet e mundshme në disponim është bërë organizimi i punës dhe qasja në shërbime shëndetësore emergjente duke mos anashkaluar shërbimet bazike dhe vizitat shtëpiake në bazë të udhëzuesve klinik të trajtimit të sëmundjeve në situatën pandemisë.

STAFI MJEKËSOR I ANGAZHUAR NË SISTEMIN E KPSH DERI ME DATË 01. 10.2020.										
		Mjekësi Familjare			Konsultativë					
	Stomatolog dhe Mr. Farmacistë	Nr. Spec. M.F.	Nr. Specializantëve MF	Nr. Mjekëve pa Specializim	Nr. Spec. tjerë sipas llojit të specializimit	Nr. Specializantëve tjerë sipas llojit të specializimit	Nr. Total i Infermierëve në MF.	Nr. i Infermierëve të trajnuar në MF të Licencuar	Nr. i Infermierëve të trajnuar në MF të Pa Licencuar	Nr. Kuadrit të mesëm mjekësorë Rentgen, Laborant, Mami etj.
	Dr. Stomatolog dhe Mr. Specialistë	Specializim	Specializim	Dr. Pa Specializim	Specialistë tjerë	Specializan të tjerë	Infermier	Infermier të trajnuar	Infermier të trajnuar pa Licencë	Laborant, Mami, Tekn. Rentgen
M	1	2	2	7	5	-	7	7	-	6
F	3	8	3	5	2	2	69	69	-	22
Gj	4	10	5	12	7	2	75		-	27
	4	27			9		75			27
	40						102			
142										

Tabela 2. Numri i stafit mjekësor i angazhuar në sistemin e KPSH deri me datën 01.10. 2020

Sipas tabelës numri i resurseve humane profesionale shëndetësore është 142

STAFI MJEKËSOR I ANGAZHUAR NË SISTEMIN E KPSH NGA DATA 01. 10.2020.										
		Mjekësi Familjare			Konsultativë					
	Stomatolog dhe Mr. Farmacistë	Nr. Spec. M.F.	Nr. Specializantëve MF	Nr. Mjekëve pa Specializim	Nr. Spec. tjerë sipas llojit të specializimit	Nr. Specializantëve tjerë sipas llojit të specializimit	Nr. Total i Infermierëve në MF.	Nr. i Infermierëve të trajnuar në MF të Licencuar	Nr. i Infermierëve të trajnuar në MF të Pa Licencuar	Nr. Kuadrit të mesëm mjekësorë Rentgen, Laborant, Mami etj.

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE PËR VITIN 2020

	Dr. Stomatolog dhe Mr.	Specialistë	Specializim	Dr. Pa Specializim	Specialistë tjerë	Specializant ë tjerë	Infermier	Infermier të trajnuar	Infermier të trajnuar pa Licencë	Laborant, Mami, Tekn. Rentgen
M	1	2	2	11	5	2	8	7	-	6
F	3	8	3	8	2	2	71	69	-	22
Gj	4	10	5	19	7	2	79		-	27
	4	34			9		79			27
	46						105			
151										

Me shpalljen e gjendjes për gatishmëri të lartë nga Qeveria e Republikës së Kosovës me rekomandim të IKPSH qasja ne shërbime shëndetësore gjatë kësaj periudhe është organizuar ne bazë te rekomandimeve të IKSHP dhe Shtabit Operativ të Komunës së Drenasit ne mbikëqyrje të DSHMS me qëllim të zbatimit të vendimit Nr.01/07 datë 11.03.2020. Me vendim të DSHMS në Drenas është krijuar Këshilli Emergjent me përbërje prej 11 antarëve në QKMF dhe caktimi i 24 ekipeve mjekësore me qëllim të menaxhimit të situatës pandemike, vendosja e dy tenderëve në QKMF Drenas dhe QMF Komoran nga Komuna e Drenasit me qëllim të triazhimit të kërkueseve të shërbimeve mjekësore në bazë të rekomandimeve të IKSHPK.

Ofrimi i shërbimeve shëndetësore 24 orë në QKMF Drenas dhe QMF Komoran në kohë pandemie ka ndikuar në qasje të lehtë për kërkuarit e shërbimeve shëndetësore. Me vendim të MSH janë trajtuar rastet emergjente dhe rastet e dyshuara nga mjeku familjarë dhe referimi i tyre për testim në IKPSH.

Në funksion të ofrimit të shërbimeve shëndetësore Qendrat e Mjekësisë Familjare Arllat, Terstenik, Gllanasellë, Baicë gjatë kësaj periudhe kanë qenë në funksion të ofrimit të shërbimeve shëndetësore duke respektuar masat mbrojtëse për personelin shëndetësor dhe rekomandimet e IKPSH.

Vizitat e shëndetit palativ kanë qenë në funksion gjatë gjithë kësaj periudhe me kapacitetet e mundshme të disponueshme. Vizitat në shtëpi për nëna dhe fëmijë deri në moshën 3 vjeçare janë ndërprerë për 2 muaj dhe ne bazë të rekomandimeve të MSH por qasja në këto shërbime ka kaluar në mënyrën virtuale dhe komunikimet telefonike e realizuar nga koordinatori i programit.

Ekipi mjekësor i anketës Epidemiologjike me rekomandim të IKPSH nga data 27.02.2020. deri me datën 12.06.2020.ka zbatuar këto rekomandime për qytetarët e Komunës së Drenasit që kanë hyrë në pikat kufitare ne RK nga vendet endemike ne vendosjen e këtyre personave në vetizolim deri në 14 ditë nga dita e parë e hyrjes dhe përcjellja e gjendjes shëndetësore të tyre.

Numri i personave në vetëizolim **225 raste**

Numri i personave të karantinuar nga Komuna e Drenasit QK Prishtinë **15 raste**

Secilit person i është ofruar lista e të dhënave personale në vendbanimin e tij dhe rekomandimet e sjelljes gjatë vetizolimit e konfirmuar me nënshkrimin e tij me rekomandim dhe konfirmim të mjekut përkatës të ekipit.

Me vendim të MSH dhe në bashkëpunim me QOEMSH ne Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” Prishtinë nga data 04.05.2020 deri me datën 07.07.2020 janë angazhuar personel shëndetësor nga QKMF Drenas në nivel regjional 24 orësh, 10 asistime me rastin e aterimit të qytetarëve në Republikën e Kosovës nga vendet endemike.

Numri i personelit shëndetësor të angazhuar : **Mjekë ----- 6**

Infermier-----10

Numri i rasteve të transportuara nga Qendra karantine në vendbanimet e tyre nga ekipa mjekësore: 7 raste të cilët janë dërguar në vendbanimet e tyre me rekomandim të QOEMSH. MSH me datë 31.05.2020 ka nxjerr qarkore informative Nr.11/2020 për informim të institucioneve shëndetësore publike dhe private.

Trendi i rritjes së rasteve me COVID-19 me lirimin e masave pas vendimit të Qeverisë së RK në bazë të rekomandimeve të MSH të datës 13.07.2020, ku sipas kësaj urdhërese në zbatim të procedurave standard të operimit, mjekët familjar në QKMF në bazë të diagnozës klinike të vënë në zbatim procedurat e vetizolimit për personat e dyshuar në COVID-19 dhe përcjellje të gjendjes shëndetësore të tyre. Ndërprerja e asistimit të ekipeve mjekësore në pikat kufitare dhe zbatimi i masave mbrojtëse nga personeli shëndetësor në bazë të Manualit për COVID-19.

Ekipi mjekësor i QKMF në Drenas në bashkëpunim me Inspektoratin komunal ka bërë identifikimin dhe vendosjen në vetizolim të personave me test pozitiv dhe personat e kontaktit (familjarët) në mbikëqyrje të Policisë së Kosovës, Stacionin Policor në Drenas ku ka ekzistuar një koordinim dhe bashkëpunim në zbatim të vendimeve dhe rekomandimeve të nxjerra nga Shtabi Emergjent Lokal i Komunës së Drenasit. Nga ekipi mjekësor i anketës epidemiologjike QKMF krahas identifikimit të personave me Covid-19 dhe zbulimit të rasteve të kontaktit krahas anketës epidemiologjike në teren, ka realizuar 5374 thirrje telefonike. Në diagramin vijues është paraqitur trendi i rasteve Covid-19 në Komunën e Drenasit. Në diagram vërehet një trend i rritjes së rasteve pas lehtësimit të masave dhe zbatimi jo i duhuri rekomandimeve të IKPSHK. Në trend të rritjes ka ndikuar edhe fillimi i vitit shkollor në muajin tetor ku kontaktet kanë qenë më të shprehura në këto institucione.

Në favor të kësaj pasqyre reale është edhe rritja e kapaciteteve të testimeve PCR në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës. Diagrami është hartuar në bazë të dhënave zyrtare të raportuara nga IKSHPK për Komunën e Drenasit për personat e rezultuar pozitiv.



Duke u nisur nga kjo situatë e krijuar e rritjes së numrit të rasteve me test pozitiv me qëllim të mos ngarkimit të sistemit shëndetësor, grupi i ekspertëve i MSH ka aprovuar Udhërrëfyesin Klinik për menaxhimin dhe trajtim të pacientëve me covid-19 dhe rasteve të dyshuara në KPSH. Në bazë të rekomandimeve të MSH për

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE PËR VITIN 2020

KPSH janë ndarë hapësirat e veçanta të trajtimit dhe ekipet mjekësore që janë në dispozitim për trajtimin e rasteve.

Në QKMF në Drenas është adaptuar hapësira me kapacitete prej 8 shtretërve dhe aparaturës për oksigjen, terapi e dhuruar nga UNICEF. Në këto hapësira janë ordinar nga 14 shtatori deri në fund të vitit 5830 terapi infusive me likide parenterale dhe terapi të ordinar nga mjeku në bazë të udhërrëfyesit të trajtimit.


Përkundër situatës së pandemisë në bazë të rekomandimeve të MSH, shërbimet bazike shëndetësore janë realizuar sipas procedurave të rregullta si dhe vizitat e shëndetit palativ për të moshuar dhe personat me nevojë. Në funksion të ofrimit të shërbimeve shëndetësore kanë qenë të gjitha njësitë organizative me përjashtim të AMF-ve që kanë funksionuar me kapacitete të reduktuara.

Në bazë të tabelës së poshtë paraqitur mund të konkludojmë se mbi 80% të banorëve të Komunës së Drenasit ju kanë qasur shërbimeve shëndetësore në KPSH në vizita dhe trajtim. Koncentrimi i kërkesave të shërbimeve shëndetësore është më i shprehur në dy qendra në QKMF Drenas dhe QMF Komoran pasi që ofrimi këtyre shërbimeve ka qenë në funksion 24 orë dhe për arsye të situatës pandemike, shërbime shëndetësore kanë marrë edhe banorët e komunave tjera.


	Vizita e pare	Vizita e dyte	Total Vizita	Referi me ne	Vizita në	Sherbi me	Infusio ne	Injeksi one	Inhalim	EKG	Imazhe ri	Laborat or	Plage, pastrim
QKMF	28235	68228	96463	5438	30642	11247	17165	52354	481	1873	5837	67314	11161
QMF Komoran	12160	32356	44516	5046	16348		13236	27124	617	1762		21008	8147
QMF Arllat	2347	457	2804	346			10	1597				2660	965
QMF Gllanasei	1316	380	1696	59			7	1108				57	167
QMF Terstenik	1574	635	2209	198			159	1197					312
QMF Baicë	976	270	1246	11			5	1630					1011
AMF Nekoc	251	187	438	2				185					112
AMF Sankoc	10	2	12	0				21					17
AMF Poklek-	15	3	18	0				47					72
AMF Gradicë	13	2	15	1				6					7
AMF Abri e Epërme	188	41	239	20				169					43
AMF Terdec	21	7	28	2				11					9
AMF Dobrosh	182	31	213	13				120					6
	47288	102599	149897	11136	46990	11247	30582	85569	1098	3635	5837	91039	22029

Vizitat për gratë shtatëzane dhe fëmijët deri në moshën 3 vjet për shkak të pandemisë nuk kanë mundur të realizohen në bazë të planifikimit, por me rekomandim të MSH kjo formë e vizitave është realizuar në mënyrën virtuale. Numri këtyre vizitave gjatë periudhës janar-dhjetor është 696 vizita.


Diagrami i paraqitur në vijim paraqet numrin e vizitave dhe shërbimeve në QKMF dhe njësitë e saj në Drenas.



Diagrami i paraqitur në vijim pasqyron numrin e vizitave dhe shërbimeve në QMF Komoran



Diagrami i paraqitur në vijim pasqyron numrin e vizitave dhe shërbimeve në QMF tjera dhe AMF



Në bazë të diagrameve të lartëpasqyruara vërehet një shpërndarje jo racionale e shërbimeve shëndetësore, si rezultat i mungesës së zoonimit dhe plotësimit të standardeve me mjek familjar. Numri i vizitave dhe shërbimeve është i lartë në dy njësitë, që paraqet një ngarkesë për personelin shëndetësor në jorecionalitetin e shfrytëzimit të resurseve humane.

	Vizitat në shtëpi për kujdes paliativ (Janar - Dhjetor 2020)
QKMF	2453
QMF Komoran	27
QMF Arllat	5
QMF Gllanasellë	3
QMF Terstenik	6
QMF Baicë	2

Në bazë të tabelës së lartë paraqitur vizitat për kujdes paliativ nuk është një parametër i kënaqshëm, ne dy muajt e fundit kemi pasur një qasje më të mirë në këto vizita të shëndetit paliativ që në këtë periudhë është rritur personeli shëndetësor, por megjithatë nevojat janë më të larta se rezultati që është arritur.

Shërbimi i vaksinimit

Shërbimi i vaksinimit përkundër situatës së pandemisë ka arritur të realizojë planifikimin në 90.17% të vaksinave të aplikuara. Vaksinimi ndaj gripit sezonal përkundër kampanjës së vetëdijesimit të popullatës dhe këshillimit nga ana e mjekëve nuk është arritur caku i planifikuar. Në këtë rezultate ka ndikuar edhe vonesa e sigurimit të vaksinave nga ana e MSH, situata pandemike dhe hezitimi i pacientëve. Vaksinimi rregullt ka pasur ecuri të kënaqshme edhe pse në një periudhë të caktuar është ndërprerë me vendim të MSH për shkak të masave kundër COVID19.

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE PËR VITIN 2020

Vaksinat	Dozat e dhëna	Planifikimi	Përqindja
BCG ne Drenas	124	124	100
hep.0	124	124	100
IPV 1	854	911	93.74
IPV 2	856	911	93.96
IPV3	812	911	98.13
Pentavaks 1	854	911	93.74
Pentavaks 2	856	911	93.96
Pentavaks 3	812	911	98.13
MMR	732	895	80.78
OPV R1	694	895	77.54
DTP r1	694	895	77.54
Td	415	933	44.48
OPV R2	932	939	99.25
MMR Rivak	932	939	99.25
Td-Proad	932	939	99.25
OPV R3	927	935	99.14
Td	927	935	99.14
TT	524	524	100
Tetabulin	163	163	100
Grip	2807	3000	93.56
Hep.sipas ind. epid	52	52	100
Suksesit vaks. Oblig	16014	17758	90.17

Raporti i barnatores të hyrat nga LE e MSH dhe të hyrat vetanake në bazë të planifikimit në trajtimin e urgjencave me terapi të domosdoshme.

	Hyrjet nga LE -MSH		
data/muaji	barna/material mjekësor	insulina	gjithsej
25.01.2020	€ 5765,20	€ 6124,80	€ 11890,00
20.02.2020	€ 3561,33	€ 6783,20	€ 10344,53
26.03.2020	€ 4795,21	€ 6874,20	€ 11669,41
23.04.2020	€ 4200,80	€ 6497,70	€ 10698,50
27.05.2020	€ 3315,00	€ 6961,70	€ 10276,70
29.06.2020	€ 2576,20	€ 8380,90	€ 10957,10
05.08.2020	€ 4239,88	€ 6323,20	€ 10563,08
24.09.2020	€ 3171,99	€ 7089,20	€ 10261,19
21.10.2020	€ 4105,82	€ 6943,12	€ 11048,94
11.11.2020	€ 7490,60	€ 11340,00	€ 18830,60
24.12.2020	€ 1365,00	€ 2838,40	€ 4203,40
Gjithsej	€ 44587,03	€ 76156,42	€ 120743,45

Blerjet vetanake	
20.02.2020	€ 4241,00
15.07.2020	€ 1777,00
20.11.2020	€ 7084,00
Gjithsej	€13102,00

Shërbimi i shëndetit oral

Viti 2020 është karakterizuar me numër më të ulët të pacientëve që kanë kërkuar shërbime shëndetësore në këtë shërbim. Ky numër i ulët është si shkak i pandemisë dhe masave të MSH në trajtimin e rasteve urgjente dhe reduktim të personelit në ofrimin e këtyre shërbimeve. Me lirimin gradual të këtyre masave dhe rekomandimeve të MSH për personelin shëndetësor në aplikimin e masave mbrojtëse qasja në shërbime shëndetësore është normalizuar.

Vizita mjekësore(numri i pacientëve) ----- 5109

Shërbime shëndetësore nga mjeku stomatolog-----19005

Shërbime mjekësore nga asistenti i stomatologut-----25.932

Materniteti

Numri i lindjeve gjatë këtij viti ka qenë në një numër të ulët përkundër vizitave në hapësirën e shëndetit të gruas dhe nënave shtatzëna, megjithëse edhe situata e pandemisë ka ndikuar. Por marrë parasysh në vitet paraprake, trendi i lindjeve është në rënje në këtë njësi edhe pse kuadri profesional është në dispozicion

Numri i lindjeve-----32

Viti Fiskal : 2020

Kriteret e filtrimit : Lloji I Kontrollit Buxhetit - ALOKIMI; Elementet hierarkike të Bllokut kodues -
FUND : CAT (Nga : 10) (Nga : 22) , **ORG** : RESP (Nga : 611) (Nga : 611) ,
PROG : PCLASS (Nga : 73100) (Nga : 73100) , **OBJECT** : MOBJ (Nga : 000)
(Nga : 300)

Valutë : EUR

Përshkrimi	Buxheti Aktual	Allocated	E paalokuar	Aktuali	Zotim /Obligimet në pritje	Buxheti FreeBalance	Parashikimi vjetor	Alokimi Suficid/Deficid	Buxheti I shpenzuar sipas %
CAT / RESP / PCLASS / MOBJ	A	B	A - B	C	D	A - (C + D)	E	A - E	

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE PËR VITIN 2020

10 BUXHETI	2 106 648,06	2 106 648,06	0,00	2 037 766,69	103 383,05	-34 501,68	0,00	2 106 648,06	
611 Gllgoc	2 106 648,06	2 106 648,06	0,00	2 037 766,69	103 383,05	-34 501,68	0,00	2 106 648,06	
73100 Shërbimet e kujdesit primar shëndetësor - gllgoc	2 106 648,06	2 106 648,06	0,00	2 037 766,69	103 383,05	-34 501,68	0,00	2 106 648,06	
111 Paga dhe shtesa	1 387 544,45	1 387 544,45	0,00	1 434 281,75	0,00	-46 737,30	0,00	1 387 544,45	103,37
130 Mallra dhe shërbime	378 274,61	378 274,61	0,00	340 476,72	26 329,93	11 467,96	0,00	378 274,61	90,01
132 Shpenzime komunale	42 985,00	42 985,00	0,00	42 184,38	32,96	767,66	0,00	42 985,00	98,14
300 Pasuritë jofinanciare	297 844,00	297 844,00	0,00	220 823,84	77 020,16	0,00	0,00	297 844,00	74,14
21 Te hyrat vetanake	71 812,00	71 812,00	0,00	0,00	47 500,00	24 312,00	0,00	71 812,00	-
611 Gllgoc	71 812,00	71 812,00	0,00	0,00	47 500,00	24 312,00	0,00	71 812,00	-
73100 Shërbimet e kujdesit primar shëndetësor - gllgoc	71 812,00	71 812,00	0,00	0,00	47 500,00	24 312,00	0,00	71 812,00	-
111 Paga dhe shtesa	20 000,00	20 000,00	0,00	0,00	0,00	20 000,00	0,00	20 000,00	-
130 Mallra dhe shërbime	4 312,00	4 312,00	0,00	0,00	0,00	4 312,00	0,00	4 312,00	-
300 Pasuritë jofinanciare	47 500,00	47 500,00	0,00	0,00	47 500,00	0,00	0,00	47 500,00	-
22 Të hyrat vetanake- 2018	40 630,75	40 630,75	0,00	8 643,28	0,00	31 987,47	0,00	40 630,75	21,27
611 Gllgoc	40 630,75	40 630,75	0,00	8 643,28	0,00	31 987,47	0,00	40 630,75	21,27
73100 Shërbimet e kujdesit primar shëndetësor - gllgoc	40 630,75	40 630,75	0,00	8 643,28	0,00	31 987,47	0,00	40 630,75	21,27
111 Paga dhe shtesa	26 737,30	26 737,30	0,00	0,00	0,00	26 737,30	0,00	26 737,30	-
130 Mallra dhe shërbime	5 250,17	5 250,17	0,00	0,00	0,00	5 250,17	0,00	5 250,17	-
300 Pasuritë jofinanciare	8 643,28	8 643,28	0,00	8 643,28	0,00	0,00	0,00	8 643,28	100,00
Totali i përgjithshëm	2 219 090,81	2 219 090,81	0,00	2 046 409,97	150 883,05	21 797,79	0,00	2 219 090,81	92,22

Reforma institucionale dhe përmirësimi i praktikës menaxhuese në sistemin shëndetësorë / prioritetet e përcaktuara rezultojnë pozitivisht në këto elemente:

1. Zhvillimi i konceptit të çasjes në mjekësinë familjare;
2. Ulja e nivelit të vdekshmërisë dhe sëmundshmërisë së fëmijëve nën moshën 5 vjeçare;
3. Ulja e nivelit të vdekshmërisë dhe sëmundshmërisë materiale (para, gjatë dhe pas lindjes);
4. Ulja e nivelit të incidencës dhe ndikimit të sëmundjeve ngjitëse duke përfshirë TBC dhe HIV / AIDS;
5. Ulja e nivelit të pirjes së duhanit;
6. Stabilizimi i incidenteve me ndikim në sëmundjet mentale;
7. Zvogëlimi i incidencës me ndikim në sëmundjet kardiovaskulare;
8. Përmirësimi i gjendjes me barëra esenciale;
9. Përmirësimi i menaxhimit të financave dhe prokurimit në sektorin e shëndetësisë;
10. Përforsimi i kornizës ligjore dhe rregullative.

QPS Drenas

Raporti Statistikor-Përfundimtar për vitin 2020 i Shërbimeve Sociale

2	Kategoria	Të bartura nga Viti 2019	Lëvizja e lëndëve (gjatë vitit-2020)		Lëndët që bartën për Vitin 2021
			Të reja	Te mbyllura	
1.	1.a-Fëmijët e braktisur	20	5	3	22
	1.b-Fëmijët jetim (pa dy prindër)	3	4	/	7
	1.c-Fëmijët e prindërve të penguar në kryerjen e detyrave prindore	12	1	10	3
	1.d-Fëmijët të strehuar në Familje Strehuese, apo SOS-fshatin	9	4	3	10
2	Familje Strehuese	1	/	/	1
3	Kërkesa për Adoptim vendor	1	/	/	1
4	Kërkesa për Adoptim Nderkomb.	-	-	-	-
5	Fëmijë të keqtrajtuar	5	7	3	9
6	Fëmijët me sjellje asociale	6	6	/	12
7	Të miturit në konflikt me ligjin	5	4	3	6

8	Viktimat e dhunës familjare		35	22	19	38
9	Viktimat e Trafikimit		4	/	/	4
10	Viktimat e Krimeve seksuale		2	1	2	1
11	Martesa e të miturve		1	/	1	0
12	Punë të rënda(rrezikshme)te fëmijëve		/	/	/	/
13	Kërkues të këshillimit martesor		12	16	4	24
14	Të moshuarit		12	11	1	22
15	Kl. Tjerë:	1.a-Nënat vetushqyese	15	6	3	18
		2.b-Persona me aftësi të kufizuar	10	17	/	27
		3.c-Pers. me aft. kufiz. me pagesë	83	36	26	90
		4.d-Dok. Administrative	/	965	965	/
		5.e-Arësye tjera	10	12	11	11
	Gjithsej:		246	1117	1054	306

Numri i shfrytëzuesve të ndihmës sociale sipas muajve

Muaj	Nr.i familjeve	Shuma
Janar	1056	117215.00
Shkurt	1033	114675.00
Mars	1058	234880.00
Prill	1093	241882.50
Maj	1094	241775.00
Qershor	1087	120017.50
Korrik	1082	119515.00
Gusht	1074	118735.00
Shtator	1093	120572.00
Tetor	1109	244025.00
Nëntor	1135	250790.00
Dhjetor	1154	25450.00

2.8. DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Punët të cilat janë kryer në Drejtorinë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, bazuar në planprogramin e punës për realizimin e objektivave, me qëllim të inkorporimit të strategjisë dhe objektivave të ekzekutivit, gjithnjë duke u bazuar në obligimet që dalin nga Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligji Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Ligji Nr.06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje dhe Statuti 01-Nr.110-6904 dt. 24.09.2008 i Komunës së Glllogocit. Në bazë të punëve të cilat janë realizuar gjatë vitit 2020, zyrtarët e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit kanë përgatitur këtë:

Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit për realizimin e punëve të planifikuara bartë mbi vete shumë detyra në sektorin e planifikimit hapësinor dhe sektorin e projekteve, duke filluar me hartimin e projekteve zhvillimore, lejeve ndërtimore si dhe realizimin e projekteve kapitale. Në bazë të detyrave dhe përgjegjësi të drejtorisë paraqesim raportin vjetor të punës për vitin 2020 sipas sektorit për Planifikim Urban dhe sektorit për Mbrojtje të Mjedisit.

SEKTORI PËR PLANIFIKIM URBAN

Në vitin 2020 zyrtarët e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit nga sektori për Planifikim Urban janë angazhuar në lehtësimin e procedurave për aplikimin e lejeve të ndërtimit, kërkesave të qytetarëve, investitorëve dhe përkrahjen e iniciativave për të pasur një planifikim urban të qëndrueshëm. Në aspektin e planifikimit hapësinor dhe urban brenda afatit ligjor janë trajtuar kërkesat, janë dhënë kushtet e ndërtimit dhe lejet e ndërtimit për objektet të cilat janë në harmoni me planet urbanistike që janë të miratuara në Kuvendin e Komunës, duke filluar nga Plani Zhvillimor Komunal dhe Urban si dhe Planet Rregulluese Urbane. Për marrjen e kushteve ndërtimore dhe lejes së ndërtimit janë dorëzuar së bashku me dokumentacionet e nevojshme edhe projektet ideore dhe projektet zbatuese të cilat janë pranuar nga zyrtarët përgjegjës, me ç'rast është bërë kontrollimi i tyre. Po ashtu janë dhënë edhe pëlqime urbanistike për objekte të cilat kanë aplikuar për përfitimin e grantëve në lëmin e bujqësisë dhe blegtorisë nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Gjithashtu janë pranuar dhe shqyrtuar kërkesa dhe ankesa të tjera të palëve dhe në kohë brenda afatit ligjor janë njoftuar palët për vendimet që janë në harmoni me legjislacionin në fuqi.

Tabela e lëndëve për këtë sektor

Nr	Emërtimi i kërkesave dhe shërbimeve	Të Shqyrtuara	Të Aprovuara	Të Refuzuara	Në Proces	Kërkesa të bartura nga viti 2019
1	Kushte ndërtimi	14	5	7	2	0
2	Leje ndërtimi	8	8	0	0	1
3	Leje rrënimi	3	3	0	0	0
4	Certifikatë përdorimi	3	2	0	1	0
5	Leje për lokacion (trafo, lojëra, terasa të lokaleve)	5	5	0	0	0
6	Certifikatë e Legalizimit	46	26	0	20	4
7	Vendim për Përfshirje në Listë të Pritjes	33	17	0	16	3
	Gjithsej lëndë të shqyrtuara	112	66	7	39	7

SEKTORI PËR PLANIFIKIM URBAN

- Miratimi dhe zbatimi i Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit për periudhën 2020-2028.

- Përfundimi i drafrit dhe procesi i finalizimit të Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit, për periudhën 2021-2029.
- Shqyrtimi i kërkesave dhe lëshimi i kushteve të ndërtimit, lejeve të ndërtimit në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim.
- Lëshimi i Certifikatës së Përdorimit të objekteve, sipas Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.05/2019 për Mbikëqyrje Inspektuese dhe Procedurën për Lëshimin e Certifikatës së Përdorimit.
- Dhënia e pëlqimeve urbanistike për bashkim dhe parcelizim të parcelave kadastrale sipas Ligjit Nr.04/L-013 për Kadastër.
- Mirëmbajtja e sistemit të adresave, vendosja e tabelave dhe numrave në terren.
- Shqyrtimi i kërkesave dhe vendimmarrja për legalizimin e ndërtimeve pa leje, deri në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit (5 shtator 2018), sipas Ligjit Nr.06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje.

SEKTORI PËR MBROJTJE TË MJEDISIT

- Hartimi dhe miratimi i Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor Komunal 2020-2028,
- Miratimi dhe zbatimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis, 2020-2028,
- Miratimi dhe zbatimi i Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit, 2020-2028,
- Miratimi dhe zbatimi i Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale të Komunës së Glllogocit 2020-2028,
- Përgatitja e raporteve për gjendjen e zonave të mbrojtura në Komunën e Glllogocit,
- Inicimi i procedurave për shpallje zonë e mbrojtur sipas Ligjit Nr.03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës,
- Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Mjedisit dhe përkrahja e iniciativave në ruajtjen e mjedisit,
- Gjelbërimi i hapësirave publike.

Punët dhe aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2020 në Drejtorinë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komuna e Drenasit









2.9. DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË

Përpilimi dhe hartimi i Raporteve të Punës nga Institucionet Komunale është prezantim i punës përball transparencës dhe llogaridhënës ndaj qytetarëve tanë.

Drejtorja për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ka prezantuar në vazhdimësi punën e saj përmes raporteve javore e mujore, të cilat kanë pasqyruar ofrimin e shërbimeve gjeodezike e kadastrale për qytetarët dhe personat tjerë relevant dhe veprimet ligjore administrative për pronën publike duke dëshmuar njëkohësisht transparencën dhe llogaridhënien përballë përgjegjësive që i takojnë.

Raporti i Punës për vitin 2020, vë në pah rritjen konstante të efikasitetit në ofrimin e shërbimeve kadastrale ndaj qytetarëve, zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore gjatë përmbushjes së detyrave të punës, trajtimin

profesional të kërkesave të palëve, kryerjen e shërbimeve në afat ligjor, ndërmarrjen e veprimeve konkrete për trajtimin e pronës komunale, rritjen e vazhdueshme të të hyrave vetanake, menaxhimin efikas të buxhetit të drejtorisë, etj.

1. Misioni dhe organizimi

Misioni

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë është kompetente dhe përgjegjëse për organizimin e kapaciteteve kadastrale, rikonstruimin e informatave kadastrale në formë digjitale, modelin e sistemit informativ mbi tokën dhe pronën në përgjithësi, planifikimin e rrjetit gjeodezik me pika të reja kontrolluese dhe themelimin e pikave kontrolluese.

Misioni primar i saj është krijimi i një ambienti ligjor në sferën e kadastrit dhe pronës komunale.

Puna e drejtorisë orientohet që përmes matjeve kadastrale, sistemit informativ të tokës dhe regjistrave zyrtar të siguroj të drejtat mbi pronat e paluajtshme me krijimin e parcelave tokësore, ndërtesave si dhe përcaktimin e kufijnjëve të tyre në komunën e Drenasit.

Qëllimi i drejtorisë është ofrimi i shërbimeve profesionale dhe shërbime të tjera subjekteve të ndryshme, përmirësimi i transferimit të tokës, menaxhimi i tokës komunale dhe efikasiteti në taksimin e tokave, evidencën për emërtimet e vendbanimeve, rrugëve, shesheve si dhe numrat e objekteve, shtëpive, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, etj.

Drejtorisë për Gjeodezi Kadastër dhe Pronësi procedon shfrytëzimin e tokave komunale, zbaton vendimet e gjykatës për ndarje, bartje të pronësisë.

Ajo ka bashkëpunim të mirë me institucionet qendrore, konkretisht me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Agjencinë Kadastrale të Kosovës si autoritet qendror i menaxhimit të të dhënave kadastrale.

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ofron shërbime profesionale dhe shërbime të tjera në fushën e kompetencave dhe përgjegjësi të saj për subjektet e së drejtës dhe organeve shtetërore, dhe me një bashkëpunim të mirëfilltë arrijnë që ti realizojnë punët e caktuara,

Organizimi

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë është e organizuar në këta sektorë:

1. Sektori i Gjeodezisë,
2. Sektori i Kadastrit,
3. Sektori i Pronës.

Në përbërjen e saj ka 8 zyrtarë aktiv

2. Organogrami

Drejtori i DGJKP

Shefi i Sektorit të Kadastrit

Shefi i Sektorit të Gjeodezisë

Shefi i Sektorit të Pronës

Zyrtare kadastrale

Zyrtare për gjeodezi

Zyrtare kadastrale

Zyrtare për gjeodezi

Zyrtare kadastrale

3. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë

Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë është përgjegjëse për:

- a. sigurimin e zotërimit të tokës, reduktimin e kontesteve për tokën,
- b. përmirësimin e transferimit të tokës, menaxhimin e tokës shtetërore dhe efikasitetin në taksimin e tokave,
- c. planifikimin e rrjetit me pika të reja kontrolluese dhe themelimin e pikave të reja kontrolluese,
- d. digjitalizimin e pikave poligonale dhe trigonometrike, vektorizimin e planeve të skanuara (ngastrave dhe zonave kadastrale),
- e. azhurnimin e pjesës grafike në bazë të dokumenteve dhe matjeve të reja dhe transformimin me parametrat e dhëna për transformim,
- f. shërbimin e mirëmbajtjes së klasifikimit dhe kulturave të tokës,
- g. ndarjen e ngastrave dhe shënimin e kufijve në rastin e shpronësimit, dhe zhvillimin e procedurave.
- h. inspektimin e sipërfaqes së ndërtesave dhe përpunimi i skicave të ndarjeve për ndërtesa dhe banesa,
- i. regjistrimin e pronës së paluajtshme dhe regjistrimin e tokës komunale,
- j. zhvillimin e procedurës së regjistrimit, sipas detyrës zyrtare dhe kërkesave të palëve,
- k. korrigjimin e regjistrit (RDPP) sipas procedurave dhe zbatimi i të gjitha dispozitat pozitive në fuqi,
- l. azhurnimin e pronës, në bazë të dokumenteve të verifikuara dhe shënimeve të tjera nga dokumentacioni arkivor, azhurnimin e regjistrit të ndërrimeve të mjeteve nga terreni,
- m. kryerjen e procedurave rreth transaksioneve të pronës publike dhe kryerjen e procedurave të blerjes dhe shitjes së pronës për komunën,
- n. shqyrtimin dhe kryerjen e procedurave administrative për rikthimin e tokës pronarëve të mëparshëm,
- o. mbrojtjen e pronës komunale – publike dhe kryen procedurat lidhur me këtë çështje,
- p. vërtetimin dhe zbatimin e shitblerjes së pasurisë së patundshme,
- q. regjistrimin e ndërtesave kolektive dhe organizon mirëmbajtjen e pjesëve të përbashkëta të tyre,
- r. udhëheqjen me kadastrën etazh të banesave, ndërtesave, si dhe ngastrat kadastrale në të cilat janë të ndërtuara banesat,
- s. regjistrimin dhe çregjistrimin e hipotekave,
- t. aktvendimet mbi regjistrimin e servituteve, qira mbajtjeve dhe barrave të ndryshme,
- u. lëshimin e certifikatave personave që nuk kanë patundshmëri,
- v. mirëmbajtjen, korrigjimin dhe harmonizime e evidencave të vendbanimeve, fshatrave, shesheve, rrugëve dhe numrat e objekteve dhe ndërtesave,
- w. nxjerrjen e aktvendimeve për miratim ose refuzim të kërkesave,
- x. nxjerrjen e konkluzioneve për plotësimin e kërkesave të pakompletuara,
- y. përgatitjen e projekt programit të punës për nevojat e Drejtorisë dhe raportin e punës,
- z. kryerjen e punëve të tjera në pajtim me dispozitat ligjore (shpalljet publike, kërkesat për nevojat e Kuvendit, të gjykatave dhe të institucioneve tjera),
- aa. mbajtjen e shënimeve për tërë tokën dhe objektet, të cilat i posedon apo i shfrytëzon Komuna,
- bb. zhvillimin e procedurës së eksproprijimit, shpronësimit dhe de eksproprijimit të tokës në pronësi të Komunës,
- cc. trajtimin dhe zhvillimin e procedurës administrative për uzurpimet arbitrare të tokës në pronësi të Komunës.

3.1. Sektori i Gjeodezisë

Spektori i Gjeodezisë brenda kompetencës lëndore, kryen punët si në vijim:

Shërbimet e mirëmbajtjes së klasifikimit dhe kulturave të tokës,

Ndarjen e parcelave,

Bashkimin e parcelave sipas kërkesës së palëve,

Përpunimi i skicave të ndarjeve për ndërtesa dhe banesa,

Rilevimi i sipërfaqes së ndërtesave,

Përsëritja e kufijve të parcelës,

Shënimi i kufijve në rastin e eksproprijimit,

Identifikimi i ngastrave dhe objekteve kadastrale,

Nxjerr konkluzione lidhur me kërkesat e palëve

Ndërsa pas hyrjes në fuqi të udhëzimit administrative MMPH-NR 12/19 të dt.21.11.2019 Spektori i Gjeodezisë nuk kryen shërbime gjeodezike për pronar, por kryen shërbime vetëm për nevoja të Drejtorisë dhe Komunës, dhe sipas këtij udhëzimi, të drejta për kryerjen e shërbimeve Gjeodezike kanë vetëm Gjeodetet e Licencuar nga AKK.

Gjatë vitit 2020 sektori për gjeodezi në tërësi ka zbatuar punët e planifikuara për këtë vit ku me sukses kemi përfunduar këto planifikime.

Spektori i Gjeodezisë në vazhdimësi kryen të gjitha këto shërbime gjeodezike sipas ligjeve dhe udhëzimeve në fuqi si:

Spektori i Gjeodezisë ka bërë një angazhim dhe një përkushtim të madh për të azhurnuar autostradën N9 në pjesën grafike dhe në RDPP edhe pse kjo autostrada është shpronësuar në vitin 2009 dhe është dashur të jetë e përfunduar por ka qenë një mos interesim nga Ministria e Infrastrukturës por me insistimin e DGJKP-së që ka bërë ndaj Ministrisë së Infrastrukturës kemi siguruar shënimet e autostradës N9.

Drejtorja ka arritur të bëjë azhurnimin e autostradës N9 në pjesën grafike dhe RDPP në të gjitha zonat të cilat janë jashtë masës komastative ndërsa autostrada që kalon në zonat kadastrale që janë masën komastative kemi bërë azhurnimin vetëm në pjesën grafike ndërsa në pjesën tekstuale RDPP do të bëhet azhurimi pas përfundimit të komasacionit.

Drejtorja e Gjeodezisë, Kadastër dhe Pronë ka qenë e angazhuar në ndarjen dhe bashkimin e parcelave të cilat parcela janë dhënë në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite dhe regjistrimin e kontratave të përfituesve në RDPP.

Gjatë këtij viti Spektori i Gjeodezisë ka trajtuar kërkesat, si në vijim:

Kërkesa për ndarje të parcelave kanë qenë 162 raste

-Bashkim parcelave 23 raste

-Modifikim i atributëve të parcelave 11 raste

-Regjistrim të ndërtesave të legalizuara 37 raste

-Koordinata të parcelave 91 raste

-Vektor të parcelave 16 raste

-Korrigjim kufiri të parcelave 110 raste

-Kopje plani gjithësejtë 788 raste

Gjatë realizimit të këtyre kërkesave kemi të hyra **12,911.00 €** nga shërbimet gjeodezike dhe **5,760.00 €** për kopje të planit. Gjithsej të hyra nga shërbimet gjeodezike edhe nga kopjet e planit janë **18,694.00 €**

Gjithsej 6 përgjigje kemi kthyer për Gjykatën në Drenas e cila ka kërkuar koordinata, 8 përgjigje për gjeodet të licencuar dhe 2 përgjigje për pale.

Spektori i Gjeodezisë është i ndërlidhur ngushtë me spektorin e kadastrës dhe është e pa mundur të funksionoj njëra pa tjetrën, të gjitha lëndët që fillojnë nga spektori i gjeodezisë dhe pas shqyrtimit dhe përpunimit të këtyre lëndëve aprovohen nga ky spektor dhe pastaj nga pala parashtrohet kërkesa në spektorin e kadastrës për t'i regjistruar në SIKTK-T.

Spektori i Gjeodezisë bashkëpunon me spektorin e pronës si në raste për definimin e pronave komunale, për përcaktimin e kufijve të parcelave, konstatime të ndryshme që janë të uzurpuara pronat dhe marrim pjesë gjatë lirit të pronave komunale për t'i caktuar kufijtë e parcelave etj.

Përveç punëve që kemi në spektorin e gjeodezisë gjatë këtij viti kemi qenë të angazhuar edhe në komisione të ndryshme, si:

Komision për krijimin e elaboratit të shpronësimit të rrugës Korroticë e Epërme-Poklek

Komision për krijimin e elaboratit të shpronësimit e pronave private për nevoja të ujit në z.kad Krajkovë

Komision për krijimin e elaboratit të shpronësimit të pronave private për stadiumin e qytetit "Rexhep Rexhepi" z.kad Poklek

Komisioni për këmbimin e pronave private me atë komunale në z.kad Baicë

Komisioni për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim

Komision për harta zonale

Komision për teknologji informative

Komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore,

Komision për shpërndarjen e serave dhe mikserëve dhe

Komision për shpërndarjen e mikserëve për ushqim të kafshëve

Komision për shpërndarjen e centrifugave mekanike për bletë.

Në dy komisione për këmbimin e pronave private me atë komunale në zonën kadastrale në Glllog

Spektori i Gjeodezisë bashkëpunon edhe me Drejtoritë tjera për të ndihmuar në realizimin e projekteve, identifikimin e pronave komunale apo kërkesave të ndryshme.

Gjatë këtij viti nga Drejtoria e Infrastrukturës kemi bërë matje në **38** kërkesa të ndryshme të cilat janë kryer në një afat kohor të shpejt me qëllim që të ofrohet lehtësira për realizimin e projekteve të ndryshme që kanë ndikuar direkt në mirëqenien e qytetarëve. Spektori i Gjeodezisë ka realizuar **33** kërkesa për Spektorin të Pronës të cilat kërkesa janë parashtuar nga administratorët e fshatrave që kryesisht kanë qenë kërkesa për lirim e rrugëve publike dhe pronave komunale. Po ashtu gjatë këtij viti 2020 kemi piketuar lumenjtë Drenica, Verboc dhe degëzimet tjera të lumenjve me një gjatësi rreth 45 km ku është bërë zgjerimi nga Drejtoria e Infrastrukturës ku shumica dërmuese e lumenjve kanë qenë në komasacion dhe për here të parë shtrati i lumenjve është hapur siqë është projektuar në komasacion gjatë vitit 1985. Kërkesa të ndryshme ka pasur

edhe në piketimin e rrugëve publike me qëllim që të bëhet asfaltimi i tyre dhe kërkesa të ndryshme për realizimin e kanalizimeve dhe kolektorve.⁷ kërkesa të ndryshme kemi pranuar edhe nga drejtoria e Inspeksionit që kryesisht janë të ndërlidhura me pronën komunale që janë uzurpuar nga qytetarët.

Gjithashtu 4 kërkesa kemi realizuar edhe për Drejtorinë e Shërbimeve Publike që ka lehtësuar punën në realizimin e projekteve të ndryshme si përcaktimin e pikave gjeodezike për rrethojat e shkollave dhe varrezave. Të gjitha këto kërkesa që kemi realizuar për drejtorinë në fjalë ka qenë punë me përgjegjësi dhe është dashur një përkushtim më i shtuar profesional me qëllim që të jemi sa më të saktë në konstatimet tona

3.2. Detyrat e Sektorit të Kadastrit

Sektori i Kadastrit brenda kompetencës lëndore, kryen punët si në vijim:

- Themelon regjistrin mbi pronën e paluajtshme,
- Zhvillon procedurat e regjistrimit sipas detyrës zyrtare,
- Zhvillon procedurat e regjistrimit sipas kërkesës së palëve,
- Bën korrigjimin e regjistrit sipas procedurave,
- Zbaton të gjitha dispozitat pozitive në fuqi lidhur me regjistrimin e pronës,
- Bën azhurnimin e pronës në bazë të dokumenteve të verifikuara dhe shënimeve të tjera nga dokumentacioni arkivor,
- Bën azhurnimin e regjistrit të ndërrimeve të matjeve nga tereni,
- Nxjerr Aktvendime dhe Certifikata sipas ligjit mbi kadastrin dhe udhëzimeve administrative për kadastrë,
- Nxjerr Aktvendime dhe Konkluzione lidhur me kërkesat e palëve,
- Koordinon punët dhe zbaton udhëzimet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

Gjatë vitit 2020 sektori i kadastrit ka kryer kërkesa të ndryshme po shumica dërmuese e kërkesave kanë qenë për:

Dhënia e certifikatave të pronës së paluajtshme
 Dhënia e certifikatave që nuk posedojnë pronë
 Regjistrimin e shitblerjes së pronës së paluajtshme
 Modifikime atributive të parcelës
 Modifikime atributive të pjesëve të ndërtesave
 Regjistrimin e ndarjeve të parcelave
 Regjistrimin dhe fshirjen e hipotekave etj.

Sektori i Kadastrit gjatë vitit 2020 ka pranuar dhe ka shqyrtuar këto kërkesa:

Lloji i shërbimit	Total	Lendet e Aprovuar	Lendet e Refuzuara	Lendet e Procesuara
Bartja e posedimit - Ndarje fizike	10	9	0	1
Bartja e posedimit - Blerje	82	78	0	4
Bartja e posedimit - Dhurim	89	81	0	8
Bartja e posedimit - Këmbim	13	8	0	5
Bartja e posedimit - Shpronësim	1	1	0	0
Bartja e posedimit - Trashëgimi	69	60	1	8

Bartja e pronësisë - Ndarje fizike	3	3	0	0
Bartja e pronësisë - Blerja	5	4	0	1
Bartja e pronësisë - Dhurata	1	1	0	0
Bartja e pronësisë - Trashëgimia	2	2	0	0
Bashkimi	24	23	0	1
Bashkimi i personave të njëjtë me ID te ndryshme	21	17	3	1
Bashkimi i personave të njëjtë me ID te ndryshme pa njësi	1	1	0	0
Fshirja e drejtës së shfrytëzimit	7	6	0	1
Fshirja e hipotekës pas skadimit të afatit	41	39	0	2
Fshirja e ngarkesës tatimore sipas vendimit të ATK	2	0	0	2
Krijimi i kopjes zyrtare te planit	775	0	5	770
Modifikimi atributëve të ndërtesës	3	3	0	0
Modifikimi atributëve të parcelës	141	137	2	2
Modifikimi i atributëve të pjesës së ndërtesës	4	4	0	0
Modifikimi i drejtës së shfrytëzimit	1	1	0	0
Modifikimi i hipotekës	9	5	2	2
Modifikimi i të dhënave të personit pa njësi kadastrale	63	60	0	3
Modifikimi i të drejtave	29	27	2	0
Modifikimi i vërejtjes	4	4	0	0
Ndarja	87	71	2	14
Regjistrimi (krijimi) i parcelës së re	2	2	0	0
Regjistrimi i hipotekës	53	44	3	6
Regjistrimi i ndërtesës	37	28	0	9
Regjistrimi i ngarkesës tatimore	5	5	0	0
Regjistrimi i pjesëve të ndërtesës	14	14	0	0
Regjistrimi i posedimit të pronës shoqërore sipas detyrës zyrtare	23	22	1	0
Regjistrimi i qiramarrjes/nënqiramarrjes	3	3	0	0
Regjistrimi i servitutit	1	1	0	0
Regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit	5	1	0	4
Regjistrimi i vërejtjes me kërkesë të palës	1	1	0	0
Regjistrimi i vërejtjes me vendim të gjykatës	1	1	0	0
Regjistrimi i vërejtjes sipas kërkesave tjera	8	7	1	0
Shërbimi i të dhënave - nxjerrja e Certifikatës	2251	0	3	2248
Shërbimi i të dhënave Vërtetim që nuk posedon pronë	1343	0	0	1343
Shërbimi i të dhënave për personat fizik dhe juridik	1	0	0	1
Totali	5235	774	25	4436

Nga të gjitha këto punë të realizuara Sektori i Kadastërit i ka të hyra nga regjistrimi pronave **16,477.00 €**, dhe nga certifikatat e pronës **11008€**, gjithsejtë **27,485.00 €**.

3.3. Detyrat e sektorit të Pronës

- Zhvillon procedurat e shpronësimit të tokave në pronësi private për interesat e përgjithshme shoqërore,
- Zhvillon procedurat e deeksproprijimit, gjegjësisht nulimit të aktvendimeve të plotfuqishme rreth shpronësimit në rastet kur plotësohen kushtet ligjore,
- Kujdeset për mbrojtjen e të dhënave pronësore, ku bartës i së drejtës së shfrytëzimit është Komuna e Drenas-it,
- Udhëheq procedurën administrative lidhur me uzurpimet arbitrare,
- Mbanë evidence për lëndët e uzurpimeve,
- Kujdeset për procedurat në përputhshmëri me ligjet në fuqi,
- Kryen procedurat e eksproprijimit,
- Nxjerr aktvendime, konkluzione lidhur me kërkesat e parashtruara, etj.

Në periudhën raportuese gjegjësisht nga Janari e gjerë në fund të muajt Dhjetor 2020,

Në sektorin e pronës, janë kryer këto punë dhe detyra:

Në teren janë realizuar 102 kërkesa nga drejtorit e ndryshme të komunës si dhe nga administratorët e fshatrave. Në zyre janë mbajtur takime me palë, si dhe janë kthyer përgjigje në kërkesat të cilat nuk ka pasur mundësi që të kryhen në teren.

Është bërë sistematizimi dhe klasifikimi i dosjeve të sektorit të pronës në foldera të veçantë, sipas viteve dhe llojit të dokumenteve.

Është krijuar dosja elektronike e dokumenteve të skanuara dhe të evidentuara në formë tabulare e sektorit të pronës.

Është bërë identifikimi i parcelave të pronave komunale të cilat janë të uzurpuara nga persona të ndryshëm, me objekte, rrethoja, parkingje, kullosa etj.

1. Propozim – Vendim për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik të pronave private në Krojkovë, për shpronësim.
2. Propozim – Vendim për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik, të pronave të Hekurudhave të Kosovës SH.A, Z.K Glllogoc, me qëllim bartjen e tyre në emër të Komunës.
3. Propozim – Vendim për bashkimin dhe parcelizimin e parcelave kadastrale Z.K Komoran dhe Z.K Glllogoc.
4. Propozim – Vendim për bashkimin dhe ndarjen e parcelave kadastrale Z.K Komoran dhe Z.K Glllogoc, për dhënie në shfrytëzim.
5. Propozim – Vendim për caktimin e lokacionit për vendosjen e bustit të heroit “Fetah Kiçina”, Z.K Baicë.
6. Propozim – Vendim për caktimin e lokacioneve për ndërtimin e fushave sportive në Z.K Abri e Epërme dhe në Z.K Zabel i Epërm.
7. Propozim – Vendim për rrënimin e ish objekteve të Komunës së Drenasit.
8. Propozim – Vendim për shfuqizimin e vendimit për definimin dhe parcelizimin e të gjitha varrezave të cilat ndodhen në prona komunale të Komunës së Drenasit, shfuqizimi i këtij Vendimi është bërë me rekomandim nga MPL.
9. Propozim – Vendim për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik të pjesës së ngastrës kadastrale Z.K Poklek parcela nr. 120/0, në emër të Sadri (Hasan) Muqolli, për shpronësim, për interes të Stadiumit të Qytetit “Rexhep Rexhepi” Poklek.

10. Propozim – Vendim për këmbimin e parcelave në Z.K Baicë, këmbimi i pjesës së parcelës private në emër të Ajet (Tafë) Kiçina, me pjesën e parcelës prone Komunale.
11. Propozim – Vendim për këmbimin e pjesëve të njësive kadastrale Z.K Glllogoc, prona private në emër të Agron Mala, me pronën komunale KK Glllogoc.
12. Propozim – Vendim për këmbimin e parcelave në Z.K Glllogoc, prona private në emër të Sami Bequku, me pronën komunale KK Glllogoc.
13. Propozim – Vendim për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik të Objekteve Banesore Z.K Glllogoc, prona private të dhëna në shfrytëzim të përhershëm në parcelën 743/1.
14. Propozim – Vendim për këmbimin e pronave të paluajtshme (Objekteve Banesore) në Z.K Glllogoc parcela nr 743/1.
15. Propozim – Vendim për Shpronësimin e Objekteve Banesore Z.K Glllogoc, të cilat ndodhen në parcelën nr 743/1.

Të gjitha këto Propozim Vendime janë miratuar nga ana e Kuvendit të Komunës e po ashtu e kanë arrit edhe ligjshmërinë në MPL, dhe është vazhduar tutje lidhur me arsyen me të cilën janë përpiluar, me përjashtim të Propozim – Vendimit për Shpronësimin e Objekteve Banesore në Z.K Glllogoc, i cili është në pritje në MPL. Kemi pranuar kërkesa për heqje dorë nga Pronësia dhe ti jipet Komunës gjithsej 4, po ashtu edhe janë përpiluar Deklaratat e Mirëkuptimit dhe janë bërë regjistrimet në RDPP, dhe është bërë bartja nga prona private në emër të KK Glllogoc.

Deklaratat e përpiluara janë:

1. Deklaratë Mirëkuptimi nga Bajram Bajraktari nga Drenasi,
2. Deklaratë Mirëkuptimi nga Hamit Behrami nga Domaneku,
3. Deklaratë Mirëkuptimi nga Islam, Elmi dhe Remzi Qorri nga Drenasi dhe
4. Deklaratë Mirëkuptimi nga Sabit Nebihi nga Domaneku.

Po ashtu gjatë këtij viti janë përpiluar edhe vendime të ndryshme si në vijim:

1. Vendim Preliminar për Shpronësim të pronës së paluajtshme private në Z.K Krojkovë, për ujë të pijes në Krojkovë.
2. Vendim Preliminar për Shpronësim të pronës së paluajtshme private në Z.K Poklek, për Stadiumin e Qytetit “Rexhep Rexhepi” Poklek.
3. Vendim Përfundimtar për Shpronësim Krojkovë,
4. Vendim Përfundimtar për Shpronësim Poklek dhe
5. Vendim Përfundimtar për Shpronësim në Z.K Poklek, Z.K Korroticë e Ulët dhe Z.K Korroticë e Epërme, për ndërtimin e rrugës tranzitore “Feronikel – Kroni i Mbretit”.

Është në procedure e sipër pagesa e kompensimit të pronarëve të pronave të shpronësuara, ku janë kompletuar disa dosje të tyre për pagesa, disa dosje të pronarëve janë dërguar për pagesa në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

Janë shpallur 18 uzurpator si dhe tri raste janë në procedurë.

Lëndet e intranetit

Raporti sipas departamenteve dhe statusit të zgjidhjes

01/01/2020 - 31/12/2020, Drejtoria: DGJPK

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE PËR VITIN 2020

Shkurtesa	Përshkrimi	Pranuar	Ne Proces	Miratuar	Refuzuar	Hedhur Poshtë	Pezulluar	Ceduar	Anuluar	Përfunduar	Totali
DGJP K	Drejtoria për Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër	10	1	5,117	8	1	17	0	57	0	5,211
		10	1	5,117	8	1	17	0	57	0	5,211

Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë															
Tax regj.pronë	50011	30,000	562	2,089	1,508	140	825	1,036	1,825	1,173	1,660	1,092	1,222	1,565.00	14,697.00
Tax fl.pos.kop .pl.	50012	15,000	9260	997	630	32	423	1,081	2,072	4,233	1,244	1,115	1,281	775.80	14,809.80
Matje gjeodezike	50504	50,000	742	332	43		231	639	96	340	194	56	213	163.00	3,049.00
Shitja e pronës	50413	15,843													-
65005	Tota li	110,843	2,230	3,418	2,181	172	1,479	2,756	3,993	5,746	3,098	2,263	2,716	2,503.80	32,555.80

Të hyrat vetanake sipas programeve dhe fushave kryesore të të hyrave të planifikuara për vitin 2020.

5. Baza ligjore mbi të cilën funksionon DGJKP

Statuti i KK Drenas.

Ligji nr. 2002/5 mbi themelimin e Regjistrit të të Drejtave në Pronë të Paluajtshme.

Ligji nr 2003/13 mbi ndryshimet dhe plotësimet e ligjit nr. 2002/5.

Ligji nr 2003/25 mbi Kadastrin.

Ligji për dhënien në shfrytëzim dhe Këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës nr. 06/L-092.

Ligji nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore.

Ligji nr. 03/L-205 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

Ligji nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Udhëzimi nr. 2004/3 Administrativ i MShP.

Udhëzimet administrative të AKK nr. 2003/1 dhe nr. 2004/1.

Udhëzim pune AKK nr. 01/131/06.

[Udhëzim Administrativ \(Mea\) Nr. 09/2020 Për Tarifat E Shërbimeve Për Regjistrimin E Të Drejtave Të Pronës Së Paluajtshme](#)

[Udhëzim Administrativ Mmph Nr 08-2019 Për Tarifat E Produkteve Dhe Shërbimeve Të Agjencisë Kadastrale Të Kosovës](#)

[Udhëzim Administrativ \(Mmph\) Nr 13-2019 Për Licencimin E Kompanive Gjeodete Dhe Të Gjeodetëve](#)

[Udhëzim Administrativ Mmph – Nr 09-19 Për Ndarjen E Zonave Kadastrale](#)

[Udhëzim Administrativ Mmph – Nr 10-19 Për Matjet Kadastrale Për Regjistrim Në Kadastër](#)

[Udhëzim Administrativ Mmph – Nr 11-19 Për Ndarjen E Ndërtesës Dhe Të Pjesës Së Ndërtesës](#)

[Udhëzim Administrativ Mmph – Nr 12 19 Për Ndarjen Dhe Regjistrimin E Parcelës](#)

[Udhëzimi Administrativ Nr.14 2019 Për Caktimin E Emërimit Dhe Numërimit Të Adresave Për Zona Të Qarkullimit Publik, Ndërtesa, Shtëpi, Objekte Dhe Parcela Kadastrale Të Lira](#)

[Udhëzim Administrativ Nr.15 2019 Për Renditjen E Elementeve Të Adresave Dhe Caktimin E Formatit Të Shkronjave, Numrave Dhe Të Tabelave Të Adresave](#)

[Udhëzim Administrativ Mmph Nr 16 Për Procedurat E Krijimit Dhe Administrimit Të Regjistrimit Komunal Të Adresave Dhe Regjistrimit Shtetëror Të Adresave](#)

[Udhëzim Administrativ Mmph Nr. 17 Për Krijimin Dhe Administrimin E Listës Alfabetike Për Emërtime, Listës Rezervë Dhe Vendosijen E Tyre Në Regjistrin Komunal Të Adresave](#)

[Udhëzimi Administrativ Nr.18 2019 Për Vendosijen Fizike Të Tabelave Të Adresave Në Zona Të Qarkullimit Publik, Ndërtesa, Shtëpi, Objekte Dhe Parcela Kadastrale Të Lira](#)

2.10. DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË

	Arritjet/progresi/përformanca kyçe gjatë vitit 2020
Aktivitetet kryesore Qershor-Janar-2020	Në pajtim me nenin 17 pika f e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Drenasit, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë, gjatë vitit 2020 është angazhuar që të realizojë punët dhe detyrat që kanë qenë të parapara me Plan programin e punës.
Aktivitetet për Ditën Ndërkombëtare të Tokës	DSHPE me dt. 22/04/2020 shënoi 22 Prillin - Ditën Ndërkombëtare të Tokës dhe më datën 05/06/2020 Ditën Botërore të Mjedisit dhe 19.09.2020 Dita botërore e pastrimit. Në këto dy ditë mjedisore janë realizuar aktivitete të rëndësishme si: - Pastrimi i hapësirave publike në Qendër të qytetit;

	- Mbjellja e luleve; - Mbjellja e Drunjëve në Shkollat Fillore të Mesme të Ulët “Rasim Kiçina”, “Halil Bajraktari”, “Arif Shala”. - Largimi i mbeturinave në brezin rrugorë të rrugës “Ajet Rrukiqi”; - Largimi i deponive ilegale; - Pastrimi nga mbeturinat i hapësirave të pishave në Gllobar, - Mbjellja e drunjëve në parkun e qytetit,
Aktivitetet në fushën e menaxhimit të mbeturinave	Për të arritur objektivat Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave, përkatësisht aktivitetet që janë të parapara në këtë plan janë realizuar këto aktivitete: 1. Përmes bashkëfinancimit nga komuna e Drenasit dhe mbështetur nga bashkëpunimi Gjerman për zhvillim - GIZ, komuna e Drenasit ka përfutur projektin “Kompostimi Shtëpiak” në vlerë prej 326 shportave (komposterëve) për ndarjen e mbeturinave organike. Nëpërmjet projektit për kompostim shtëpiak në bashkëpunim me ekonomitë familjare ku do të realizohet projekti do të sigurojmë parakushte për qytetarë për ndarje të mbetjeve organike përmes ofrimit të komposterit si infrastrukturë, zvogëlim i kostos së deponimit të mbeturinave përmes zvogëlimit të sasisë së mbetjeve që shkojnë në deponi, profit ekonomik përmes prodhimit të plehut organik prej ndarjes së mbetjeve për kompostim për nevoja individuale dhe ngritje të vetëdijes së komunitetit për rëndësinë e trajtimit të mbetjeve si resurs për përfitim. 2. Blerja e Kontejnerëve me qëllim të rritjes së numrit të ekonomive familjare dhe bizneseve në sistemin e menaxhimit të mbeturinave; 3. Përmes projektit “Blerja e Kontejnerëve dhe Shportave për Mbeturina” të financuar nga komuna e Drenasit janë blerë 380 kontejnerë 120 dhe 240 litërsh. Këta kontejnerë i janë dorëzuar kompanisë “Pastrimi” e cila në bashkëpunim me zyrtarët komunal do të shpërndajë shportat me qëllim që çdo ekonomi familjare dhe biznes të ketë qasje në sistemin e menaxhimit të mbeturinave. 4. Procesi i shpërndarjes së shportave dhe rritja e numrit të klientëve që ju ofrohet shërbimi i grumbullimit të mbeturinave. - Ky proces në vazhdimësi është duke u realizuar dhe si rezultat i këtyre aktiviteteve në këtë vit janë duke hyrë në sistem të menaxhimit të mbeturinave edhe shumë ekonomi familjare, Institucione (shkollat), e biznese. Për ta arritur qëllimin, jemi duke bashkëpunuar me Drejtoratin e Inspektoriatit. Sa i përketë mbulueshmërisë në sistemin e menaxhimit të mbeturinave kemi mbulueshmërinë në 100% të territorit të Komunës së Drenas-it. 4. Projekti “Ndarja e Mbeturinave të Riciklueshme në Burim” - Komuna e Drenasit ka pranuar donacion nga Gizi – Gjerman në vlerë prej 100 kontejnerëve 240 litërsh, me qëllim zgjerimin e zonave dhe rritjen e numrit të ekonomive familjare që kanë qasje në ndarjen e mbeturinave të riciklueshme në burim. 5. Investimet në stacion transferin e mbeturinave;

	Në deponinë e transferit është siguruar makina - presa nga kompania “Pastrimi” ku si rezultat do të mundësohet paketimi (presimi) i mbeturinave të riciklueshme nga vetë kompania “Pastrimi”, e gjithë kjo do të ndikojë në zvogëlimin e sasisë së mbeturinave dhe koston e shpenzimeve në bartjen e tyre deri në deponinë regjionale. Po ashtu këtë vit komuna e Drenasit ka shprehur gatishmëri për bashkëfinancim në kuadër të përfuturit të projektit “Rehabilitimi i Stacionit të Transferimit të Mbeturinave në komunën e Drenasit” i cili do të mbështetet nga “KRM Pastrimi”, GIZ dhe CMSR. 6. Procesi i identifikimit të deponive ilegale; Gjatë këtij viti është realizuar identifikimi i deponive ilegale për vitin 2019 nga zyrtari komunal për menaxhimin e mbeturinave dhe inspektori komunal mjedisor në bashkëpunim me GIZ/in. Gjatë këtij procesi është bërë identifikimi i 31 deponive ilegale në komunën e Drenasit nga 90 që ishin në vitin 2018. Prej gjithsej 31 deponive ilegale të identifikuara 11 prej tyre janë të vogla, 9 të mesme dhe 11 të mëdha. 7. Projekti për eliminimin e deponive ilegale; - Në kuadër të projektit për eliminimin e deponive janë duke u realizuar aktivitetet punuese për largimin e deponive ilegale edhe përgjatë vitit 2020 ku deri më tani janë larguar 13 deponi të mbeturinave. Pas largimit të mbeturinave në ato vende do të vendosen tabela informuese mbi ndalim hudhjen e mbeturinave në mënyrë jo adekuate. 8. Projekti për mirëmbajtjen e deponisë inerte në Llapushnik; - Në kuadër të këtij projekti mundësohet mirëmbajtja e deponisë inerte në Llapushnik e cila është e destinuar për hudhjen e mbeturinave ndërtimore.
Aktivitetet në realizimin e projekteve kapitale	Për realizimin e projekteve kapitale janë kryer këto aktivitete kryesore: • Hartimi i deklaratave të nevojës për projektet e DSHPE-së, • Hartimi i kërkesave për zotim të mjeteve , • Hartimi i projekteve ideore për secilin projekt, • Hartimi i paramasave dhe parallogarive , • Caktimi i organeve për mbikëqyrjen e projekteve, • Faza e implementimit të projekteve, • Faza e pranimit teknik të projekteve. Gjate këtij viti janë realizuar projektet një vjeçare dhe ato që janë me kontratë kornizë , të cilat po i paraqesim si me poshtë. • Rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave në Komunën e Drenasit Në kuadër të këtij projekti është bërë rregullimi i rrethojës së varrezave, ky projekt është procedura të zhvillimit në prokurim dhe këtë vit do të bëhet rregullimi i varrezave në fshatrat: Terdec (Lagja e Tahiraj), Terstenik (Lagja Zhushi, Hoti) , Vasilevë dhe Krojkovë • Renovimi i rrugëve të asfaltuara- (kontratë kornizë), janë riparuar disa pjesë të rrugëve në qendër të qytetit në rrugët “Ilaz Kodra”, “Fehmi e Xhevë Lladrovci”, ”Besim Mala” dhe në fshatrat, në rrugën “Sokol Elshani” në Drenas, Baicë, Likoshan , Sankoc lagja Janova, dhe është mbyllur kontrata kornizë trevjeçare. • Zgjerimi dhe mirëmbajtja e kamerave në komunën e Drenasit: Është bërë rregullimi i defekteve për 25 kamerat e qytetit, dhe tani më janë në funksion, po ashtu ky projekt vazhdon edhe vitet në vijim.

	• Mirëmbajtja dhe zgjerimi i ndriçimit Publik: (kontratë kornizë), ky projekt është realizuar në fillim, mandej kompania e kontraktuar nuk është përgjigjur kërkesave që janë adresuar nga qytetarët, andaj lidhur më këtë kemi dërguar rekomandimet në zyrën e prokurimit. • Bashkëfinancim i projekteve: Ky projekt kryesisht është realizuar në bashkëpunim me GIZ-in ku janë blerë komposteret dhe është bërë shpërndarja e tyre, po ashtu janë blerë edhe kontejner te tjerë për mbeturina. • Blerja e kontejnerëve dhe shportave për mbeturina: Ky projekt është realizuar duke bërë furnizimin e dy lloje të kontejnerëve dhe atë: 120 l dhe 240 l, dhe janë shpërndarë në ekonomit familjare dhe biznese gjatë procesit të zgjerimit. • Shenjëzimi Vertikal dhe Horizontal i rrugëve (Kontratë Kornizë): Është realizuar projekti i shenjëzimit vertikal dhe horizontal në të gjitha vendet ku kemi pasur kërkesa si: Shenjëzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve në qendër të qytetit, parkingjeve, shenjëzimi vertikal për vendndalje të autobusëve, shenjëzimi horizontal në stacionin e autobusëve, kompletimi me shenjëzim vertikal tek rrugët ku atakohen me hekurudhën, shenjëzimi horizontal dhe vertikal i zebrave në rrugët në qendër të Drenasit, dhe vendbanime tjera ku ka qenë e nevojshme, sidomos në rrugët që janë në afërsi të shkollave. • Mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonës dimërore për vitin 2019- 2020. Projekti ka filluar sipas sezonës dimore dhe ka përfunduar sipas kontratës. Në këtë projekt kanë qenë të përfshira për mirëmbajtje dhe pastrim nga bora rreth 530 km rrugë dhe 26,405 m², sipërfaqe me parkingje, Sheshe dhe trotuare, dhe është e lidhur kontrata kornizë për tri vitet në vazhdim me kompaninë “PASTRIMI” • Mirëmbajtja e rrugëve gjatë verës (projekt kornizë)- është nënshkruar kontrata me kompaninë Publike KRM dhe është duke vazhduar realizimi me larje dhe fshirjet e rrugëve kryesore dhe atyre periferike të qendrës së qytetit të Drenasit në çdo javë, dhe në rrugët e qendrës së Komoranit. • Mirëmbajtja e kanalizimeve fekale dhe atmosferike dhe gropave septike(kontratë kornizë: Ky projekt është duke u implementuar në gjithë territorin e Komunës, në bazë të kërkesave të ardhura nga administratoret e fshatrave, dhe detyrës zyrtare që është e paraparë me ligje për mirëmbajtje të ambientit (kanalizimeve atmosferike, fekale dhe gropave septike), të cilat po kryhen në mënyrën më të mirë të mundshme duke zhblllokuar kanalizimet të cilat me vite kanë qenë te pazgjidhura. Në këtë rast janë bërë disa bllokime të kanalizime me gypa duke filluar nga ata Ø200, 250, 315 dhe 400 (mm), dhe pastrimi gropave septike dhe kanalizimit atmosferik. Kjo kontratë ka përfunduar dhe pritet të vazhdoj në vitin tjetër. • Mirëmbajtja e rrugëve të rendit të katërt me zhavor- Është duke u implementuar në bazë të kërkesave të administratoreve të fshatrave, dhe janë duke realizuar të gjitha ato kërkesa që janë të arsyeshme, në të gjitha fshatrat e komunës së Drenasit. • Mirëmbajtja e parqeve dhe gjelbërimi i qytetit të Drenasi (kontratë kornizë): Ky projekt është implementuar sipas paramasës dhe parallogarisë. • Projekti i renovimit të objektit të Zjarrfikëseve. Është realizuar rregullimi i rrethojës së Objektit të zjarrfikësve me rrethoj të tipit Gilinder, dhe është përfunduar në mënyrën më të mirë të mundshme.
--	--

	• Projekti i eliminimit të deponive ilegale, ky projekt është implementuar në dy faza dhe janë eliminuar deponitë e egra dhe deri me tani janë larguar 28 deponi të mbeturinave në territorin e Komunës së Drenasit. • Projekti për Intervenimet Emergjente: (kontratë kornizë), Ky projekt është nënshkruar kontrata dhe ka filluar implementimi në terën sipas kërkesave të adresuar nga qytetarët. Po ashtu duhet të theksohet që zyrtaret e DSHPE-së për rastet emergjente dhe në projektet tjera(si ai i mirëmbajtjes së rrugëve gjatë dimrit dhe projektet tjera), • Projekti për Shërbimet e varrimit për qytetarët e Komunës së Drenasit: ky projekt është implementuar në bazë të shënimeve të sjelluara nga Bashkësia Islame për shërbimet e kryera. Është e rëndësishme të ceket se për shkak të gjendjes së krijuar me COVID, kemi pasur numër më të madh të rasteve të vdekjeve dhe kontrata është përfunduar një muaj më herët dhe është lidhur kontratë tjetër. • Nga aspekti i Efiqencës së Energjisë është formuar grupi punues për përgatitje për aplikim për projekte të fondit efiçent. Në kuadër të këtij projekti grupi punues ka aplikuar me shtatë (10) projekte, Fondin e Kosovës për Efiqencë të Energjisë të cilat projekte janë në listën e Planit komunal të Veprimit për Efiqencë të Energjisë dhe implementimi i tyre pritet të realizohet në vitin 2021
Ndarja e subvencioneve	▪ Për vitin 2020 ,DSHPE-ja, ka planifikuar buxhetin edhe për subvencione dhe transfere, ku këto mjete kryesisht janë shpenzuar për t'iu dalë ndihmë familjarëve të cilëve u janë shkaktuar dëmet nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera (zjarre, vërshime, erëra. Po ashtu nga komisioni komunal i caktuar nga zyra e kryetarit kanë bërë vlerësimet e dëmeve dhe janë hartuar edhe vendimet për përfituesit e subvencioneve dhe janë përcjellur nga ana jonë për pagesë.
Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave	▪ Gjatë periudhës gjashtë mujore në adresë të DSHPE-së janë pranuar këto kërkesa: - 470 – kërkesa të ndryshme siç janë: - kërkesa për mirëmbajtje të kanalizimit dhe gropave septike, të cilat janë realizuar dhe trajtuar të gjitha. - kërkesa për shenjëzim horizontal dhe vertikal të komunikacionit, - kërkesa për zhavor për rrugët e rendit të IV, - kërkesa për renovimin e gropave të asfaltit , - kërkesa për zgjerim të ndriqimit publik, - kërkesa për parkingje të rezervuara, - kërkesa për pastrimin e deponive ilegale të mbeturinave, - kërkesa për rregullimin e rrethojave për varreza, - kërkesa për kompensim të dëmeve nga FNFT dhe - kërkesa të natyrave tjera të ndryshme. - Kërkesë për furnizim me ujë higjienik • Të gjitha kërkesat janë shqyrtuar dhe sipas detyrës zyrtare ato që kanë qenë të realizueshme kanë përfunduar, ndërsa pjesa tjetër ose është refuzuar ose është ende në proces për shkak të mungesë së buxhetit, mirëpo u është kthyer përgjigje palëve. Punëtorët e DSHPE- janë duke punuar jashtë orarit të punës, prandaj duhet gjetur mundësin e kompensimit për këtë orët jashtë orarit.

Menaxhimi i Stacionit të Autobusve dhe parkingjeve publike	DSHPE-ja në bazë të Vendimit 01 Nr. 344-8563 prej dt. 16/02/2016, ka në Menaxhim Stacionin e Autobusëve me objekte përcjellëse në Glllogoc, deri sa të definohet statusi i tij. Pagesa e tarifave në emër të kryerjes së shërbimeve për peronizim, provision nga Operatorët Ekonomik bëhen në lartësi të tarifës së shërbimeve që janë përcaktuar nga Ministria e Infrastrukturës në Prishtinë për Stacionet e Autobusëve të kategorisë së dytë, mirëpo këtë vit për shkak të pandemisë janë respektuar vendimet e marra nga niveli qendror. Në fushën e menaxhimit të parkingjeve publike, janë bërë shenjëzimet e vertikale dhe horizontale të parkingjeve të rezervuara dhe janë duke u lëshuar leje për shfrytëzim një vjeçar.								
Shërbimi i zjarfikësve	DSHPE-ja në bashkëpunim të plotë me Njësinë Profesionale të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit (NJPZSH), Rastet emergjente: Gjatë gjashtë muorit të parë në territorin e komunës së Drenasit, ka pasur situata emergjente të cilat janë trajtuar dhe më theks të veçantë vërshimet, rastet e zjarreve fushore dhe malore të cilat shumica prej tyre, dyshohet që janë shkaktuar si pasojë e pakujdesisë nga faktori njeri, po ashtu zjarret në objektet e banimit dhe objekte të tjera. Për të gjitha rastet janë marrë masat për reagim të shpejt në parandalimin dhe zvogëlimin e dëmeve të shkaktuara. Pjesëmarrja ka qenë aktive në të gjitha rastet emergjente duke përfshirë të gjitha rastet e FNFT. Intervenimet e NJPZSH-së ishin si në vijim: <table> <tr> <td>1) Shuarje të zjarreve</td><td>210</td></tr> <tr> <td>2) Shërbime teknike(furnizim me ujë)</td><td>80</td></tr> <tr> <td>3) Vërshime</td><td>1</td></tr> <tr> <td>4) Intervenime teknike</td><td>22</td></tr> </table>	1) Shuarje të zjarreve	210	2) Shërbime teknike(furnizim me ujë)	80	3) Vërshime	1	4) Intervenime teknike	22
1) Shuarje të zjarreve	210								
2) Shërbime teknike(furnizim me ujë)	80								
3) Vërshime	1								
4) Intervenime teknike	22								
Takimet zyrtare	- Takim me organet kompetente që mundë të kontribuojnë, me qëllim të bashkëpunimit në mbarëvajtjen e punëve në Drejtorinë e Shërbimeve Publike - Takime me përfaqësuesit e organizatës së Giz-it (për çështje të komposterave), - Takim me Asociacionin e Komunave të Kosovës,(takime online, në formë virtuale) - Takim me agjencionin e Emergjencave-AME, (takime online, në formë virtuale) - Takim me strukturat e KEDS-it, - Takime me administratorët e fshatrave, me biznese, me qytetar rreth menaxhimit të mbeturinave, ndarjes dhe zgjerimit të shërbimit, furnizim me ujë pijshëm.								
Vizioni i DSHPE-së:	Vizioni i këtij Drejtorati është që të kryej të gjitha punët dhe detyrat që janë të parapara me Statutin e Komunës, Ligjin për Qeverisje Lokale, dhe planin e punës së DSHPE-së.								
Misioni i DSHPE-së	Misioni i DSHPE-së është që të rritë cilësinë e shërbimeve publike, mirëmbajtjen e infrastrukturës në përgjithësi, dhe rritjen e mirëbesimit të qytetarit në kryerjen e këtyre shërbimeve.								
Qëllimi i DSHPE-së:	Është që të ngrisë standardin në mirëmbajtjen e infrastrukturës së shërbimeve publike, duke i realizuar të gjitha projektet e mirëmbajtjes që përfshijnë: Mirëmbajtjen e rrugëve të asfaltuara dhe të rendit të – IV, trotuareve, mirëmbajtjen e kanalizimit fekal dhe atmosferik, menaxhimin dhe trajtimin e mbeturinave, mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësin për ujë të pijes, mirëmbajtjen e ndriçimit publik, mirëmbajtjen e								

	parqeve, shesheve dhe hapësirave të gjelbërta, Shërbimi i transportit publik me autobus dhe autotaxi , mirëmbajtjen e parkingjeve, mirëmbajtjen e rrugëve gjatë sezonit të verës dhe dimrit, shenjëzimin horizontal dhe vertikal të rrugëve,menagjimin dhe trajtimin e rasteve emergjente që shkaktohen nga e fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, shërbimin e varrimit për qytetarë.
--	--

2.11. INFRASTRUKTURA PUBLIKE

Zyrtarët nga Drejtoria për Infrastrukturë Lokale, detyrat e punës i kanë kryer duke u bazuar në planprogramin e punës, duke u mbështetur në Ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës, si dhe në bazë të detyrave e obligimeve të përcaktuara me Statutin e Komunës së Drenasit.

Drejtoria për Infrastrukturë Lokale për realizimin e punëve të planifikuara mbartin mbi vete shumë aktivitete në sektorin e Infrastrukturës lokale dhe sektorin e projekteve, duke filluar me hartimin e projekteve zhvillimore, investimet kapitale. Në përputhje me këto detyra dhe përgjegjësi, paraqesim raportin e punës për vitin 2020 sipas sektorëve:

SEKTORI I INFRASTRUKTURES LOKALE

Në sektorin e Infrastrukturës jemi angazhuar si drejtori në përmirësimin e procedurave për aplikimin e lejeve, kërkesave të qytetarëve, investitorëve dhe përkrahjen e iniciativave për të pasur një planifikim të qëndrueshëm dhe realizim të projekteve kapitale. Gjithashtu janë shqyrtuar edhe kërkesa dhe anketa tjera të palëve brenda afatit ligjor dhe me kohë i'u kemi përgjigjur dhe njoftuar palët për vendimet e ndërmarra në harmoni me ligjet ekzistuese.

Tabela e përgjithshme e lëndëve gjatë vitit:

Nr	Emërtimi i kërkesave dhe shërbimeve	Pranuara	Aprovuar a	Refuzuara	Në Proce s
1 2	Leje ndërtimi-projekte infrastrukturore(KEDS)	103	103	x	X
6	Pëlqime (për Infrastrukturë)	5	5	x	x
7	Njoftime për lëndë të ndryshme(kërkesa)	929	894	32	3
Totali:		1037	1002	32	3

Gjithashtu janë trajtuar kërkesat për infrastrukturë rreth problemeve infrastrukturore etj. Klasifikimi, renditja dhe regjistrimi i lëndëve dhe projekteve të drejtorisë (të gjitha me numër dhe emër në data bazën elektronike të krijuar në kuadër të drejtorisë).

-Kontrollimi i projekteve ideore dhe zbatuese në aspektin teknik profesional dhe dhënia e pëlqimit për hartimin e projektit zbatues.

-Hartimi i pëlqimeve të ndryshme për shfrytëzimin e objekteve infrastrukturore

-Hartimi i pëlqimeve të ndryshme për kompani publike dhe private (Kompaninë e Ujësjellësit dhe Kanalizimit, Kompaninë e Pastrimit, Keds-in,Ipko-n ,Posta dhe Telekomit i Kosovës).

-Hartimi i aktvendimeve të ndryshme për mbikëqyrje dhe menaxhim të kontratës, pranime teknike të projekteve kapitale, përgatitja e raporteve të ndryshme për mbikëqyrje dhe pranimin teknik të projekteve kapitale në Komunën e Drenasit.

Gjatë realizimit të projekteve kapitale që janë paraparë për realizim gjatë vitit 2020 nga buxheti komunal, grantet dhe donacionet e ndryshme, ne si drejtorat jemi angazhuar me tërë stafin që të realizojmë projektet kapitale dhe hartimin e planeve të nevojshme komunale. Janë kryer një numër i konsiderueshëm projekteve zbatuese në konsultim me kompaninë projektuese. Projektet kapitale si: rrugët, trotualet, ujësjellësit, kanalizimet, ndërtimi i objekteve të reja shkollore, ura, mure mbrojtëse, gropa septike,renovime,kanale kulluese, ndriçim publik, pastrim i lumit etj. që janë realizuar gjatë këtij viti janë kryer sipas kontratave të nënshkruara. Në të njëjtën kohë kemi qenë të fokusuar edhe në rritjen e cilësisë së punës dhe në përgjithësi është e kënaqshme. Jemi angazhuar si drejtorat që të kemi një performancë edhe më të mirë brenda mundësive dhe kapaciteteve profesionale që i kemi në dispozicion.

PROJEKTET KAPITALE QË JANË REALIZUAR GJATË VITIT 2020

LISTA E PROJEKTEVE TË REALIZUARA PËR VITIN 2020		
RRUGËT ME ASFALT DHE KUBËZA BETONI		
Nr	Emërtimi i Projektit	Gjatësia e rrugëve të realizuara në m'
	Totali i përgjithshëm për Asfalt në m'	24,000m'
	TROTUALET	
	Totali i përgjithshëm për Kubëza në m'	6300m'
	KANALIZIMET ne Km'	45km'
	<u>Total i përgjithshëm për Kanalizim nëm'</u>	Gjatësia e kanalizimeve të realizuara në m'
		45,000.00 m'
	Kolektorët ne Km'	25km'
	<u>Total i përgjithshëm për Kolektorëve në m'</u>	Gjatësia e kolektorëve të realizuara në m'
		25000m'
	UJËSJELLËS	
	Totali i përgjithshëm për ujësjellës në m'	Gjatësia e ujësjellësit të realizuara në m'
		1750 m'
	NDRIÇIM PUBLIK	
	Totali i përgjithshëm për ndriçim në m'	Gjatësia e rrjetit të ndriçimit publik të realizuara në m'
		30,000.00m'

	Rregullim i shtratit te lumit dhe pastrim I tyre	Gjatësia e rregullimit dhe pastrimit te Lumit,përrockave realizuara në m'
		26,000.00m'
	Pastrimi dhe rregullimi i kanaleve kulluese m'	
		15,000.00m'
	Rregullimi i urës, tombinave dhe mure mbrojtëse	1 Urë ; 3 tombinave dhe 4 mure mbrojtëse

Hartimi i projekteve zbatuese për:

Gjithashtu kemi përgatitur me kohë listën me kërkesat dhe nevojat e qytetarëve për investime kapitale për vitin 2020, kemi pranuar me shkrim kërkesat e administratorëve të fshatrave për investime dhe i kemi paraqitur në kornizën afatmesme për planifikimin e buxhetit për vitet 2020-2023 para Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit Komunal. Jemi munduar t'i japim prioritet projekteve të mbetura gjysmë dhe disa projekte që kanë qenë të domosdoshme. Në prioritet kemi vënë një numër të madh kanalizimesh, rrugëve, trotuareve dhe ndriçim publik në krahasim me vitin që lamë pas sepse ishin edhe kërkesat e qytetarëve.

PROJEKTET KAPITALE TË PËRFITUARA NGA DONACIONET ME BASHKËFINANCIM ME KOMUNËN E DRENASIT

Përveç projekteve që janë financuar me buxhetin e Komunës sonë me angazhimin e stafit të drejtorisë dhe me mbështetjen e kryetarit të Komunës, kemi arritur që të përfitojmë edhe projekte të cilat i financojmë me ndihmën e granteve të qeverisë dhe nga donatorët e ndryshëm. Me seriozitet dhe punë profesionale kemi arritur që t'i bindim donatorët që këto mjete t'i investojnë në Komunën e Drenasit.

Projektet që janë financuar në Komunën tonë me ndihmën e granteve dhe donatorëve janë:

–Asfaltimi i rrugëve nga memorandume te bashkëpunimit në periudhën 2 dhe 3 vjeçare të financuara nga niveli qendror:

- Asfaltimi i rrugës Terdec-Vuqak
- Asfaltimi i rrugës Kroj i Mbretit deri tek Liqeni i Vasileves
- Asfaltimi i rrugës Tranzit Kroj i Mbretit-F
- Asfaltimi i rrugës Gradicë-Zhilivodë

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në vlerë prej 315,000.00 € (Granti i performancës)

--Kolektorët për grumbullimin e ujërave të zeza në Komunën e Drenasit

Memorandum bashkëpunimi me OJQ “Jetimat e Ballkani” për këtë vit

-Rregullimi i 24 shtëpive për familjet në nevojë

AKTIVITETET

- Përgatitja dhe dorëzimi i projekteve kapitale të komunës në Ministrinë e Infrastrukturës, MMPH, MAPL dhe donatorët:

- Përgatitja e paramasave dhe parallogarive për projekte kapitale;
- Përgatitja e dokumentacionit për tenderim të projekteve, deklarata e nevojave, kërkesave për të gjitha projektet e Drejtoratit për DIL.
- Mbikëqyrja e punimeve gjatë realizimit të projekteve në teren;
- Hapja dhe vlerësimi i tenderëve për projekte kapitale;
- Hartimet e planeve të menaxhimit të kontratave, raporteve të kërkuara për pagesa nga mbikëqyrësit e projekteve kapitale;
- Përgatitja e platformës digjitale online të dhënave hapësinore në infrastrukturë(rrugë me asfalt dhe kubëza betoni, kanalizime, ujësjellësi, trotuare, ndriçim publik, hapje e kanaleve kulluese, rehabilitim i kanalizimeve, rregullimi dhe pastrimi i shtratit të lumit)
- Përgatitja e detyrave projektuese për hartimin e projekteve zbatuese për projekte kapitale
- Njoftime të ndryshme për palë rreth kompletimit të lëndëve;
- Takime me përfaqësuesit e Ministrive të ndryshme që lidhen me punët e drejtoratit;
- Puna në komisione të ndryshme të caktuara nga Kryetari I Komunës dhe drejtorët e drejtorateve tjera si(komisioni për performancë komunale, komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga të reshurat atmosferike, komisioni për efikasitet të energjisë,etj)
- Takimi me përfaqësuesit e Ujësjellësit Rajonal, CDI zvicerane në Prishtinë dhe punë kryesit për fillimin e punëve në rrjetin e ujësjellësit për 14 fshatra të komunës sonë.
- Përgatitja e raporteve të ndryshme për nevoja të drejtorisë sonë dhe drejtorive tjera të komunës

PENGESAT DHE VËSHTIRËSITË

Zyrtarët e drejtoratit për Infrastrukturë Lokale i kryejnë punët dhe detyrat tjera në bazë të ligjeve në fuqi, përshkrimit të vendeve të punës si dhe planit vjetor të punës.

Duhet të theksohet që gjatë realizimit të mbikëqyrjes së projekteve në teren, po ashtu edhe punëve në zyrë jemi ballafaquar me vështirësi të natyrave të ndryshme. Kemi pasur shumë pengesa nga banorët e zonave të ndryshme duke filluar nga uzurpimet e pronave dhe ngushtimi i rrugëve, moslejimi i realizimit të projekteve në pronat publike e private e deri te pengimi i realizimit të projekteve, si dhe në disa raste kanë ndikuar edhe në procedurat e prokurimit të stërzgjidhura (vlerësimet e ofertave si dhe publikimi i kontratave). Gjithashtu duhet theksuar se gjatë vitit 2020 pengesa kryesore ishte pandemia COVID-19 e cila shkaktoi vonesa edhe në realizimin e projekteve.

Problem është mungesa e punëtorëve, reduktim i stafit për shkak të gjendjes së krijuar nga Pandemia COVID-19 sepse me këtë numër kaq të vogël të punëtorëve që ka drejtoria kemi vështirësi të shumta në realizimin e të gjitha këtyre projekteve kapitale sepse vëllimi i punëve është mjaft i madh. Zyrtarët e drejtoratit tonë është dashur të marrin pjesë në çdo hapje dhe vlerësim të ofertave si dhe menaxhimin e mbikëqyrjen e punimeve në teren. Po ashtu kemi mungesë të veturave për dalje në teren për menaxhim të projekteve, takime dhe trajnime të ndryshme.

Problem tjetër është edhe mbikëqyrja e punimeve gjatë vikendeve nga ana e zyrtarëve të drejtoratit në mënyrë që të rritet cilësia në realizim të projekteve. Vlen të ceket edhe rrezikshmëria gjatë menaxhimit të kontratave sipas rregullores 33/2012 për shtesat në pagë dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil.

PROPOZIMET

Drejtoria për Infrastrukturë Lokale në fokusin e saj ka përmirësimin e infrastrukturës për jetë më të mirë për banorët e komunës sonë dhe kjo do të arrihet duke pasur një planifikim të qëndrueshëm dhe realizimit të projekteve kapitale të cilat lidhen drejtpërdrejtë me infrastrukturën.

Për të përmbushur misionin dhe vizionin e saj drejtoratit tonë mendojmë se duhet të krijohen disa parakushte për zyrtarët komunë dhe se pari të rritet numri i punëtorëve në këtë drejtori sepse kemi mungesë të inxhinierëve të lëvizjeve profesionale.

2.12. DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik në Komunën e Drenasit gjatë vitit 2020 (01.01.2020-31.12.2020) në kuadër të fushëveprimtarisë ka ofruar këto punë/shërbime zyrtare të bazuar në Statutin e Komunës, në harmoni me ligjet e Kuvendit të Kosovës, aktet tjera nënligjore, Rregulloret e miratuara nga Kuvendi Komunal i Drenasit, dokumenteve strategjike dhe planin e punës për vitin 2020.

Punës/shërbimet e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik fokus të veçantë i është kushtuar hartimi dhe realizimit të politikave zhvillimore, marrja e masave sa më të përshtatshme për të nxituar më tutje zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të komunës së Drenasit, krijimin e kushteve sa më të favorshme me infrastrukturë dhe mjedisit sa më të përshtatshme për zhvillim të ndërmarrjeve të vogla, mesme (NVM) për një zhvillim sa më të qëndrueshëm.

Fokus të veçantë vazhdon t'i ipet promovimit të zhvillimit ekonomik, turizimit, zbutjes së papunësisë duke mundësuar gjenerimin e vendeve të reja të punës. Pra, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik vazhdon me intensifikimin e angazhimeve të saj drejt përmirësimi të klimës së të bërit biznes, promovimin e komunës së Drenasit si një Komunë atraktive, për investorët strategjik për të investuar dhe për tu vizituar, gjithëmon e hapur ndaj ideve inovative dhe projekteve të reja smart, gjithmon duke ofruar shërbime/konsulenca profesionale.

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtori:

- Regjistrimi i bizneseve fillestare (të gjitha bizneset individuale B.I shoqëritë aksionare, ortakëri e përgjithshme, ortakëri e kufizuar, shoqëria e huaj tregtare, ndërmarrjet shoqërore dhe kooperativat bujqësore;
- Regjistrimi i ndryshimeve në biznes;
- Paisje me qertifikata të reja me numër Unifikues;
- Paisja me informata shtesë për biznes;
- Protokollimi i të gjitha lëndëve që kanë të bëjnë me biznes;
- Raportet javore, mujore pranë MTI;
- Vërtetime për persona fizik që nuk ushtrojnë veprimtari biznesore;
- Vërtetime që nuk posedojnë obligime të taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste biznesore;
- Shqyrtimi i lëndëve: kërkesave, ankesave dhe të ngjajëshme;
- Ngarkesa e taksës komunale për biznese;
- Inkasimi i taksës komunale për biznese (pagesat);
- Bartja e të dhënave kartelat e programit të vjetër të taksës për biznes në programin e ri të taksës për biznes E-Taksa Drenas.
- Konsulenca me palët/bizneset si dhe
- Punë dhe angazhime tjera në komisione.

Sipas Qendrës Komunale **ONE STOP SHOP** për Biznese, numri i bizneseve të regjistruara nga data: 01.01.2020 deri me datën 31.12.2020 janë të regjistruar **182** biznese të reja. Krahasuar me vitin paraprak që ishin regjistruar **202** biznese ose shprehur në përqindje **11.00%** më pak se në vitin e kaluar, të cilat biznese në bazë të deklarimeve të tyre punësojnë **285** punëtorë.

Bizneset fillestare brenda ditës pajisen me certifikatën e biznesit si dhe numrin unik të regjistrimit, pranë kësaj Qendre jepen të gjitha konsultat e nevojshme të kësaj natyre për ta krijuar një ambient sa ma të volitshëm për regjistrimin dhe të gjitha ndryshimet e nevojshme në biznes. Shikuar në bazë të kësaj periudhe ky numër i bizneseve të regjistruara duket si vijon :

I. Tabela e klasifikimit të bizneseve sipas numrit të punësuarëve:

Klasifikimi sipas madhësisë	Numri i punëtorëve	Numri i bizneseve	Përqindja në total
Të vogla	1-5	107	59.00%
Të mesme	5 – 60 (Sh.p.k.)	75	41.00%
Të mëdha	60 - e më tepër	-	-
Gjithsejtë:		182	100.00%

Vlen të theksohet se regjistrimi i bizneseve të tipit Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizume kanë shënuar një rritje.

Nga tabela e paraqitur më lartë vërehet se të gjitha bizneset e regjistruara në periudhën:

01.01.2020 – 31.12.2020 i takojnë ekskluzivisht kategorisë së bizneseve të vogla (59.00%).

Nr .	Bizneset kryesisht janë të përqendruara në këto veprimtari:	Shpërndarja e bizn. sipas veprimtarive	Përqindja
1.	Tregëti	36	20.00%
2.	Transport	21	12.00%
3.	Ndërtimtari	39	21.00%
4.	Hoteleri	31	17.00%
5.	Bujqësia	27	14.00%
6.	Shëndetësi	12	7.00%
7.	Industri- zejtari prodhuese	-	-
8.	Arsim	16	9.00%
	Gjithsejtë:	182	100.00 %

II. Bizneset e regjistruara në Komunën e Drenasit sipas llojit të pronësisë në periudhën:

01.01.2010 – 31.12.2020

Nr.	Lloji i pronësisë	Numri i bizneseve	Përqindja
1	Biznes individual	107	59.00%

2	Ortakëri e përgjithshme	/	
3	Ortakëri e kufizuar	/	
4	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	75	41.00%
5	Shoqëri Aksionare	/	
6	Ndërmarrje në pronësi të huaj	/	
7	Ndërmarrje publike	/	
8	Kooperativë bujqësore	/	
	TOTALI:	182	100.00%

Të dhënat e QKB të paraqitura në tabelën e mësipërme ofrojnë informata në lidhje me strukturën pronësore të bizneseve të regjistruara me 01.01.2020 – 31.12.2020 në Komunën e Drenasit, Bizneset individuale gjatë kësaj periudhë ekskluzivisht dominojnë strukturën pronësore bizneset individuale me **59.00%**, SHPK-t edhe më tutje shënojnë një rritje konstante.

Gjatë periudhës 01.01.2020 – 31.12.2020, në vijim me kërkesën e pronarëve të bizneseve janë regjistruar gjithsejtë: **126** ndryshime të bizneseve ekzistuese ,në periudhën paraprake të vitit të kaluar bizneset që patën ndryshime ishte **156** biznese ose **30.00%** ma pak se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar dhe sipas muajve duken kështu:

III. Ndryshime në biznes sipas periudhës: 01.01.2020 – 31.12.2020;

Nr.	Muajt e vitit	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
1.	Ndryshimet në biznese	09	12	10	18	15	07	9	12	07	11	7	9

Janë regjistruar **19** shuarje dhe janë ripërtëri certifikatat me numrin unik të regjistrimit si dhe bizneset me logo të UNMIK-ut janë zëvendësuar me certifikata me logo të Republikës së Kosovës.

Në periudhën 01.01.2020- 31.12.2020 janë Arkivuar 603 lëndë në sistemin e ARBK, janë faturuar dhe paguar **94.825,00** euro taksë komunale, janë dorëzuar raporte për biznese në MTI, konsulenca rreth bizneseve, si dhe punë të tjera sipas nevojës së DBZHE .

❖ Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve që ofron kjo drejtori kanë marrë pjesë stafi sipas kërkesës në:

- Pjesëmarrje në punëtori: „Rrjeti Rajonal për Ngritje të Kapaciteteve” e organizuar nga Asociacioni i Komune të Kosovës.
- Pjesëmarrja në trajnimin; “Lidershipi dhe dhe Menaxhimi i Administratës Lokale” të organizuar nga IKAP.
- Pjesëmarrja në seminarin e organizuar në mënyrë virtuale me temë: “ Analiza për investime Kapitale e realizuar sipas rajoneve Zhvillimore të vitit 2019 “ e organizuar Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale(KLGI) dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal.
- Pjesëmarrja në seminarin mbi “Integrimin gjinor në procesin e vendimarrjes” organizuar nga Misioni në Kosovë i Organizatës për siguri dhe Bashkëpunim në Europ (OSBE) dhe Mnisitrisë së Pushtetit Lokal.

- Pjesëmarrja në seminarin në mënyrë virtuale me temë: “Menagjimi i Taksave dhe Planifikimi i të Hyrave Vetanake” të organizuar nga IKAP.
- Pjesëmarrja në seminarin në mënyrë virtuale me temë: Hartimi i strategjive, monitorimi dhe vlerësimi i tyre” të organizuar nga IKAP.
- ❖ **U realizuan takime me përfaqësuesit institucioneve të nivelit qendror, organizatave vendore dhe ndërkombëtare me qëllim të arritjen se marrëveshjes/bashkëpunimit për të gjetur mundësin e përkrahjes/financimit e projekteve zhvillimore, të cilat do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik të komunës së Drenasit dhe sektorit privat/ bizneseve të cilat operojnë në territorin e komunës së Drenasit;**
 - Takim me përfaqësuesit nga MTI – Agresioni për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë, tema: “Bashkëpunimi i rregullt dhe koordinimi rreth aktiviteteve për promovimin e investimeve në Komunën e Drenasit.
 - Takim me përfaqësuesit e OSBE-së, tema: Gjetja dhe mundësia e bashkëpunimit/financim të aktiviteteve të planifikuara komunale të cilat do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik lokal.
 - Takim me përfaqësuesit e Organizatës HELP, gjetja e mundësive të bashkëpunimit për të nxituar zhvillimin ekonomik të komunës së Drenasit, përkrahja e projekteve të bizneseve, dhe mundësia e përkrahjes se START-UP-ve.
 - Takim me përfaqësuesit e WOMEN FOR WOMEM, mundësia e bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve të tyre me Komunën e Drenasit.
 - Takim me udhëheqësen e Agjencisë për Zhvillim Rajonal –Qendër , me tem diskutimi skema e investimeve kapitale të lansuara nga Ministria e Zhvillimit Rajonal, si dhe shpalosëm planet dhe mundësin e rritjes së bashkëpunimit.
 - Janë realizuar takime me përfaqësuesit e bizneseve që të diskutojm për sfidat, pengesat, mundësitë dhe planet zhvillimore.
 - Janë realizuar takime me përfaqësueset e shoqatave dhe organizatave joqeveritare, me qëllim të koordinimit të aktiviteteve në nivelin lokal, të cilat do të ndikojnë në përmirësimin e jetës ekonomike, sociale të Komunës së Drenasit.
 - Takim në MTI me Fokus Grupeve Regjionale lidhur me sfidat e bizneseve dhe përkrahjen që i është ofruar gjatë kësaj periudhe, qëllimi i takimit ishte zhvillimi i dialogut-bashkëpunimit mes nivelit qendror dhe atij lokal.
- ❖ **Arritja e realizimit të marrëveshjeve/bashkëpunimeve të cilat do të ndikojnë në përmirësimin dhe ngritjen e kapaciteteve të NMV**
 - ✓ Marrëveshje bashkëpunimi me organizatën HELP
 - ✓ Marrëveshje bashkëpunimi me organizatën WOMEN FOR WOMEN
- ❖ **Projektet të cilat janë implementuar dhe duke u implementuar :**
 - **Projekti:** “Mbështetje stabilitetit socio-ekonomik në Kosovë”, projekt bashkëpunues mes komunës së Drenasit dhe organizatës HELP.
 - Realizimit i sesionit informuar të projektit “ I SEE” organizuar nga organizata WOMEN FOR WOMEN dhe implementuar në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik Komuna Drensa.
- ❖ **Informimi me kohë në platformën online dhe informim në zyre të drejtorisë lidhur me gjetjen dhe mundësin e aplikimit në grande, projekte dhe subvencione adresuar: sektor privatë/bizneseve, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit si;**
 - Thirrje për projekte të vogla nga Ambasada gjermane ;

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE PËR VITIN 2019

- Thirrje për aplikim në projektin “Mbështetje stabilitetit socio-ekonomik në Kosovë”, projekt bashkëpunues mes komunës së Drenasit dhe organizatës HELP.
- Thirrje për aplikim për grante- programin: “Gratë Ndërmarrëse në Energji (WEE) lancuar nga Fondacioni i Mileniumit të Kosovës (MFK).
- Thirrje për aplikim “Mbështetja për përsheptimin e biznesit (Business Acceleration Support) nga WEE (Women Energy Support).
- Thirrje për aplikim për gande në - Skemen e Granteve „ Programi i Zhvillimit Rajonal të Balansuar” PZHRB 2020, për propozimet për start-up dhe biznese ekzistuese, të shpallur nga MZHR-ja;
- Thirrje për aplikim në projektin “Përgjigje e shpejtë ndaj pandemisë COVID-19-mbështetje e grupeve më të cenushme të grave” nga Formi Ekonomik i Grave i koordinuar nga Instituti Riinvest;
- Thirrje për suvencionim të mejteve financiare për ndermarrjet e mesme, të vogla dhe të mëdha, lansuar nga MTI-KIESA.
- Thirrje për suvenncionim të bizneseve MVM-ve në pronësi të grave ndërmarrëse lansuar nga MTI-KIESA.
- Thirrje për aplikim për start – up biznes për të rinjtë e moshave 18-24 vjeqë lansuar nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Soprtit.
- Thirrje për lansimin e granteve për start-up dhe biznese ekzistuese, masa 8 “ Programi për Rimëkëmbje Ekonomike 2020 Masa 8”lansuar nga MZHR.
- Thirrje për aplikim - BERZH në bashkëpunim me MZHR prezantojnë akademinë online” Know-how” për bizneset e vogla.
- Thirrje për gratë ndërmarrëse lidhur me programin për grante - Gratë Ndërmarrëse në Energji (WEE) thirrje për aplikim nga Fondacioni Mileniumit i Kosovës (MFK) dhe pajisja me aplikacione sipas kërkesës së palëve.

❖ Zhvillimi dhe promovimi i turizmit:

- Me qëllim të mundësisë për promovim dhe zhvillim të turizmit të komunës së Drenasit është duke u bërë identifikimi i monumenteve historike në bashkëpunim me Drejtorin e Kulturës. Si shkak i gjendjes se pandemisë shumë procese/projekte kanë mbetur pa u implementuar gjatë këtij viti.

KRYETARI I KOMUNËS

RAMIZ LLADROVCI



[Handwritten signature]